



# Manual për Vëzhgimin e Zgjedhjeve

**Botimi i pestë**

Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe  
të Drejtat e Njeriut (ODIHR)  
Al. Ujazdowskie 19  
00-557 Warsaw  
Poland  
[www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr)

© OSBE/ODIHR 2006

Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara. Përmbajtja e tij mund të kopjohet dhe të përdoret lirisht për qëllime edukative si dhe qëllime të tjera jo komerciale, me kusht që çdo riprodhim të jetë i shoqëruar me një shënim ku të thuhet se burimi është OSBE/ODIHR.

ISBN 83-60190-10-0

Fotografia në kopertinë nga Lubomir Kotek

Formulimi grafik nga Nona Reuter

Shtypur në Poloni nga Poligrafus Andrzej Adamiak

---

Manual për  
Vëzhgimin e  
Zgjedhjeve

**Botimi i pestë**

---



---

# TABELA E LËNDËS

Parathënie	7
1. Hyrje	9
2. Pak histori për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve	11
3. Parimet universale të zgjedhjeve dhe të drejtave të njeriut	17
4. Kuadri praktik për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve	23
5. Përgatitjet për vëzhgim: Misioni i vlerësimit të nevojave	27
6. Struktura e misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin zgjedhor	29
7. Vëzhgimi i periudhës parazgjedhore	39
8. Vëzhgimi ditën e zgjedhjeve	55
9. Vëzhgimi i numërimit të votave	65
10. Raportimi, informimet, deklaratat	69
11. Vëzhgimi paszgjedhor	73
12. Mbyllja e misionit të vëzhgimit zgjedhor të OSBE/ODIHR	77
13. Partneritetet	79
14. Raporti përfundimtar	81
15. Ndjekja në vazhdimësi e problemeve	83
Aneks A: Dokumente të OSBE-së	86
Aneks B: Modeli i listës së verifikimeve të OSBE/ODIHR-it ditën e zgjedhjeve	90
Aneks C: Botime rreth zgjedhjeve	93

---



# PARATHËNIE

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) është një organizatë transatlantike, ndërqeveritare me pjesëmarrjen e 55 shteteve, që rrok rajonin e Europës në kuptimin më të gjerë (duke përfshirë Kaukazinë e Jugut dhe Azinë Qendrore), ku bëjnë pjesë edhe Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kësisoj OSBE-ja përfshin në gjirin e vet një rajon të tërë nga Vancouver deri në Vladivostok.

Në tërë këtë rajon OSBE-ja është instrument i rëndësishëm për paralajmërimin dhe parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave, dhe rehabilitimin e situatës në periudhën pas konfliktit. Qasja e saj ndaj çështjeve të sigurisë është bashkëpunimi; vendimet merren me konsensus dhe janë politikisht të detyrueshme për të 55 shtetet pjesëmarrëse.

Qysh nga zanafilla e vet, me organizimin në vitin 1975 të Konferencës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (KSBE), OSBE-ja ka një këndvështrim gjithëpërfshirës për çështjet e sigurisë. *Dimensioni njerëzor* i sigurisë – mbrojtja dhe çuarja përpara e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe mbështetja e institucioneve të forta demokratike dhe shtetit të së drejtës – janë po aq të rëndësishme për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, sa edhe dimensionit politiko-ushtarak ose ekonomik. Të gjitha vendet anëtare të OSBE-së janë të angazhuara t'u përmbahen parimeve demokratike si dhe respektimit të një spektri të gjerë të të drejtave të njeriut dhe, ndërmjet tyre, të sigurojnë zhvillimin e zgjedhjeve periodike dhe të vërteta.

Të gjitha vendet anëtare të OSBE-së pajtohen me mendimin se çështjet e dimensionit njerëzor nuk janë probleme të brendshme të njeriut ose tjetrit vend, por çështje që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha shtetet anëtare të kësaj organizate, e që përbëjnë një shqetësim të ligjshëm për ta. Në Deklaratën e Samitit të Lisbonës më 1996, thuhet se, “Ndër problemet e mprehta që kanë të bëjnë me dimensionin njerëzor, shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut, të tilla si mashtrimet elektorale, vazhdojnë të vënë në rrezik stabilitetin në rajonin e OSBE-së.” Ndërsa më poshtë, vendet anëtare të OSBE-së shprehen se, “Janë të angazhuara të merren edhe në të ardhmen me trajtimin e këtyre problemeve.”

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, (ODIHR) me qendër në Varshavë, është institucioni kryesor i OSBE-së për sa i përket dimensionit njerëzor. Një nga elementët

kyç në kuadër të mandatit të ODIHR-it lidhur me dimensionin njerëzor është edhe mbështetja e zgjedhjeve demokratike. Nisur nga ky synim, kjo Zyrë ka ndërmarrë një numër programesh që kanë të bëjnë me zgjedhjet, ndër të cilët më i rëndësishmi është ai i vëzhgimit të zgjedhjeve nga vëzhgues ndërkombëtarë. Qysh nga koha e krijimit të ODIHR-it, më 1991, ai është shndërruar në *agjensinë* kryesore ndërkombëtare për vëzhgimin e zgjedhjeve në mbarë rajonin. Veprimtaritë e ODIHR-it që lidhen me zgjedhjet përforcohen nga spektri tejjet i gjerë i programeve të tjera të ndërmarra nga kjo Zyrë, të cilat synojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, forcimin e institucioneve demokratike, respektimin e shtetit të së drejtës, si dhe nxitjen e përkrahjen e shoqërisë civile në të gjithë shtetet anëtare të Organizatës.

Manuali për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i ODIHR-it erdhi si rrjedhojë e kërkesës të vendeve anëtare të OSBE-së,<sup>1</sup> ndaj dhe botimi i parë i tij doli më 1996. I konceptuar, pikësepari e kryesisht, si një guidë sjelljeje e misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve (MVZ) të ODIHR-it, metodologjia e përshkruar në këtë manual ka udhëhequr të gjitha përpjekjet e bashkësisë së vëzhguesve ndërkombëtarë të zgjedhjeve për të kryer një vlerësim tërësor dhe të njehsishëm të proceseve zgjedhore. Kjo metodologji i ka shërbyer më së miri OSBE-së dhe ka hedhur themele të shëndosha për sa i përket famës së ODIHR-it si udhërrëfytes në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve.<sup>2</sup>

Botimi i pestë është freskuar dhe përmirësuar në mënyrë që tja përshtasë metodologjinë rrethanave të reja, ndërkohë që pasqyron edhe përvojat e reja të përfuara gjatë viteve të fundit. Dëshiroj sinqerisht ta rekomandoj atë jo vetëm dhe thjesht si një material të domosdoshëm leximi për të gjithë vëzhguesit tanë zgjedhorë, por edhe për një publik më të gjerë, të interesuar për proceset zgjedhore.

Së bashku me botime të tjera tonat, ky manual pasqyron një sërë arritjesh parësore të bashkësisë ndërkombëtare, si dhe përbën një bazë të qëndrueshme lidhur me proceset demokratike. Të gjithë botimet e ODIHR-it gjenden në faqen tonë në internet ([www.osce.org/odihp](http://www.osce.org/odihp)) dhe janë pa pagesë.

Së fundi, dëshiroj të falenderoj ata mijëra vëzhgues që i kanë përkushtuar kohë dhe energji përforcimit të misioneve tona të vëzhgimit të zgjedhjeve. Përkushtimi i tyre ka qenë thelbësor për përpjekjet tona.



**Ambasadori Christian Strohal**  
Drejtor i ODIHR-it



<sup>1</sup> Deklarata e Samitit të Budapestit, 1994.

<sup>2</sup> Metodologjia e ODIHR-it është miratuar dhe përshtatur edhe nga organizata të tjera ndërkombëtare për të kryer veprimtaritë e tyre në lëmin e vëzhgimit të zgjedhjeve. Për shembull, në *Handbook for European Union Election Observation Missions* [Manualin e Bashkimit Europian për misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve të], pohohet se qasja e saj metodologjike ndaj vëzhgimit të zgjedhjeve "Është pasuruar veçanërisht nga përvoja e Organizatës për Siguri e Bashkëpunim në Europë, dhe metodologjia e saj lidhur me vëzhgimin e zgjedhjeve, ashtu siç është përvijuar në Manualin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR"-it.



# 1.

## Hyrje



### 1.1 Rreth Manualit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve

Ky manual na jep një ide të përgjithshme për metodologjinë e vëzhgimit të zgjedhjeve nga ODIHR dhe shërben si pikë referimi për të gjithë anëtarët e MVZ-ve.<sup>3</sup> Gjithashtu, ai informon mbarë bashkësinë e OSBE-së, duke përfshirë qeveritë e vendeve anëtare, partitë politike, kandidatët, votuesit dhe shoqërinë civile, në lidhje me planifikimin, dërgimin në terren dhe zbatimin e një misioni vëzhgimi të zgjedhjeve.

Ndonëse metodologjia e ODIHR-it nuk ka ndryshuar shumë qysh nga botimi i parë i manualit më 1996, botimi i pestë ka përfutur nga përvoja e grumbulluar prej më se 150 procesesh zgjedhore që ODIHR ka vëzhguar deri më sot. Ai e ka zgjeruar fokusin e vet, duke mbajtur parasysh një sërë çështjesh specifike, si pjesëmarrja e grave dhe përfshirja e pakicave kombëtare në procesin zgjedhor. Në vijim të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990, ky botim i referohet gjithashtu edhe angazhimeve të marra herë pas here nga vendet anëtare në forume të ndryshme lidhur me procesin zgjedhor.<sup>4</sup>

Dalja nga shtypi e botimit të pestë të këtij manuali përkon me përvjetorin e 30-të të Aktit Final të Helsinkit, si dhe me përvjetorin e 15-të të Dokumentit të Kopenhagenit e të Kartës së Parisit. Kështu ky botim shërben edhe si një kujtesë për arritjet e OSBE-së në shpurjen përpara të proceseve zgjedhore demokratike në radhët e vendeve anëtare të Organizatës. Qysh në botimin e parë të manualit, theksohej fakti se procesi zgjedhor nuk është thjesht e vetëm

<sup>3</sup> Udhëzime më të hollësishme e të specializuara për anëtarët e misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve gjenden në një sërë botimesh të tjera të ODIHR-it, duke përfshirë këtu *Handbook for Monitoring Women's Participation in Elections* [Manualin për Monitorimin e Pjesëmarrjes së Grave në Zgjedhje], *Guidelines for Reviewing a Legal Framework for Elections* [Udhëzues për Rishikimin e Kuadrit Ligjor për Zgjedhjet], *Guidelines to Assist National Minority Participation in the Electoral Process* [Udhëzues për të Ndhimuar Pjesëmarrjen e Pakicave Kombëtare në Procesin Zgjedhor], *Handbook on Resolving Election Disputes in the OSCE Area* [Manuali për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Zgjedhore në Zonën e OSBE-së], si dhe *Existing Commitments for Democratic Elections in OSCE Participating States* [Angazhimet Ekzistuese të Vendeve Anëtare të OSBE-së për Zgjedhje Demokratike]. Të gjitha këto botime janë të vlefshme e gjenden si në trajtë libri, ashtu edhe në version elektronik në faqen e ODIHR-it në internet: [www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr).

<sup>4</sup> Deklarata e Samitit të Budapestit, 1994; Deklarata e Samitit të Lisbonës, 1996; Deklarata e Samitit të Stambollit, 1999; Karta për Sigurinë Europiane, 1999.

një ngjarje njëditore, dhe se ai pasqyron e nxjerr në pah edhe rolin e ODIHR-it në vëzhgimin afatgjatë para, gjatë dhe pas ditës së votimit (Deklarata e Samitit të Budapestit, 1994).

Sot, pas vendimeve të marra në Stamboll (1999), Porto (2002) dhe Mastriht (2003), botimi i pestë i manualit thekson interesimin e vazhdueshëm të ODIHR-it për angazhimin e mëtejshëm të vendeve anëtare të OSBE-së për të zbatuar në vijimësi rekomandimet e ODIHR-it për përmirësimin e procesit zgjedhor. Në harkun kohor të një dhjetëvjeçari, nga botimi i parë i manualit në atë të pestë, ODIHR-i ka nënvizuar rëndësinë e angazhimeve afatgjata si dhe qasjen e orientuar drejt procesit të partneritet me vendet anëtare të OSBE-së, për të arritur objektivin e përbashkët, atë të realizimit të angazhimeve të OSBE-së lidhur me procesin zgjedhor.

## 1.2 Si ta përdorim këtë Manual

Manuali është strukturuar në mënyrë të atillë që të mundësojë përdorimin me lehtësi nga ana e lexuesve të materialeve me interes për ta. Kapitujt 1-4 shqyrtojnë arësyet pse ODIHR-i merret me vëzhgimin e zgjedhjeve, duke përfshirë këtu edhe angazhimet e OSBE-së, në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i proceseve zgjedhore në rajonin e saj, si edhe parimet e tjera universale<sup>5</sup> të zhvillimit të zgjedhjeve demokratike. Në të trajtohet edhe kuadri rregullator i një misioni vëzhgimi zgjedhor, ku përfshihen kushtet e nevojshme për të patur një mision vëzhgimi zgjedhor të efektshëm si edhe Kodin e Sjelljes së Vëzhguesve.

Kapitujt operativë janë grupuar si vijon: Kapitujt 5-6 flasin për përgatitjet e posaçme për krijimin e një MVZ-je, duke nisur me misionin e vlerësimit të nevojave, dërgimin dhe vendosjen në vend të misionit të vëzhgimit, strukturën dhe organizimin e tij; Kapitujt 7-9 përshkruajnë me hollësi metodologjinë e vëzhgimit të periudhës parazgjedhore, si dhe procedurat e votimit dhe të numërimit të votave; Kapitujt 10-12 përqëndrohen në periudhën paszgjedhore, ku hyn raportimi fill paszgjedhor, vëzhgimi i zhvillimeve paszgjedhore dhe mbyllja e misionit; ndërsa kapitujt e fundit (13-15) trajtojnë partneritetin e ODIHR-it me organizatat e tjera, vlerësimin përfundimtar të zgjedhjeve dhe opsionet për ndjekjen e situatës paszgjedhore.

Dhe sëfundit, manuali përmban gjithashtu tri anekse me informacione të tjera: Aneksi A përmban të gjitha angazhimet e rëndësishme të OSBE-së që kanë të bëjnë me zgjedhjet, të cilat gjenden në Dokumentin e Kopenhagenit të vitit 1990, si dhe angazhime të tjera që lidhen me OSBE-në; Aneksi B përmban modelin e pyetësorit që përdoret nga vëzhguesit afatshkurtër gjatë kohës që vizitojnë qendrat e votimit; ndërsa aneksi C përfshin një bibliografi të të gjithë botimeve e ODIHR-it për zgjedhjet.

<sup>5</sup> *Me parime universale* kuptojmë të gjitha ato parime që përfshihen në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut si dhe në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Politike e Civile. Tekstet e tyre të plota, si dhe të dokumenteve të tjera të Kombeve të Bashkuara, mund të gjenden në faqen në internet të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, [www.ohchr.org](http://www.ohchr.org).

# 2.

## Pak histori për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve



### 2.1 Pse vëzhgohen zgjedhjet?

Si një bashkësi vendesh të angazhuara ndaj parimeve të demokracisë, OSBE-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë çuarjes përpara të zgjedhjeve demokratike, si një nga shtyllat kryesore të stabilitetit. Të gjitha vendet anëtare të OSBE-së janë të angazhuara të ftojnë vëzhgues ndërkombëtarë për zgjedhjet në vendet e tyre dhe në mënyrë të veçantë ODIHR-in (Samiti i Stambollit, 1999), duke pranuar faktin se vëzhgimi i zgjedhjeve mund të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e besimit tek procesi zgjedhor. Prania e vëzhguesve në zgjedhje siguron një përkrahje të dukshme për proceset demokratike dhe mund t'i ndihmojë vendet anëtare të OSBE-së të realizojnë synimet e tyre për të kryer zgjedhje të drejta në përputhje me angazhimet e OSBE-së.

Zgjedhjet janë kurorëzimi i të drejtave themelore të njeriut dhe, thënë më shkoqur, i të drejtave politike e qytetare, ndaj dhe vëzhgimi i zgjedhjeve është një ndihmesë për çuarjen përpara dhe mbrojtjen e gjithanshme të këtyre të drejtave. Zgjedhjet e vërteta janë një garë politike që zhvillohet në një mjedis që karakterizohet nga mirëbesimi, transparenca dhe ndjenja e llogaridhënjes; një mjedis që u siguron votuesve mundësinë e një zgjedhje të informuar midis alternativave të ndryshme politike. Një proces zgjedhor i drejtë presupozon respektimin e lirisë së shprehjes dhe një media të lirë; lirinë e shoqatave, të mbledhjeve dhe të lëvizjes; bindjen ndaj shtetit ligjor; të drejtën për të krijuar parti politike dhe për të konkuruar për poste në administratën publike; mosdiskriminim dhe të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët; të qenurit i çliruar nga gjithfarësoj kërcënimesh; si dhe një sërë të drejtash dhe lirisish të tjera themelore, të cilat të gjitha vendet anëtare të OSBE-së janë angazhuar t'i mbrojnë e t'i çojnë përpara.

Vëzhgimi i zgjedhjeve rrit transparencën dhe llogaridhënjen, duke shtuar kësodore besimin në vend dhe në shkallë ndërkombëtare tek procesi zgjedhor. Gjithsesi thjesht e vetëm prania e vëzhguesve ndërkombëtarë nuk duhet parë si diçka që shton legjitimitetin ose rrit besueshmërinë e një procesi zgjedhor. Ndonëse prania e vëzhguesve mund të jetë një tregues se pro-

cesi meriton të vëzhgohet, do të jenë përfundimet e vëzhguesve për procesin, të mbështetura në metodologjinë e ODIHR-it, ato që do të formojnë opinionin e ODIHR-it për zgjedhjet.

Qëllimi përfundimtar i një misioni vëzhgues zgjedhor të ODIHR-it është që të vlerësojë se deri në ç'shikallë një proces zgjedhor përputhet me angazhimet e OSBE-së, duke pasur parasysh Dokumentin e Kopenhagenit të vitit 1990, legjislacionin vendas dhe parime të tjera universale të zgjedhjeve demokratike. Po kështu vlerësimi bëhet edhe për legjislacionin vendas për të parë se sa pajtohet ai me këto angazhime, ndërkohë që kuadri ligjor për zgjedhjet lypset t'i pasqyrojë plotësisht të gjithë këto angazhime.

## 2.2 Vëzhgimi i zgjedhjeve në kontekst

Shtrirja e veprimtarive që kanë të bëjnë me vëzhgimin e zgjedhjeve në këta dy dhjetëvjeçarët e fundit është e lidhur drejtpërdrejtë me prirjen globale drejt demokratizimit. Prandaj dhe vëzhgimi i zgjedhjeve është një veprimtari që zhvillohet kryesisht në përkrahje të demokracive të reja dhe vendeve në tranzicion drejt demokracisë. Veprimtaritë e misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it kanë dëshmuar angazhimin e OSBE-së për të ndihmuar demokracitë e reja dhe ato të sapoformuara brenda hapësirës së OSBE-së për të ndërtuar struktura të qëndrueshme demokratike. Në të njëjtën kohë, procesi i vëzhgimit ofron mundësi për të bërë një vlerësim se deri në ç'shikallë demokracitë e reja dhe ato të sapoformuara po i plotësojnë zotimet e tyre ndaj OSBE-së.

Ndonëse në pjesën më të madhe të rasteve të vëzhgimit të procesit zgjedhor, vëmendja është përqëndruar te demokracitë e reja ose vendet në tranzicion, edhe demokracitë e përparuar mund të përfitojnë nga vëzhgimet me qëllime të përcaktuara, ose nga vlerësimet e bëra nga ekspertët ndërkombëtarë. Në këtë pikë lypset të mbahet parasysh se, nisur nga parimi i barazisë së shteteve sovraane, siç u përcaktua edhe në Helsinkë, të 55 vendet anëtare kanë të njëjtat detyrime në bazë të angazhimeve të njëjta të marra bashkërisht. Duke pasur parasysh këtë, ODIHR ka ndërmarrë misionet e vëzhgimit të vlerësimit zgjedhor (shih Seksioni 2.4.2) edhe në vende me tradita të vjetra ose të stabilizuara demokratike për të vlerësuar praktikatat zgjedhore dhe, kur e ka parë të nevojshme, për të sugjeruar përmirësime në to.

Vëzhgimi i zgjedhjeve është një veprimtari civile. E megjithatë vëzhgimi i procesit zgjedhor mund të kryhet edhe në situata pas konfliktit, ndonëse kjo gjë varet nga krijimi i mjedisit të përshtatshëm e të sigurtë për vëzhguesit dhe ekspertët zgjedhorë për të vepruar brenda një hapësire kudonjëllor të sigurtë në mënyrë që procesi zgjedhor të zhvillohet ashtu siç duhet. Por dobia e vëzhgimit të zgjedhjeve do të ishte në thelb e pavlefshme në qoftë se procesi do të zhvillohej nën masa të rrepta sigurie, duke përfshirë këtu edhe rojet e armatosura.

## 2.3 Mandati i ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve

Mandati i ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve rrjedh nga paragrafi 8 i Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 dhe më pas është konfirmuar nga Karta e Parisit të vitit 1990 për një Europë të Re, nga Dokumenti i Takimit të Katërt të Këshillit të KSBE-së, Romë, 1993, Dokumenti i Samimit të Budapestit, 1994 dhe nga Dokumenti i Samimit të Stambollit (Karta për Sigurinë Europiane), 1999.

Fillimisht ODIHR u krijua si Zyra për Zgjedhje të Lira me anë të një vendimi të marrë në Samitin e Parisit më 1990 nga paraardhësi i OSBE-së, Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (KSBE). Mandati fillestar i Zyrës ishte nxitja e zbatimit të zotimeve të OSBE-së dhe, konkretisht, i atyre që kishin të bënin me zgjedhjet demokratike. Fill pas krijimit të saj, kjo Zyrë nisi të ndër marrë një sërë veprimtarish në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve, ndonëse në një shkallë ende të vogël.

Zyra ndërroi emër dhe u riquajt Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut në vitin 1992, kur u shtuan përgjegjësitë në lidhje me elementë të tjerë të dimensionit njerëzor. Në vitin 1993, në mbledhjen e Këshillit të KSBE-së në Romë, u mor vendimi për të rritur rolin e ODIHR-it nëpërmjet “monitorimit tërësor të zgjedhjeve”.<sup>6</sup> Një vit më pas, duke patur parasysh se një proces zgjedhor është një ngjarje që zgjat më shumë një ditë, në Samitin e Budapestit u vendos që ODIHR të “luajë një rol përforcues në vëzhgimin e zgjedhjeve para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor.”<sup>7</sup> Samiti i Budapestit i ngarkoi ODIHR-it gjithashtu detyrën e vlerësimit të kushteve për një funksionim të lirë e të pavarur të medias në lidhje me procesin zgjedhor.

Në Kartën për Sigurinë Europiane të miratuar në Samitin e OSBE-së në Stamboll më 1999, vendet anëtare u angazhuan posaçërisht të ftonin ODIHR-in për të vëzhguar zgjedhjet në vendet e tyre. Duke pranuar, në të njëjtin dokument, se vëzhgimi i zgjedhjeve nuk është qëllim në vetvete, por se synon përmirësimin e praktikave elektorale, vendet anëtare u zotuan të merrnin përsipër edhe një angazhim tjetër të rëndësishëm: “Ne pranojmë të vemë menjëherë në jetë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet.”<sup>8</sup>

## 2.4 Kur duhet vëzhguar

Samiti i Budapestit i vitit 1994 i vuri si detyrë ODIHR-it të hartonte një “kalendar për zgjedhjet e ardhshme.”<sup>9</sup> Të gjitha vendeve anëtare të OSBE-së iu kërkua të informonin ODIHR-in lidhur me zgjedhjet e tyre të ardhshme, si dhe t’i dërgonin atij në kohën e duhur një ftesë për vëzhgimin e tyre, mundësisht tri muaj përpara ditës së zgjedhjeve. Duke qenë se çdo vit organizohen një numër i madh zgjedhjesh brenda hapësirës së OSBE-së në nivel vendi dhe në nivele të tjera, ODIHR-it i duhet të përcaktojë përparësitë e tij në lidhje me vëzhgimin e proceseve të ndryshme zgjedhore, duke mbajtur parasysh burimet që ka në dispozicion.

Veprimtaritë për vëzhgimin e zgjedhjeve nga ana e ODIHR-it financohen nga buxheti i OSBE-së, i cili miratohet me konsensus nga shtetet anëtare të OSBE-së. Kjo gjë nënkupton nevojën për një shpërndarje të kujdesshme të burimeve, çka do të thotë se ODIHR shqyrton me vëmendje veprimtaritë e mundshme të vëzhgimit në mënyrë që ato të kenë ndikimin më të madh të mundshëm në çuarjen përpara të demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Kësodore, vëzhgimi i zgjedhjeve në vendet me demokraci të reja ose në zhvillim e sipër mbetet

<sup>6</sup> Dokument i Takimit të Katërt të Këshillit të KSBE-së, Romë, 1993, Vendimet, Kreu IV, Paragrafi 4. Teksti i këtij dokumenti si dhe i dokumenteve të tjera të OSCE-së që iu referohemi në këtë manual mund të gjenden në faqene OSCE-së [www.osce.org](http://www.osce.org). Një dokument me angazhimet e OSCE-së për çështjet lidhur me të drejtat e njeriut, duke përfshirë këtu edhe zgjedhjet, gjendet në *OSCE Human Dimension Commitments* [Angazhime të OSCE-së në dimensionin njerëzor], Botimi i dytë (Varshavë, OSBE/ODIHR, 2001). Ky dokument mund të gjendet edhe në faqen e ODIHR-it [www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr).

<sup>7</sup> Dokumenti përmbyllës i Budapestit, Vendime, Kreu VIII, Paragrafi 12.

<sup>8</sup> Karta për Sigurinë Europiane, Stamboll, Paragrafi 25.

<sup>9</sup> Kalendari mund të gjendet në faqen e ODIHR-it [www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr).

përparësi, duke qenë se, përgjithësisht, këto vende janë më të prirura për të përfitur sa më shumë nga vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve dhe nga rekomandimet e nxjerra prej tyre.

Në përgjithësi, ODIHR përqëndrohet tek zgjedhjet e drejtpërdrejta për institucionet shtetërore në nivel vendi. Gjithsesi, vitet e fundit, duke iu përmbajtur edhe Paragrafit 8 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990, ODIHR është marrë edhe me vëzhgimin e zgjedhjeve në nivel bashkie dhe rrethi. Po kështu janë vëzhguar edhe një numër i kufizuar referendumesh.

Në një sërë rastesh, ODIHR mund të marrë vendim edhe të mos i vëzhgojë zgjedhjet për arsye të mëposhtme: kur një vlerësim paraprak tregon se vendi anëtar përkatës i ka kryer zgjedhjet në përputhje me zotimet e OSBE-së; kur kuadri ligjor ose kushtet e përgjithshme për të kryer zgjedhje të vërteta demokratike në përputhje me angazhimet e OSBE-së nuk janë ashtu siç duhen; ose kur faktorët e sigurisë, ose aspekte të tjera, nuk krijojnë as kushtet minimale të nevojshme për të zhvilluar një vëzhgim efektiv të procesit zgjedhor.

## 2.5 Miratimi i Metodologjisë së Vëzhgimit të ODIHR-it

Metodologjia e zakonshme e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve parashtrohet në kapitujt 6-15 të këtij manuali. E megjithatë, përvec misioneve të zakonshme të vëzhgimit të zgjedhjeve (shih Kap 6), ODIHR e ka përshtatur metodologjinë e vet të vëzhgimit të zgjedhjeve me synimin për t'iu përgjigjur siç duhet rrethanave të veçanta që mund të shfaqen në kontekstin e vëzhgimit të zgjedhjeve. Të gjitha këto përshtatje jepen në seksionet në vijim.

### 2.5.1 Misione vëzhgimi zgjedhore pa vëzhgues afatshkurtër

Disa misione vëzhgimi përbëhen vetëm nga ekipe afatgjatë, pa praninë e vëzhguesve afatshkurtër ditën e zgjedhjeve. Kjo gjë ka ndodhur në ato vende ku përvojat e kaluara ose misioni i vlerësimit të nevojave (shih kapitulli 5) tregojnë se ka fare pak gjasa që të ketë probleme serioze ditën e votimeve në qendrat e votimit, por ku, megjithatë, vëzhgimi afatgjatë i procesit mund të japë rekomandime të dobishme. Po ashtu, një mision mund të mos dërgojë vëzhgues afatshkurtër kur është e qartë qysh në krye të procesit, ose kur bëhet e qartë gjatë tij, se nuk janë krijuar kushtet e duhura për një ditë normale votimi.

### 2.5.2 Misionet e vlerësimit zgjedhor

Një tjetër nismë e ndërmarrë nga ODIHR për të përmbushur mandatin e vet ka qenë edhe dërgimi i misioneve të vlerësimit zgjedhor. Një mision vlerësimi normalisht dërgohet për të vlerësuar zgjedhjet në vendet me demokraci të zhvilluara, ose në vende më të konsoliduara, dhe përqëndrohet në çështje konkrete dhe në zbatimin e praktikave më të mira. Duke qenë se demokracitë e stabilizuara zakonisht kanë praktika zgjedhore të sprovuara më së miri, që gëzojnë besimin e plotë të elektoratit në vendet e tyre, si dhe një media të lirë e të shëndoshë, e cila është në gjendje të identifikojë mangësitë e shfaqura në procesin zgjedhor e t'i shtrojë ato për debat publik, misionet e vlerësimit mund t'i realizojnë objektivat e tyre thelbësorë me një kosto minimale, pa qenë nevoja për praninë afatgjatë ose dërgimin sistematik të vëzhguesve ditën e zgjedhjeve.

Përgjithësisht, misioni i vlerësimit përbëhet nga një ekip ekspertësh, i cili viziton një vend për një periudhë relativisht të shkurtër kohore para dhe gjatë ditës së zgjedhjeve. Misioni i vlerësimit nuk rreket të bëjë komente shterruese rreth një procesi zgjedhor, ashtu siç vepron misioni i vëzhgimit, dhe ka një prani të kufizuar në qendrat e votimit ditën e votimit. Sidoqoftë,

---

misioni i vlerësimit mund të trajtojë çështje që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor dhe probleme të përgjithshme të karakterit administrativ rreth mbarëvajtjes së zgjedhjeve, çështje që lidhen me zgjedhjet si në rrafshin shtetëror, ashtu edhe në atë rajonal, pa lenë mënjanë edhe trajtimin në shkallë të kufizuar të procedurave të qendrave të votimit. Rekomandimet jepen kur shihet e nevojshme.

### **2.5.3 Ekipet mbështetëse me ekspertë**

Në ato raste kur ODIHR nuk ka ndërmend të vëzhgojë ndonjë proces zgjedhor të veçantë, mund të dërgojë edhe një ekspert të vetëm ose një ekip të vogël ekspertësh për të mbështetur misionin e OSBE-së që gjendet në terren, kur kjo është e mundur të bëhet. Roli i tyre është që të jenë të pranishëm para, gjatë, dhe fill pas zgjedhjeve në mënyrë që të përforcojnë kapacitetet e misionit për të raportuar rreth zgjedhjeve nëpërmjet kanaleve të zakonshme të raportimit. Ekipi i ekspertëve më së shumti dërgohet në rastet e zgjedhjeve bashkiake, ose në rast të ndonjë referendumi, kur ODIHR nuk ka ndërmend t'i vëzhgojë ato në shkallë të gjerë.





# 3.

## Parimet universale të zgjedhjeve dhe të drejtave të njeriut



Të gjitha shtetet anëtare të OSBE-së kanë rënë dakord se “Vullneti i popullit i shprehur në mënyrë të lirë e të ndershme nëpërmjet zgjedhjeve të vërteta periodike përbën bazën e autoritetit dhe legjitimitetit të një qeverie.” Për rrjedhojë, zgjedhjet e vërteta janë një e drejtë bazë e njeriut dhe element themelor i demokracisë. Misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it i vlerësojnë proceset zgjedhore në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe me parimet universale të zgjedhjeve demokratike. Për shembull, në qoftë se shtetet janë palë në traktatet e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara, ose në instrumentë të tjerë ligjorë ndërkombëtarë që kanë të bëjnë me zgjedhjet (fjala vjen, Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore), respektimi nga ana e tyre e këtyre parimeve është diçka që gjithashtu merret parasysh.

### 3.1 Parimet universale

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila është pranuar nga të gjitha vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara, përcakton të drejtën universale për zgjedhje të vërteta. Neni 21 i Deklaratës Universale thotë se, “Cdonjëri ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tij drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur me vullnet të lirë.” I njëjti nen përcakton gjithashtu se zgjedhjet e lira janë baza e vetme për autoritetin e një qeverie: “Vullneti i popullit duhet të jetë baza e autoritetit të qeverisë; ky vullnet duhet shprehur nëpërmjet zgjedhjeve periodike të vërteta, të cilat lypset të jenë të përgjithshme e të barabarta, me votim të fshehtë ose nëpërmjet procedurave të barasvlefshme të votimit të lirë.”

Si shtojcë e nenit 21, i cili lidhet konkretisht me zgjedhjet, Deklarata Universale parashtron një listë me të drejta që kanë të bëjnë me proceset zgjedhore, duke përfshirë këtu lirinë e shprehjes, të shoqatave, e të mbledhjeve.

Të drejtat e parashtruara në Deklaratën Universale rimerren e shtjellohen më gjerësisht në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), që është një traktat i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, i ratifikuar nga pothuajse të gjithë vendet

anëtare të OSBE-së. Duke qenë traktat, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike përbën një detyrim ligjor për shtetet, të cilët janë të detyruar t'i përmbahen klauzolive të saj. Neni 25 i kësaj Konvente i njehtë drejtën çdo qytetari, pa dallim, të votojë dhe të konkurrojë për në administratën publike. ICCPR-ja gjithashtu kodifikon dhe shtjellon më tej një numër të madh të drejtash civile dhe politike të mishëruara në Deklaratën Universale.

Instrumente të tjerë të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut mbartin klauzola të posaçme për të drejtat zgjedhore, si dhe për të drejtat e njeriut në përgjithësi, që mund të lidhen me zgjedhjet. Për shembull, neni 5 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD) i garanton gjithkujt, pa kurrfarë dallimi ose diskriminimi, "Të drejtat politike dhe, në mënyrë të veçantë, të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje – për të votuar e për t'u votuar..." Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW), në nenin 7 të saj, u siguron grave të drejtën për të marrë pjesë në jetën politike dhe në zgjedhje me të njëjtat të drejta si edhe burrat. Pothuaj të gjitha vendet anëtare të OSBE-së i kanë ratifikuar CERD-in dhe CEDAW-un dhe janë të detyruar të respektojnë klauzolat e tyre. Parimet Udhëheqëse të Kombeve të Bashkuara për të Shpërngulurit Brenda Vendit shprehin se personat e shpërngulur brenda një vendi kanë të njëjtat të drejta si edhe qytetarët e tjerë, duke përfshirë konkretisht të drejtën për të votuar dhe për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit ose në çështje publike.

### 3.2 Angazhimet e OSBE-së

Vendet anëtare të OSBE-së janë zotuar të respektojnë një spektër të gjerë standardesh për përkrahjen, mbrojtjen dhe çuarjen përpara të të drejtave të njeriut në suazë të qeverisjes demokratike.<sup>10</sup> Pjesa më e madhe e angazhimeve bazë që lidhen në mënyrë konkrete me zgjedhjet gjenden në paragrafët 6-8 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990, ndonëse në të gjenden edhe një sërë angazhimesh të tjera me peshë që prekin një hark të gjerë të drejtash civile e politike, çështje të shtetit të së drejtës dhe klauzola të mosdiskriminimit që mbahen kurdoherë parasysh nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve.<sup>11</sup> Të gjithë vëzhguesit duhet t'i bëjnë të tyret këto angazhime, teksti i plotë i të cilave gjendet në Aneksin A. Shkurtimisht, angazhimet kërkojnë nga shteti:

- Të mbajë zgjedhje të lira në intervale të arsyeshme kohore;
- Të lejojë që të gjithë anëtarët, të paktën e një prej dhomave të parlamentit, të zgjidhen me votim popullor;
- Të garantojë të drejtën e votimit të përgjithshëm e të barabartë;
- Të respektojë të drejtën e qytetarëve për t'u zgjedhur;
- Të respektojë të drejtën për të krijuar parti politike si dhe të sigurojë që të gjitha partitë të konkurojnë mbi bazën e trajtimit të barabartë para ligjit si dhe nga ana e autoriteteve;
- Të sigurojë që fushata politike të zhvillohet në një atmosferë të lirë e të ndershme pa ndërhyrje të administratës, pa ushtrim dhune, kërcënime ose frikësime për ndëshkime kundër kandidatëve, partive ose votuesve;
- Të sigurojë akses të lirë për të gjitha organet e medias pa asnjë diskriminim;

<sup>10</sup> Shih *OSCE Human Dimension Commitments* [Angazhime të OSCE-së në dimensionin njerëzor], vep. e cit. Shën. 6.

<sup>11</sup> Dokumenti i Takimit të Kopenhagenit për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së. Kopenhagen 1990.

- Të sigurojë që votimi të jetë i fshehtë dhe që votat të mund të numërohen dhe të raportohen me ndershmëri, si dhe që rezultati të bëhet publik në kohën e duhur; dhe,
- Të sigurojë që kandidatët, të cilët kanë fituar numrin e nevojshëm të votave për t'u zgjedhur, të marrin vendin që u takon dhe të lejohen të rrinë në atë vend deri sa t'u mbarojë afati.

Veç kësaj, paragrafi 8 i Dokumentit të Kopenhagenit i vitit 1990, shprehet se prania e vëzhguesve, si të huaj ashtu edhe vendas, mund t'i japë më shumë integritet procesit zgjedhor. Dokumenti përfshin edhe një ftesë që u drejtohet shteteve anëtare, organizatave dhe institucioneve private përkatëse të vëzhgojnë procedurat e proceseve zgjedhore kombëtare.

Dokumente të tjerë të OSBE-së përfshijnë angazhime të mëtejshme lidhur me zgjedhjet. Për shembull, Deklarata e Samitit të Lisbonës e vitit 1996 i citon mashtrimet zgjedhore si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si një çështje sigurie rajonale, dhe i angazhon të gjithë shtetet pjesëmarrës ta trajtojnë këtë problem të njohur. Dokumenti i miratuar në Samitin e Stambollit më 1999, përforcon zotimin e shteteve anëtare të OSBE-së për të zhvilluar zgjedhje të lira e të ndershme dhe i angazhon të gjithë këto vende të sigurojnë të drejta të plota për personat që u përkasin pakicave si dhe t'u mundësojnë refugjatëve të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje në vendet prej nga vijnë. Siç thuhet në kapitullin 2 të këtij manuali, vendet anëtare janë po ashtu të angazhuara të ndjekin pa ngurrim zbatimin e vlerësimeve dhe rekomandimeve të ODIHR-it.

### 3.3 Detyrime të tjera ndërkombëtare

Pjesa më e madhe e vendeve anëtare të OSBE-së janë gjithashtu anëtarë të Këshillit të Europës dhe, për rrjedhojë, kanë detyrime që rrjedhin nga Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ECHR) dhe Prokollit e saj, si dhe nga traktate të tjera të miratuara nga Këshilli i Europës.<sup>12</sup> Neni 3 i Protokollit të Parë të ECHR ju kërkon shteteve anëtare "Të zhvillojnë zgjedhje të lira në intervale kohore të arsyeshme, nëpërmjet votimit të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimeve të njerëzve në zgjedhjet parlamentare." Në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, që janë edhe anëtare të Këshillit të Europës, çdo individ mund t'i drejtohet Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke i kërkuar asaj të shqyrtojë shkeljet e kryera gjatë zgjedhjeve, me kusht që ndërkohë ata t'i kenë përdorur të gjitha mjetet ligjore të vendit.

Edhe Bashkimi Europian ka miratuar po ashtu traktate me klauzola që bëjnë fjalë për zgjedhje të lira, duke përfshirë këtu Traktatin për Bashkimin Europian dhe Kartën e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore. Këto traktate janë të detyrueshme vetëm për vendet anëtare të Bashkimit Europian. Çështjet që kanë të bëjnë me demokracinë janë vendosur në qendër të marrëdhënieve midis BE-së dhe partnerëve të saj, duke qenë se konsolidimi i institucioneve demokratike dhe i të drejtave të njeriut është një vlerë e përbashkët dhe përbën të njëjtin interes për të cilin të gjitha palët kanë rënë zyrtarisht në ujd.

<sup>12</sup> Dokumentet e Këshillit të Europës mund të gjenden në faqen e tij në [www.coe.int](http://www.coe.int).

Bashkësia e Shteteve të Pavarura dhe Organizata e Shteteve Amerikane gjithashtu kanë miratuar standardet për zgjedhje të detyrueshme për të gjithë vendet pjesëmarrëse të OSBE-së, të cilat i kanë ratifikuar ato.

### 3.4 Pasojat praktike

Paragrafët që vijojnë parashtrojnë në mënyrë të përmblendhur disa prej koncepteve kyç të mishëruara në parimet universale, në zotimet e OSBE-së dhe në detyrime të tjera ndërkom-bëtare, të cilave misionet e vëzhgimit lypset t'u kushtojnë vëmendjen më të madhe, duke përfshirë këtu: zgjedhjet periodike, zgjedhjet e vërteta, zgjedhjet e lira, zgjedhjet e ndershme, votimin e përgjithshëm e të barabartë, votimin e fshehtë, si dhe numërimin e ndershëm dhe bërjen të ditur të rezultateve. Qeveria e çdo vendi është përgjegjësja kryesore dhe duhet të sigurojë respektimin e plotë të këtyre zotimeve.

**ZGJEDHJET PERIODIKE** bëjnë të mundur që zgjedhjet të zhvillohen në intervale të rregullta kohore, siç përcaktohet me ligj. Periudha kohore midis dy zgjedhjeve nuk duhet të tejzgjatet në mënyrë të paarsyeshme. Përgjithësisht, brenda për brenda hapësirës së OSBE-së, shtatë vjet konsiderohen si maksimumi i arsyeshem kohor midis dy zgjedhjeve për shefin e ekzekutivit, ndonëse pjesa më e madhe e vendeve kanë zgjedhur një interval kohe ndërzgjedhor që shkon nga katër deri në pesë vjet. Periudha pesëvjeçare përgjithësisht shihet si maksimumi i arsyeshem kohor për zgjedhjet për dhomën e ulët të parlamentit.

**ZGJEDHJET E VERTETA** nënkuptojnë që procesi zgjedhor të kryhet në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, si dhe të sigurojë mundësi reale që votuesit të bëjnë zgjedhje të mirinformuara, duke siguruar kështu besimin e përgjithshëm të elektoratit. Koncepti i zgjedhjeve të vërteta mund të vihet në pikëpyetje në qoftë se nuk respektohen të drejtat dhe liritë themelore, në qoftë se nuk ka një garë të besueshme politike, në qoftë se ekzistojnë kufizime të paarsyeshme për krijimin dhe jetën e partive politike, ose po qe se nuk ekziston kurrfarë perspektive kuptimplotë që votuesit nëpërmjet votës së tyre të kenë mundësi të kryejnë ndërrimin e pushteteve.

**ZGJEDHJET E LIRA** kërkojnë që të gjithë qytetarët të gëzojnë të drejtat e tyre themelore të lirisë së shprehjes, shoqatava, mbledhjes dhe lëvizjes së lirë. Të gjithë votuesit duhet të ndjehen të aftë ta hedhin votën e tyre pa frikën e kërcënimeve, dhunimeve, pa qeenë nën trusni administrative, ose nën frikën e ndëshkimit. Kurrfarë pengese nuk duhet të ketë në rrugën e kandidatëve për të shpalosur lirshëm pikëpamjet e tyre ose që t'i ndalojë votuesit të angazhohen në veprimtari të fushatës zgjedhore si dhe të mësojnë rreth kandidatëve ose të diskutojnë rreth pikëpamjeve të tyre. Media duhet të jetë në gjendje ta mbulojë fushatën lirshëm, pa kurrfarë ndërhyrjesh ose kufizimesh të paarsyeshme të imponuara nga autoritetet. Vëzhguesit vendas, si ata të partive (përfaqësues të kandidatit ose të partisë) ashtu edhe ata që nuk janë të partive, lypset të jenë të lirë ta vëzhgojnë procesin zgjedhor në të gjitha fazat e tij, para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve. Tabelëzimi i rezultateve duhet të jetë i dukshëm dhe i verifikueshëm, duke nisur nga qendra e votimit për të kaluar më pas në të gjitha nivelet e e ndërmjetme të administratës zgjedhore, për të mbërritur më në fund tek autoriteti zgjedhor kombëtar.

**ZGJEDHJET E NDRSHME** lypset të garantojnë kushte të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Kuadri ligjor duhet të pasqyrojë angazhimet e OSBE-së dhe parimet e tjera universale, ndaj dhe të gjitha ligjet e lidhura me zgjedhjet duhet të zbatohen dhe të jenë të zbatueshme jo në mënyrë të përzgjedhur. Të gjithë kandidatët, partitë dhe organizatat politike që dëshirojnë të hyjnë në garë, lypset të jenë në gjendje ta kryejnë këtë gjë, si dhe të konkurrojnë mbi bazën e trajtimit të barabartë e të paanshëm nga ana ligjore, dhe nga ana e autoriteteve. Kandidatët dhe partitë politike lypsen të kenë akses të lirë në media, pa asnjë dallim, ndërkohë që media shtetërore duhet t'i përmbushë përgjegjësitë e veçanta që ka për të dhënë një informacion të mjaftueshëm e të drejtpeshuar, në mënyrë që t'i japë mundësi elektoratit të bëjë zgjedhje të mirinformuara. Rregullat e financimit të fushatës nuk duhet të favorizojnë ose të diskriminojnë një parti ose kandidat në kurriz të një tjetri. Në këtë proces, duhet të ketë një ndarje të qartë midis shtetit dhe partive politike, ndërsa burimet publike lypset të përdoren në mënyrë të ndershme dhe jo në të mirën e një kandidati ose grupi kandidatësh. Administrata zgjedhore në të gjitha nivelet duhet të veprojë në mënyrë profesionale dhe të paanshme, ndërkohë që procesi i të votuarit, numërimit dhe tabelëzimit të votave duhet të mbrohet nga manipulimet dhe shpërdorimet. Kandidatët, partitë dhe votuesit duhet të kenë të gjitha mundësitë për një ankimim të atypëratyshëm e efektiv, duke përfshirë këtu edhe përdorimin e gjyqësorit të pavarur në rast të shkeljes së ligjit ose dhunimit të të drejtave të njeriut. Të gjithë ata që janë përgjegjës për shkeljen e ligjit duhet të përgjigjen para tij në kohën e duhur. Kandidatët që përfitojnë numrin e duhur të votave për t'u zgjedhur, duhet të marrin detyrën siç e kërkon ligji.

**VOTIMI I PËRGJITHSHËM** kërkon që të gjithë qytetarëve, të aftë sipas ligjit, t'u jepet e drejta e votës. Procedura e regjistrimit të votuesve duhet të jetë efektive, e paanshme, jo diskriminuese dhe e saktë, duke u garantuar të gjithë qytetarëve, të aftë sipas ligjit, të drejtën për të votuar dhe ua mbron këtë të drejtë kundër votimit në grup. Nuk duhet kurrësi të vendosen taksa për votimet ose pagesa të gjithfarësojshme për regjistrimin. Gjithashtu, nuk duhet të ketë kurrfarë kufizimesh në procesin e votimit për persona që u përkasin pakicave kombëtare, që janë gra, ose që u takojnë grupeve të ndryshme qytetarësh. Të gjithë votuesit, duke përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara fizike, lypset të kenë akses të pacenuar në qendrat e votimit ose në procedurat e tjera të votimit. Gjithashtu, duhet të ketë klauzola të përcaktuara për personat e zhvendosur brenda vendit. Lypset të bëhen përpjekje për të siguruar klauzola të përshtatshme për votimin jashtë vendit. Kufizimet e të drejtave politike dhe civile të gjithë personave të dënuar për krime duhen të jenë proporcionale me veprën penale, ndërsa e drejta e votimit duhet t'i kthehet automatikisht çdokujt që e ka kryer dënimin.

**VOTIMI I BARABARTË** nënkupton që vota e çdo qytetari të ketë të njëjtën vlerë. Kjo do të thotë që në sistemet me përfaqësim proporcional, numri i përfaqësuesve për çdo rreth duhet të jetë proporcional me numrin e zgjedhësve dhe se pragu për të hyrë në parlament nuk duhet të jetë aq i lartë sa të mos marrë parasysh zgjedhjet politike të një numri relativisht të madh zgjedhësish. Në sistemet maxhoritare, votim i barabartë do të thotë që numri i banorëve të zonave zgjedhore të jetë përafërsisht i barabartë; ndryshime që e kalojnë 10 përqindshin përbëjnë arsye për t'u shqetësuar.

**VOTIMI I FSHEHTË** kërkon domosdoshmërisht që votuesit ta vënë vetë shenjën në fletën e votimit, në intimitetin e një kabine votimi të sigurtë dhe në mënyrë që fleta e shenjuar të mos shi-

het para se votuesi ta hedhë atë në kutinë e votimit, si dhe të mos identifikohet me një votues të caktuar. Prania e më shumë se një personi në kabinën e votimit nuk duhet lejuar, duke qenë se komprometon fshehtësinë e votës. Përrjashtime mund të bëhen vetëm në kushte të veçanta dhe me kërkesë të votuesve të cilët kërkojnë ndihmë, p.sh. në rastet kur votuesit janë analfabetë ose me aftësi të kufizuara. Çdo votim jashtë një kabine votimi komprometon fshehtësinë e votës. “Votimi në grup”, votimi i përbashkët i anëtarëve të një familjeje, votimi i hapur, ose votimi i jashtëligjshëm me ndërmjetës përbëjnë shkelje të rënda të parimit të fshehtësisë së votës. Përgatitjet për votim nga pjesëtarët e një njësie ushtarake dhe, në ato raste kur lejohet, nga të burgosurit, duhet të bëjë të mundur që votimi të jetë i fshehtë dhe të mos i nënshtrohet trusnive, ndërkohë që votimi i ushtarëve do të ishte ideal po qe se do të realizohej tok me popullsinë civile, ndërkohë që votimi i veçantë në qendra votimi vetëm për ushtarakët të kryhej vetëm në raste të jashtëzakonshme. Asnjë qendër votimi nuk duhet të jetë aq e vogël sa që njoftimi i rezultatit të komprometonte fshehtësinë e votës (çka mund të përbëjë ngandonjëherë problem në ato raste kur votohet në reparte ushtarake, burgje ose në përfaqësitë diplomatike jashtë vendit).

# 4.

## Kuadri praktik për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve



Kuadri praktik për vëzhgimin e zgjedhjeve mbështetet në kushtet minimale - siç vijojnë më poshtë - për një vëzhgim sa më efektiv, i cili pritet të sigurohet nga qeveria e vendit pritës, si dhe në Kodin e Sjelljes së Vëzhguesve të OSBE-së, që duhet ta zbatojnë vëzhguesit.

### 4.1 Kushtet për një vëzhgim sa më të efektshëm

Që të kryejë një vëzhgim sa më të efektshëm, ODIHR kërkon garanci nga qeveria e vendit pritës në mënyrë që misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve të mund të plotësojë detyrat e veta në kohë e siç duhet, dhe më konkretisht:

- Krijimin e misionit brenda një afati kohor që lejon vëzhgimin e të gjitha fazave të procesit zgjedhor;
- Të vendosë sipas mundësive për numrin e vëzhguesve të nevojshëm për të pasur një mision vëzhgimi të frytshëm;
- Të marrë akreditimin për të gjithë vëzhguesit nëpërmjet një procedure të thjeshtë dhe jo diskriminuese;
- Të sigurojë të gjithë informacionin e duhur nga autoritetet vendore në të gjitha nivelet përsa i takon procesit zgjedhor, në kohë e siç duhet;
- Të takohet me kandidatë, anëtarë të të gjitha partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile dhe individë të tjerë sipas zgjedhjes së bërë vetë;
- Të jetë i lirë të udhëtojë në të gjitha krahinat e vendit gjatë procesit zgjedhor dhe ditën e zgjedhjeve, pa kurrfarë kufizimesh dhe pa qenë i detyruar të njoftojë paraprakisht;
- Të hyjë lirisht në të gjitha qendra e votimit, komisionet zgjedhore, si dhe në qendrat e numërimit e tabelëzimit në të katër anët e vendit; dhe
- Të ketë mundësi të bëjë deklaratata publike.

Atje ku këto rrethana nuk ekzistojnë, kushtet për të pasur një vëzhgim sa më të efektshëm në thelb nuk janë plotësuar.

#### 4.2 Kodi i Sjelljes së Vëzhguesit

Kodi i Sjelljes së Vëzhguesit u hartua për të siguruar që të gjithë pjesëtarët e një misioni vëzhgues zgjedhor të veprojnë në bazë të standardeve më të larta profesionale dhe personale, si dhe të sillen në mënyrë të atillë që t'i shkojë për shtat rolit të vëzhguesit të pavarur e të paanshëm. Roli i vëzhguesit është i kufizuar dhe ka të bëjë vetëm me vëzhgimin dhe raportimin, për rrjedhojë një vëzhgues nuk është i autorizuar të udhëzojë, ndihmojë, ose të ndërhyjë në votim, numërim, tabelëzim, ose në aspekte të tjera të procesit zgjedhor. Kodi i Sjelljes së Vëzhguesit është i detyrueshëm për të gjithë vëzhguesit e ODIHR-it; çdo shkelje serioze e Kodit do të shpjerë në heqjen e akreditimit të vëzhguesit.

#### KODI I SJELLJES SË VËZHguesVE TE OSBE/ODIHR

- Vëzhguesit duhet të jenë rreptësisht të paanshëm në kryerjen e detyrave të tyre dhe nuk duhet kurrsesi e në asnjë rast të shprehen publikisht, ose të mbajnë anë, apo të shfaqin preferenca në marrëdhëniet me autoritetet kombëtare, partitë, kandidatët, ose për çështje që lidhen me procesin zgjedhor.
- Vëzhguesit duhet t'i kryejnë detyrat e tyre me kujdes dhe nuk duhet të ndërhyjnë në procesin zgjedhor. Vëzhguesit mund të ngrënë çështje me zyrtarët zgjedhorë, si dhe të sjellin në vëmendjen e tyre parregullsi të ndryshme, por nuk duhet kurrsesi e në asnjë rast të japin udhëzime ose të prapësojnë vendimet e marra prej zyrtarëve vendorë.
- Vëzhguesit duhet të qëndrojnë në krye të detyrës gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve, duke përfshirë këtu edhe gjatë numërimit të votave dhe, po qe se janë udhëzuar, gjatë fazës së mëpastajme, atë të tabelëzimit.
- Vëzhguesit duhet t'i mbështesin të gjitha përfundimet e arritura në vëzhgime vetjake ose në fakte e dëshmi të qarta dhe bindëse.
- Vëzhguesit nuk duhet të bëjnë as edhe një koment në media lidhur me procesin zgjedhor ose rreth brendisë së vëzhgimeve të tyre, ndërkohë që çdo komunikim me median duhet të bëhet brenda kuadrit të informacionit të përgjithshëm, rreth misionit të vëzhgimit dhe rolit të vëzhguesit.
- Vëzhguesit nuk duhet të ndërmarrin rreziqe të panevojshme e të palejueshme. Siguria vetjake e çdo vëzhguesi është më e rëndësishme se gjithçka tjetër.
- Vëzhguesit duhet të mbajnë me vete një kartë identifikimi të lëshuar nga qeveria e vendit pritës ose nga komisioni zgjedhor dhe duhet të vetidentifikohen pas çdo kërkesë të bërë nga autoritetet vendase.
- Vëzhguesit duhet të veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet dhe normat e vendit.
- Vëzhguesit duhet të shfaqin maturi të madhe dhe sjellje profesionale gjatë gjithë kohës.
- Vëzhguesit duhet të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet për dhënien e udhëzimeve ose shkëmbimin e të dhënave e mendimeve, si dhe janë të detyruar t'i nënshtrohen planit të veprimit dhe të gjitha udhëzimeve të tjera të nxjerra nga Misioni i Vëzhgimit Zgjedhor të OSBE/ODIHR-it.



---

Në përputhje me Kodin e Sjelljes së Vëzhguesit, prej të gjithë vëzhguesve kërkohet të respektojnë e zbatojnë udhëzuesit e OSBE-së lidhur me mjedisin profesional të punës, i cili e ndalon rreptësisht diskriminimin ose ngacmimin seksual. Në varësi nga vendi ku do të veprojnë, misionet e vëzhgimit zgjedhor mund të nxjerrin edhe rregulla shtesë ose udhëzues të detyrueshëm për të gjithë vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it.



# 5.

## Përgatitjet për vëzhgim: Misioni i vlerësimit të nevojave



Hapi fillestar për krijimin e një misioni vëzhgimi të zgjedhjeve të ODIHR-it është dërgimi në terren i një misioni për vlerësimin e nevojave (MVN), çka zakonisht bëhet disa muaj para zhvillimit të zgjedhjeve në një vend të caktuar. MVN-ja vepron për një periudhë disa ditore dhe përbëhet nga anëtarë të Departamentit të Zgjedhjeve të ODIHR-it. Kryetari, zëvendëskryetari ose punonjësi i logjistikës, që mendohet të zgjidhen në një MVZ të mundshme mundet gjithashtu të marrin pjesë në mision bashkë me ekspertët përkatës, kur shihet e nevojshme.

Qëllimi i një MVN-je është të përcaktojë mundësitë e kryerjes së një misioni zgjedhor në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe, për rrjedhojë, të këshillojë drejtorin e ODIHR-it lidhur me veprimtarinë e propozuar të ODIHR-it. Gjithashtu MVN-ja sigurohet nëse qeveria e vendit pritës ka ndërmend të respektojë kushtet minimale për një vëzhgim sa më të efektshëm të zgjedhjeve.

Raporti i MVN-së, i cili u përcillet të gjitha vendeve anëtare, pasqyron konkluzionet e ODIHR-it lidhur me qëllimin dhe madhësinë e misionit të vëzhgimit që mendohet të krijohet. Nisur nga zbulimet e tij, në disa raste, MVN-ja mund të rekomandojë se nuk është i përshtatshëm apo i nevojshëm vëzhgimi i plotë i zgjedhjeve dhe, për pasojë, mund të bëjë thirrje për dërgimin e një misioni vëzhgimi zgjedhor të kufizuar ose të një misioni për vlerësimin e zgjedhjeve (shih Seksioni 2.5). Raporti i MVN-së përcakton gjithashtu edhe numrin e vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurtër, që vendeve anëtare do t'u kërkohet të vënë në dispozicion në mënyrë që të përmbushet misioni përkatës.

MVN-ja shërben gjithashtu për të vendosur qysh në krye një dialog me autoritetet kombëtare zgjedhore si dhe me institucionet e tjera të përfshira në procesin zgjedhor. Në përgjithësi, MVN-ja takohet me zyrtarët e lartë të administratës zgjedhore, me përfaqësues të qeverisë (Ministrisë së Jashtme dhe të gjitha dikastereve të angazhuara në zgjedhje, siç është Ministria e Brendshme dhe institucionet që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare ose të drejtat e njeriut), partitë politike, përfaqësuesit e medias, të organizatave të shoqërisë civile, misionit

të OSBE-së (kur gjykohet e nevojshme), ambasadave të vendeve anëtare të OSBE-së, si dhe të organizmave të tjerë ndërkombëtarë të interesuara për këtë proces.

MVN-ja bën një vlerësim paraprak:

- Të shkallës së zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga misionet e mëparshme të vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it;
- Të mjedisit parazgjedhor, duke përfshirë edhe faktin se deri në ç'skallë përkujdeset përgjithësisht qeveria lidhur me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme;
- Të kuadrit legjislativ dhe të të gjitha amendamenteve të bëra qysh nga zgjedhjet e fundit (kurdoherë që është e mundur ose e përshtatshme, ODIHR do të përgatisë një analizë të veçantë e të hollësishme të legjislacionit zgjedhor);
- Të përbërjes dhe strukturës së administratës zgjedhore, të shkallës së përgatitjeve të saj për zgjedhjet dhe të besimit të përgjithshëm publik dhe politik në punën e saj;
- Të statusit të mediave dhe rolit të tyre të pritshëm në procesin zgjedhor;
- Të çdo çështje tjetër që ka një farë peshe, siç është: përpilimi i regjistrit të votuesve, procesi i regjistrimit të kandidatëve/partive, pjesëmarrja e grave, përfshirja e minoriteteve, ose veprimtaria zgjedhore e organizatave të shoqërisë civile;
- Të dobisë, që sipas bashkëbiseduesve, mund të ketë dërgimi i një MVZ-je të ODIHR-it; dhe
- Të situatës së sigurisë në vend, për të parë nëse ajo lejon dërgimin e një misioni vëzhgimi.

# 6.

## Struktura e misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin zgjedhor



Misioni i vëzhgimit zgjedhor të ODIHR-it dërgohet nën direktivën e përgjithshme të drejtorit të ODIHR-it. Kreu i Departamentit të Zgjedhjeve të ODIHR-it përfaqëson drejtorin për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Kryetari i një MVZ-je emërohet nga drejtori i ODIHR-it dhe është njeriu përgjegjës për punën e zhvilluar çdo ditë nga misioni i vëzhgimit zgjedhor, në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Zgjedhjeve të ODIHR-it. Këshilltari i ODIHR-it për zgjedhjet, i ngarkuar si personi përgjegjës për një proces zgjedhor të caktuar, shërben si pikë ndërlidhjeje midis MVZ-së dhe ODIHR-it në Varshavë. Kryetarit të një misioni zgjedhor mund t'i kërkohet të udhëtojë nga qendra e misionit për në Varshavë ose anasjelltas për udhëzime dhe/ose për shkëmbime mendimesh.

Misioni i zakonshëm zgjedhor përbëhet nga një ekip bërthamë, nga vëzhgues afatgjatë (VAGJ) dhe nga vëzhgues afatshkurtër (VASH). Pjesëtarët e ekipit bërthamë merren nga një regjistër ekspertësh të ODIHR-it<sup>13</sup> dhe punësohen e kontraktohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, por ka raste që dërgohen nga vendet anëtare të OSBE-së sipas kërkesave të bëra nga ana e ODIHR-it. Për çdo proces zgjedhor të pritshëm, ODIHR u nis një notë-verbale të gjithë vendeve anëtare të OSBE-së, duke u kërkuar të dërgojnë vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër posaçërisht për atë proces zgjedhor.

Në ndonjë rast, për të patur misione të shumëllojta vëzhgimi zgjedhor, anëtarët e VAGJ-ëve dhe VASH-ëve mund të rekrutohen edhe nëpërmjet fondit të vullnetarëve të ODIHR-it, që u krijua në vitin 2001. Ky fond ka rëndësi të jashtëzakonshme për ODIHR-in në përpjekjet e tij për të përgatitur misione vëzhgimi zgjedhor me përbërje sa më të ndryshme, si dhe për të garantuar pjesëmarrjen e vëzhguesve në procese zgjedhore nga Europa Lindore e Qendrore dhe nga shtetet anëtare që janë pjesëtare të Bashkësisë së Shteteve të Pavarura. Kjo

<sup>13</sup> ODIHR-i rekomandon ekspertët e interesuar të freskojnë informacionin e tyre në bazën e të dhënave të ekspertëve të ODIHR-it, për ta ndihmuar këtë të fundit në lidhje me personelin e misioneve (baza e të dhënave mund të gjendet në faqen e ODIHR-it në internet: [www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr)).

gjë përfton një rëndësi të veçantë ngaqë lejon përfaqësimin në misionet vëzhguese të një shumëllojshmërie përvojash, shpesh nga ato vende anëtare që nuk dërgojnë rregullisht vëzhgues në zgjedhje.

Vëzhguesit zgjedhorë të ODIHR-it duhet të jenë qytetarë të shteteve anëtare të OSBE-së,<sup>14</sup> me përjashtim të vendeve pritëse. Duke qenë se anglishtja është gjuha e punës e misioneve të vëzhgimit zgjedhor të ODIHR-it, të gjithë anëtarët e MVZ-së, duke përfshirë si vëzhguesit afatgjatë dhe ata afatshkurtër, duhet të jenë të aftë të komunikojnë mirë në anglisht me gojë e me shkrim. Gjithsesi, aftësia për të komunikuar në një gjuhë të dytë, e cila përdoret gjerësisht në zonën ku do të kryhet vëzhgimi, përbën vlerë të shtuar.

Informacione konkrete për të gjitha misionet e vëzhgimit zgjedhor të ODIHR-it mund të gjenden në një faqe të veçantë në internet të krijuar enkas pas ngritjes së misionit.<sup>15</sup>

## 6.1 Ekipi bërthamë

ODIHR i vendos zyrat në kryeqytetin përkatës të vendit pritës, pak a shumë gjashtë deri më tetë javë para ditës së zhvillimit të zgjedhjeve, ku e ka qendrën edhe ekipi bërthamë i misionit vëzhgues zgjedhor. Zakonisht ekipi bërthamë përbëhet nga 10-12 ekspertë ndërkom-bëtarë, në varësi të madhësisë së misionit dhe rrethanave konkrete të procesit zgjedhor. Normalisht kryetari/kryetarja e misionit ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij/saj nga një zëvendëskryetar/e; në rastet kur bëhet fjalë për misione shumë të mëdha, mund të caktohet edhe më shumë se një zëvendëskryetar. Ekipi bërthamë ka dhe një analist të zgjedhjeve, një analist politik, një analist ligjor, një analist të medias, një analist statistikor, një koordinator të vëzhguesve afatgjatë, një punonjës për logjistikën, një punonjës për sigurinë, një punonjës për financat, si dhe një punonjës ndërlidhës me parlamentin, kur gjykohet e domosdoshme. Ngandonjëherë në përbërje të ekipit bërthamë caktohet edhe një ekspert për çështje gjinore ose për pakicat kombëtare, në mënyrë që të përforcohet analiza për këto çështje në kontekstin e zgjedhjeve. Detyrat e personelit të ekipit janë si më poshtë.

**KRYETARI I MISIONIT** është përgjegjës për punën e përditshme të misionit vëzhgues. Ai ose ajo drejton punën e misionit për vlerësimin e vazhdueshëm të shkallës së përputhjes së të gjitha aspekteve të procesit zgjedhor me legjisllacionin vendas, me angazhimet e OSBE-së, si dhe me parimet e tjera universale të zgjedhjeve demokratike.

Kryetari i misionit, në bashkëpunim dhe bashkëveprim të ngushtë me Departamentin e Zgjedhjeve të ODIHR-it, është përgjegjës për punën e misionit, duke përfshirë:

- Përgatitjet për raportet e brendshme ku përvijohen zhvillimet dhe çështjet më të rëndësishme të periudhës parazgjedhore;
- Vendosjen dhe ruajtjen e kontakteve me autoritetet, administratën zgjedhore, partitë kryesore politike, kandidatët, shoqërinë civile, grupet e tjera të vëzhgimit, bashkësinë e trupit diplomatik në vend, si dhe me organizatat ndërkombëtare;
- Mbikëqyrjen e punës së ekipit bërthamë, të ekipeve të misioneve VAGj dhe VASh;

<sup>14</sup> Në raste të veçanta, OSBE/ODIHR-i ka pranuar edhe vëzhgues afatshkurtër të ftuar nga vendet partnere për bashkëpunim të OSBE-së.

<sup>15</sup> Faqe individuale të MVZ në web mund të gjenden edhe në visin e ODIHR-it [www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr).

- Marrëdhëniet me median, duke përfshirë këtu edhe përgatitjen e njoftimeve publike të MVZ-së (në bashkëpunim me zëdhënësin e ODIHR-it);
- Dhënien e udhëzimeve dhe bashkëpunimin e ngushtë me delegacionet parlamentare (në ato raste kur gjykohet e udhës);
- Hartimin e një deklarate për konstatimet e përfundimet paraprake, si dhe nxjerrjen e njoftimit për shtyp, ngandonjëherë sëbashku me drejtuesit e delegacioneve të tjera të pranishme; dhe
- Përgatitjen e raportit përfundimtar që lypset të dalë afërsisht gjashtë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor.

Me të mbërritur në vendin pritës, ODIHR ose nxjerr një njoftim për shtyp ku njofton hapjen e misionit, ose kryetari i misionit jep një konferencë për shtyp për të paraqitur misionin dhe punën e tij. Konferenca e shtypit ofron mundësinë për të shpjeguar qëllimin e misionit dhe metodologjinë e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve, si dhe për të shprehur vullnetin e mirë të misionit për t'u takuar me të gjitha palët e interesuara e për të marrë sa më shumë informacione rreth procesit zgjedhor.

**ZËVENDËSKRYETARI I MISSIONIT** shërben kryesisht si shef i stafit për të siguruar një koordinim sa më të mirë të MVZ-së, për të ndihmuar kryetarin e misionit në detyrat e veta operacionale dhe administrative, si dhe përfaqëson kryetarin e misionit në ato raste kur gjykohet e udhës. Ndër detyrat e tjera, zëvendëskryetari mbikëqyr të gjithë aspektet e operacioneve të VAGJ-ve dhe VASH-ve, duke përfshirë përgatitjen e raportimeve të tyre, të një plani dislokimi të balancuar e të mirëpërfaqësuar, si dhe të shkëmbimit të informacionit. Ai mund të koordinojë hartimin e raporteve të brendshme sëbashku me kryetarin e misionit dhe Departamentin e Zgjedhjeve të ODIHR-it. Në MVZ të vogla, zëvendëskryetari mund të punojë në të njëjtën kohë edhe si një ekspert/analist, siç shpjegohet më poshtë.

**ANALISTI I ZGJEDHJEVE** vlerëson funksionimin e administratës zgjedhore të vendit pritës në përputhje me angazhimet e OSBE-së si dhe me një sërë parimesh të tjera universale. Ai është pika kryesore e kontaktit të MVZ-së me administratën zgjedhore dhe merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Komisionit Qendror Zgjedhor, ose organit ekuivalent, kurdoherë që e gjykon të nevojshme. Analisti i zgjedhjeve vlerëson efektivitetin e këtij organizmi, pavarësinë nga autoritetet e ekzekutivit, si dhe transparencën dhe paanshmërinë e tij. Analisti i zgjedhjeve është përgjegjës për vëzhgimin e regjistrimit të votuesve, regjistrimit të kandidatëve, rregullave dhe procedurave zgjedhore, formulimin grafik dhe shtypjen e fletëve të votimit, efektivitetin e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulta, si dhe për çështje të tjera të sferës së administratës zgjedhore. Analisti i zgjedhjeve mbikëqyr procedurat e numërimit dhe tabelëzimit dhe analizën mbledhjen e rezultateve përfundimtare, për të parë nëse janë në përputhje me rregullat ligjore dhe procedurat administrative. Analisti i zgjedhjeve punon nga afër me analistin ligjor lidhur me ankesat dhe apelimet për çështje që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

**ANALISTI LIGJOR** krijon ekspertizën për legjisllacionin dhe normat zgjedhore. Ai ose ajo vlerësojnë se deri në ç'shikallë legjisllacioni vendas dhe zbatimi i tij pajtohen me angazhimet e OSBE-së dhe parimet e tjera universale, dhe nëse është përdorur legjisllacioni vendas i tëri e në mënyrë të paanshme. Analisti ligjor ndjek të gjitha diskutimet lidhur me zgjedhjet, ankesat, proceset gjyqësore, si dhe me apelimet. Kjo gjë bën të mundur të vlerësohen mundësitë reale

ligjore që ekzistojnë për t'u ankuar, si dhe paanshmëria e gjyqësorit në shqyrtimin e rasteve që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

**ANALISTI POLITIK** shërben si ndërlidhësi kryesor i MVZ-së me kandidatët dhe partitë politike, si dhe vëzhgon e vlerëson fushatën politike në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe parimet e tjera universale. Ai ose ajo vendosin kontakte me partitë politike, grupet e shoqërisë civile dhe organizatat jo qeveritare që kanë të bëjnë me procesin politik. Në një sërë rastesh, analistit politik mund t'i ngarkohet të merret me probleme konkrete, fjala vjen, me pjesëmarrjen e gruas, me çështje të pakicave, si dhe me probleme të tjera që prekin të drejtat politike e civile. Analisti politik mund të jetë gjithashtu pika kryesore e kontaktit me vëzhguesit zgjedhorë vendorë.

**ANALISTI I MEDIAVE** bashkërendon punën e një ekipi analitik përgjegjës për përgatitjen e analizave sasiore e cilësore rreth funksionimit dhe përmbajtjes së medias së shkruar dhe asaj elektronike gjatë procesit zgjedhor. Ai ose ajo vlerësojnë se sa mundësi të barabarta kanë partitë dhe kandidatët për të shfrytëzuar organet e medias në pajtim me angazhimet e OSBE-së dhe parimet e tjera universale. Analisti i medias vëzhgon nëse mediat, dhe në veçanti mediat publike ose shtetërore, iu përmbahen përgjegjësi të tyre për të mbuluar procesin zgjedhor në mënyrë të drejtëpeshuar e asnjansë. Së fundi, analisti i medias duhet të vlerësojë nëse organet e ndryshme të medias japin informacion të mjaftueshëm, të balancuar e të shumëllojshëm për t'iu dhënë mundësi votuesve të bëjnë zgjedhje të mirëinformuara. Analisti i medias njihet me legjislacionin e medias dhe vlerëson nëse organet e medias dhe autoritetet i përmbahen ligjeve dhe normave që kanë të bëjnë me median. Analisti i medias gjithashtu ndjek punën e enteve rregullatore të medias në lidhje me zgjedhjet, si dhe mosmarrëveshjet rreth procesit zgjedhor që prekin rolin e medias në këtë proces. Analisti i medias mund të ketë për detyrë edhe përgatitjen e një buletini ditor lajmesh.

**ANALISTI STATISTIKOR** është përgjegjës për përgatitjen e analizave statistikore rreth përfundimeve të mbërritura ditën e zgjedhjeve bazuar në formularët e plotësuar nga VASh-ët, të cilët kanë pasur për detyrë të vlerësojnë procedurat në qendrat e votimit dhe qendrat e numërimit të votave. Analisti statistikor jep këshilla lidhur me përmbushjen e formularëve të VASh-ëve për zgjedhjet në fjalë dhe mbikëqyr punën e ekipit të ngarkuar me mbledhjen e të dhënave. Të dhënat paraprake mund të analizohen dhe të jenë të gatshme herët në mëngjes, një ditë pas zgjedhjeve, në mënyrë që t'u bashkëngjiten përfundimeve të deklaratës paraprake. Analisti statistikor mbërrin në vendin pritës disa ditë para zgjedhjeve dhe largohet vetëm pasi janë përpunuar dhe analizuar plotësisht formularët e plotësuar nga VASh-ët.

**KOORDINATORI I VËZHguesve AFATGJATË** ose Koordinatori i VAGj-ëve është pika kryesore e kontaktit brenda për brenda ekipit bërthamë përsa u takon VAGj-ëve. Koordinatori i VAGj-ëve përvijon projekt-planin e shpërndarjes së VAGj-ëve, në bashkërendim me zëvendëskryetarin e misionit, në mënyrë që të sigurohet që të mbulohen siç duhet zhvillimet zgjedhore në mbarë vendin. Ai ose ajo organizojnë një mbledhje udhëzuese për VAGj-ët në kohën kur ata mbërrijnë në vendin pritës si dhe seanca shkëmbimi mendimesh gjatë gjithë kohës së vëzhgimit. Koordinatori i VAGj-ëve u jep atyre udhëzime, duke u siguruar që ata janë duke përmbushur përgjegjësitë që u takojnë si dhe që po marrin nga misioni përkrahjen që kërkojnë, mban kontakte të rregullta me ta, si dhe merr e analizon raportet e tyre. Ai ose ajo japin këshilla për shpërndarjen e drejtë të VAGj-ëve në rajone të ndryshme të vendit, në mënyrë që të realizo-



het një plan shpërndarje i balancuar dhe sa më përfaqësues, por mund të përgjigjet edhe për shpërndarjen e VAGj-ëve të rekrutuar në vend. Koordinatorin e VAGj-ëve luan një rol të dorës së parë në organizimin dhe programimin e raportimeve nga ana e VAGj-ëve dhe VASH-ëve ditën dhe natën e zgjedhjeve, në mënyrë që të garantojë që raportet e nevojshëm për hartimin e deklaratës paraprake të jenë të gatshme në kohën e duhur.

**PUNONJESI I LOGJISTIKËS** është i ngarkuar me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me operacionet logjistike të një MVZ-je. Ai ose ajo normalisht mbërrin në vend pak ditë para pjesëtarëve të tjerë të ekipit bërthamë dhe ndërkaq gjejnë e marrin me qera mjedise të përshtatshme për zyra, pajisje të ndryshme, mjete komunikimi, si dhe identifikojnë opcionet e mundshme për strehim. Punonjësi i logjistikës merret edhe me rekrutimin e stafit mbështetës vendas. Ndërkohë që afrohet dita e zgjedhjeve, punonjësi i logjistikës vë në jetë planin e shpërndarjes së VASH-ëve (duke u konsultuar me koordinatorin e VAGj-ëve dhe zëvendëskryetarin e misionit) dhe merret me përgatitjet e duhura përsa u takon përkthyesve, shoferëve dhe gjithë nevojave të tjera për sistemin e VASH-ëve. Në ato raste kur nuk ka një punonjës përgjegjës për sigurinë, punonjësi i logjistikës mund të jetë përgjegjës edhe për çështjet e sigurisë. Punonjësi i ngarkuar me logjistikën qëndron në vend edhe disa ditë pas largimit të ekipit bërthamë për të ndihmuar në mbylljen e MVZ-së.

Duke qenë se siguria e personelit të OSBE-së, duke përfshirë këtu edhe vëzhguesit zgjedhorë, është e një rëndësie parësore gjatë gjithë veprimtarive vëzhguese të ODIHR-it, në misionet e vëzhgimit zgjedhor caktohet rregullisht një **PUNONJES PER SIGURINË**, të paktën në ato raste kur kjo gjë gjykohet e nevojshme. Punonjësi i sigurisë mban kontakte të rregullta me autoritetet përkatëse të vendit pritës dhe, në mënyrë të veçantë, me institucionet e zbatimit të ligjit; organizon rregullisht mbledhje informative për çështje të sigurisë me pjesëtarët e MVZ-së, duke përfshirë edhe vëzhguesit afagjatë e afashkurtër; përgatit planet e evakuimit, duke përfshirë edhe evakuimin mjekësor; si dhe mban lidhje të ngushta me koordinatorin për sigurinë të OSBE-së në Vjenë dhe punonjësit përgjegjës të misioneve rezidente të OSBE-së ose organizmave të tjera, kurdoherë që kjo gjë gjykohet e udhës.

**PUNONJESI I FINANÇËS** përpunon dhe administron buxhetin e detajuar të MVZ-së në përputhje me rregullat dhe procedurat e ODIHR-it. Ai ose ajo administron financat dhe shpenzimet e MVZ-së, ku hyjnë pagesat për zyrën dhe pajisjet, rrogat, dietat e shpenzime të tjera dhe siguron që të gjitha këto të jenë në pajtim me buxhetin. Ai ose ajo harton ose mbikëqyr të gjitha kontratat e lidhura me stafin mbështetës kombëtar dhe mjediset e marra me qira. Normalisht punonjësi i financës mbërrin në vendin pritës, bashkë me punonjës të logjistikës, disa ditë përpara pjesës tjetër të ekipit bërthamë, dhe qëndron në vend për të ndihmuar në mbylljen e MVZ-së.

**PUNONJESI PER LIDHJET ME PARLAMENTIN** shërben si ndërlidhësi kryesor i një MVZ-je me delegacionet parlamentare vëzhguese të një procesi të caktuar zgjedhor. Në përbërje të këtyre delegacioneve mund të jenë anëtarë të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (OSBE AP), anëtarë të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (PACE), anëtarë të Parlamentit Europian ose, sipas rastit, të organizmave të tjerë parlamentarë. Në varësi edhe të rrethanave të veçanta, punonjësi ndërlidhës me parlamentin mund të jetë përgjegjës për organizimin e takimeve informuese, mbështetjen logjistike, planet e shpërndarjes në terren dhe për veprimtari të tjera për parlamentarët. Punonjësi ndërlidhës me parlamentin mban kontakte

të ngushta me stafin administrativ të organizmave përkatës parlamentarë. Ai ose ajo mbërrin në vendin pritës dy ose tri javë para zgjedhjeve dhe rri deri sa të jenë larguar të gjithë grupet parlamentare.

## 6.2 Vëzhguesit Afatgjatë

**VËZHguesit Afatgjatë (VAGj)** kërkohen nëpërmjet një note-verbale që u përcillet të 55 vendeve anëtare të OSBE-së, ku ODIHR-i parashtron kërkesat për persona me një farë përvojë në administrimin e zgjedhjeve dhe/ose me përvojë të krahasueshme në fushën e vëzhgimit të tyre për të shërbyer si VAGj. VAGj-ët duhet të jenë në gjendje të mbajnë marrëdhënie objektive me zyrtarët bashkiakë ose krahinorë, punonjësit e ngarkuar për zgjedhjet, përfaqësuesit e partive politike dhe kandidatët dhe organizatat përkatëse jo qeveritare për një periudhë të gjatë kohore. Ata duhet të jenë të aftë të përgatisin analiza të pavarura lidhur me mjedisin parazgjedhor në mbarë vendin pritës, për t'u përfshirë në raportet e përgjithshëm të ODIHR-it. Shtetet prej nga vijnë VAGj-ët mbulojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve për dërgimin dhe mbështetjen e tyre.

Zakonisht VAGj-ët arrijnë në vendin pritës një javë pas vendosjes së misionit të vëzhgimit zgjedhor dhe qëndrojnë rreth një javë pas përfundimit të zgjedhjeve. Më së shumti janë të organizuar në skuadra prej dy vetësh, shpesh me shtetësi të ndryshme, dhe shpërndahen në të katër anët e vendit sipas një plani që bën të mundur një mbulim gjeografik të ekuilibruar. VAGj-ëve iu kërkohet të punojnë pranë bashkive, ose në të gjithë nivelet e pushtetit lokal, duke qëndruar në zonat e caktuara gjatë gjithë procesit zgjedhor, përveç rasteve kur marrin udhëzime të tjera. Normalisht iu kërkohet të marrin pjesë periodikisht në mbledhje udhëzuese në nivel qendror. Numri i VAGj-ëve mund të ndryshojë në varësi të madhësisë së një vendi dhe një sërë rrethanash të tjera të veçanta.

Para se të dërgohen në zonën përkatëse, VAGj-ët marrin një sërë udhëzimesh nga ekipi bërthamë, prej të cilave mund të përmendim:

- Një vështrim të përgjithshëm për OSBE-në si dhe për rolin e VAGj-ëve në gjirin e një MVZ të ODIHR-it;
- Një pasqyrë të metodologjisë së vëzhgimit zgjedhor të ODIHR-it dhe Kodit të Sjelljes;
- Një analizë të sistemit zgjedhor, ligjit dhe normave zgjedhore, si dhe të strukturës së administratës zgjedhore;
- Një kuadër të situatës politike;
- Një përshkrim të çështjeve kyç që duhen vëzhguar, si dhe të detyrave konkrete që duhen përbushur;
- Një vështrim për situatën dhe çështjet gjinore e ato të pakicave;
- Një vështrim për situatën dhe çështjet e sigurisë në vend;
- Informacione për aspekte logjistike, financiare dhe të dërgimit në vend; dhe
- Udhëzime lidhur me raportimin dhe detyra të tjera operative.

Punonjësi i ngarkuar me Logjistikën në MVZ iu vjen në ndihmë VAGj-ëve për punësimin e përkthyesve dhe shoferëve, rregullimin e transportit në zonat përkatëse të punës, për përcaktimin fillestar të vendeve për t'u sistemuar, si dhe për pajisjen e çdo ekipi VAGj-ësh me mjetet e domosdoshme të punës si kompjutera dhe telefonë celularë. Fillimisht VAGj-ëve iu

kërkohet të punojnë në mjediset ku janë strehuar, sepse buxheti i MVZ-së nuk përfshin fonde për mjedise zyra për VAGj-ët.

Prania e VAGj-ëve është garanci që MVZ-ja mund të shtrihet efektivisht në mbarë vendin. Çdo ekip VAGj-ësh ndërmerr veprimtari vëzhgimi dhe raportimi në rajonin ku është dërguar, ashtu siç vepron edhe ekipi bërthamë në të gjithë vendin. Çdo ekip VAGj-ësh nje pjesë të kohës vëzhgon çështjet thelbësore që rrokin procesin zgjedhor, kurse një pjesë tjetër përgatit logjistikën dhe dërgimin e VASh-ëve, të cilët priten të dërgohen e të punojnë nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të tyre.

Roli thelbësor i VAGj-ëve është që të vëzhgojnë dhe të vlerësojnë efektivitetin e paanshmërinë së administratës zgjedhore, zbatimin e normave dhe ligjit zgjedhor, natyrën e fushatës si dhe mjedisin politik. Për këtë qëllim, VAGj-ët vendosin dhe mbajnë kontakte me autoritetet qeveritare, me përfaqësues të administratës zgjedhore rajonale e lokale, me kandidatë dhe parti politike, udhëheqës të grupeve minoritare dhe organizatave të shoqërisë civile që merren me zgjedhjet. Këtu hyjnë grupet e të drejtave të njeriut, grupet e vëzhguesve zgjedhorë vendas, organizatat e grave, si dhe përfaqësues të organeve të medias dhe OJQ-ve të tjera. Në bashkëpunim e duke u bashkërenduar me analistin e medias të MVZ-së, VAGj-ëve mund t'u kërkohet të ndjekin mbulimin e zgjedhjeve nga media lokale. (Hollësitë rreth çështjeve që kanë të bëjnë me analizën e medias gjenden në Kapitullin 7 të këtij manuali.)

VAGj-ëve iu kërkohet të paraqisin raporte javore te Kryetari i Misionit nëpërmjet koordinatorit të VAGj-ëve. Në këto raporte, lypset të përmbliidhen ngjarjet më domethënëse të dala nga vëzhgimi i VAGj-ëve lidhur me procesin zgjedhor gjatë asaj jave, si dhe të pasqyrohen takimet e ndryshme që janë kryer. Informacionet e një rëndësie të veçantë ose tejet urgjente duhet të përcillen veçmas në raportet e përpiluara nga vendi i ngjarjes. Të dhënat e raportuara nga VAGj-ët përfshihen në raportet e përgjithshëm të MVZ-së.

VAGj-ëve u kërkohet gjithashtu t'u ofrojnë informacione thelbësore VASh-ëve lidhur me aspektet e procesit zgjedhor përkatësisht për zonat ku ata janë dërguar. Gjatë këtyre mbledhjeve informative, hidhet dritë mbi aspektet kryesore të procesit zgjedhor në atë zonë dhe mbi çështjet më të mprehta politike, si dhe mund të vihen në dukje çështje të karakterit logjistik e të sigurisë. VAGj-ëve iu kërkohet të marrin pjesë në takime periodike të thirrura nga Kryetari i Misionit gjatë gjithë procesit të vëzhgimit.

Roli i VAGj-ëve në dhënjen e mbështetjes logjistike për VASh-ët është kyç për funksionimin efektiv të një MVZ-je. Të gjithë ekipet e VAGj-ëve duhet të ndihmojnë në përcaktimin e numrit optimal të VASh-ëve që nevojiten për vëzhgim në ditën së zgjedhjeve në zonën e tyre; numri i njerëzve do të vendoset në konsultim me përfaqësuesit e ekipit bërthamë, bazuar edhe në numrin e përgjithshëm të VASh-ëve të pranishëm. VAGj-ët lypset të hartojnë plane për dërgimin në vend të VASh-ëve për të bërë të mundur një mbulim të përshtatshëm e të balancuar të qendrave të votimit dhe qendrave të numërimit në zonat e tyre. Nga ana tjetër, ata duhet të sigurojnë kushtet për strehim, përkthyes, makina e shoferë për ekipet e VASh-ëve që hyjnë në fushën e përgjegjësisë të tyre. VAGj-ëve mund t'u kërkohet të ndihmojnë vëzhguesit parlamentarë që do të dërgohen në zonën e tyre.

Ditën dhe natën e zhvillimit të zgjedhjeve, VAGj-ët duhet të koordinojnë raportimet e bëra nga VASh-ët si dhe të bëjnë çmos e sigurojnë që ekipi bërthamë të jetë plotësisht i informuar lid-

hur me zhvillimet përkatëse në zonat e mbuluara prej tyre. Zakonisht VAGj-ëve u kërkohet t'i parashtrojnë një raport ekipit bërthamë herët në mëngjes, një ditë pas zhvillimit të zgjedhjeve, në mënyrë që vëzhgimet e tyre të pasqyrohen në deklaratën paraprake të MVZ-së. Shpesh VAGj-ëve u kërkohet të organizojnë një mbledhje për shkëmbime mendimesh me VASH-ët mëngjesin e ditës pas zgjedhjeve.

### 6.3 Vëzhguesit afatshkurtër

**VËZHguesit AFATSHKURTËR** (VASH-ët) kërkohen nëpërmjet një note-verbale që u përcillet të 55 vendeve anëtare të OSBE-së, ku ODIHR-i parashtron kërkesat për persona me një përvojë të ndjeshme në administrimin e zgjedhjeve dhe/ose përvojë të krahasuar në fushën e vëzhgimit për të shërbyer si VASH-ë. Shtetet përkatëse përballojnë të gjitha shpenzimet për VASH-ët.

VASH-ët zakonisht qëndrojnë në një vend për afro një javë. VASH-ët dërgohen në skuadra prej dy vetësh dhe vëzhgojnë procesin e votimit dhe të numërimit ditën e zgjedhjeve. Ata dërgohen sipas një plani që siguron një prani të gjerë e të balancuar vëzhguesish në mbarë vendin gjatë ditës së zgjedhjeve. Për shkak të kompleksitetit të planeve të dërgimit të vëzhguesve, nuk është e mundur të merren parasysh kërkesat e VASH-ëve për t'u dërguar në një zonë të caktuar ose që të jenë në ekip me këtë ose atë person. Përgjegjësitë dhe procedurat konkrete të VASH-ëve jepen në kapitujt 8 dhe 9 të këtij manuali.

Në shumë raste, ODIHR e mirëpret rekrutimin e si VASH-ë të ndërkombëtarëve që ndodhen në vendin ku do të kryhen zgjedhjet për të plotësuar numrin e vëzhguesve të ardhur; zakonisht është fjala për diplomatë ose qytetarë të tjerë të vendeve anëtare të OSBE-së, të cilët rekomandohen nga ambasadat e vendeve të tyre. Sidoqoftë, ODIHR-i ruan të drejtën e fjalës së fundit, domethënë të pranojë ose refuzojë rekomandimet sipas rastit. Në bazë marrëveshesh të veçanta, të gjithë ato shtete që janë partnere për bashkëpunim me OSBE-në mund të dërgojnë vëzhgues me status special për të marrë pjesë në vëzhgim si VASH-ë.

Siç e përmendëm më sipër, ODIHR-i krijoi në vitin 2001 një fond vullnetarësh që mundëson pjesëmarrjen në misionet vëzhgimi të vëzhguesve nga të gjithë vendet e Europës Lindore e Qendrore si dhe të atyre vendeve që bëjnë pjesë në Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, në varësi të fondeve të disponueshme.

VASH-ët zakonisht mbërrijnë në një vend rreth katër ditë para zgjedhjeve; grafiku i saktë përcaktohet nga ODIHR-i nisur nga rrethanat e vendit dhe u komunikohet delegacioneve të vendeve pjesëmarrëse në kohën e duhur. Një ditë pas mbërritjes së programuar, ekipi bërthamë organizon një seancë udhëzimesh e informacioni për VASH-ët. Ditën tjetër, VASH-ët dërgohen në zonat e tyre të vëzhgimit; paskëtaj normalisht ata kanë një ditë për t'u ambientuar me vendin ku janë caktuar për vëzhgim, para se të zhvillohen zgjedhjet.

VASH-ët e nisin punën herët në mëngjes ditën e zgjedhjeve duke vëzhguar hapjen e qendrave të votimit. Gjatë ditës, VASH-ët mund të vizitojnë deri në 10 qendra votimi. Paskëtaj, ata përcaktojnë një qendër votimi ku do të vëzhgojnë procedurat e mbylljes dhe numërimin e votave. Në ndonjë rast, VASH-ëve mund t'u kërkohet të rrinë vetëm në një qendër votimi, ose mund të caktohen të vëzhgojnë tabelëzimin pranë një komisioni zgjedhor të nivelit të mesëm dhe/ose të kryejnë detyra të tjera, si vëzhgimi i procedurave të veçanta të votimit (votimi në një repart udhtarak ose burg, ose ndjekja e një kutie të lëvizshme votimi).

Pjesëmarrja në seancën e udhëzimeve dhe informacionit parazgjedhor është e detyrueshme për të gjithë VASh-ët; ata persona që nuk mbërrijnë në kohë për t'u udhëzuar e informuar nuk do të pranohen të marrin pjesë në MVZ. Edhe vëzhguesit më me përvojë e kanë të nevojshme të udhëzohen lidhur me çështje dhe procedura që janë specifike për një proces zgjedhor të caktuar. Seanca e udhëzimeve përfshin:

- Metodologjinë e ODIHR-it dhe Kodin e Sjelljes së Vëzhguesit;
- Kuadrin e përgjithshëm politik;
- Sistemin zgjedhor;
- Ligjin elektoral dhe zbatimin e tij në praktikë;
- Administratën e zgjedhjeve;
- Procedurat e votimit dhe të numërimit;
- Çështjet gjinore dhe të pakicave;
- Një vështrim të përgjithshëm të mediave;
- Si t'u jepen përgjigje kërkesave të medias;
- Periudha parazgjedhore mbështetur në vëzhgimin afatgjatë;
- Çështje ose procedura të poscame për t'u vëzhguar;
- Si të plotësohen dhe dorëzohen formularët e raportimit;
- Informacione rreth problemeve të logjistikës, dislokimit dhe financës; si dhe
- Çështje të sigurisë.

VASh-ët janë të pajisur me mandat akreditimi, si dhe materiale udhëzuese të shkruara, ku përfshihen një libër udhëzimesh për VASh-ët, që përgatitet posaçërisht për çdo proces zgjedhor, një përkthim të ligjit zgjedhor kombëtar dhe rregulloret përkatëse, informacion të përgjithshëm për logjistikën dhe numrat e kontaktit në raste emergjencash, një hartë të vendit ose zonës së vëzhgimit, Manualin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR-it, si dhe formularët e raportimit. Në rastet kur është e mundur, libri i udhëzimeve të VASh-ëve iu dërgohet me postë elektronike VASh-ëve para ditës së zgjedhjeve.

## 6.4 Staf mbështetës kombëtar

Një komponent kyç i një misioni vëzhgues zgjedhor është stafi kombëtar, i cili i jep MVZ-së njohuri tejet të çmuara. Në përgjithësi, çdo anëtar i ekipit bërthamë ka të paktën një ndihmës vendas. Disa njësi – sidomos ajo e medias dhe e logjistikës – kanë nevojë për një numër më të madh anëtarësh vendas.

Anëtarët e stafit kombëtar të një MVZ-je shërbejnë si përkthyes dhe staf mbështetës administrativ për personelin ndërkombëtar. Staf vendas mund të përfshijë njerëz me ekspertizë në fusha të veçanta me interes për një mision vëzhgimi. Çdo ekip VAGj-ësh dhe VASh-ësh do të ndihmohet në punën e vet nga një shofer dhe përkthyes vendas.

Ndërkohë që stafi vendas luan një rol mbështetës thelbësor për çdo mision vëzhgimi zgjedhor, ata vetë nuk mund të akreditohen si vëzhgues të ODIHR-it. Këto kufizime janë të nevojshme në mënyrë që të sigurojnë një analizë objektive dhe të paanshme, të parandalojnë konflikte të mundshme interesash, si dhe të ruajnë një vijë të qartë ndarëse midis vëzhgimit ndërkombëtar dhe opinionit vendas.



# 7.

## Vëzhgimi i periudhës parazgjedhore



Vëzhgimi afatgjatë i procesit zgjedhor dhe vlerësimi i tij në përputhje me angazhimet e OSBE-së si dhe parimet e tjera universale është përgjegjësi e ekipit bërthamë dhe e VAGj-ëve. Në mënyrë të veçantë, vëzhgimi afatgjatë duhet të vlerësojë zbatimin në praktikë të legjislacionit zgjedhor, funksionimin e administratës zgjedhore, ecurinë e fushatës zgjedhore dhe rolin e medias. Seksionet që vijojnë hedhin dritë mbi një sërë çështjesh kyçe dhe hulumtimesh të kryera në suazën e secilës prej këtyre fushave.

### 7.1 Kuadri ligjor

#### A. Legjislacioni zgjedhor dhe zbatimi i tij në praktikë

**LIGJI PER ZGJEDHJET:** Para se një MVZ të dërgohet në një vend të caktuar, kurdoherë kur është e mundur, ODIHR-i merret me rishikimin dhe analizën e ligjit zgjedhor përkatës. Kjo bën të mundur një vlerësim gjithëpërfshirës e të plotë për të parë se deri në ç'shallë ligji pasqyron angazhimet e OSBE-së dhe parimet e përgjithshme. Kjo analizë kryhet në përputhje të plotë me udhëzimet e ODIHR-it për rishikimin e kuadrit ligjor për zgjedhjet<sup>16</sup>. Në vendet anëtare të Këshillit të Europës, kjo analizë mund të kryhet së bashku, ose në bashkëpunim me Komisionin për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) të Këshillit të Europës. Anëtarët e MVZ-së dhe, në veçanti, analisti ligjor duhet të njohin mirë të gjitha analizat e bëra për këtë çështje. Në qoftë se në legjislacion ka mangësi serioze, duhen mbajtur parasysht, kurse raporti përfundimtar i MVZ-së duhet të përfshijë rekomandime për amendamentet përkatëse.

MVZ-ja merr në shqyrtim jo vetëm përmbajtjen e legjislacionit, por edhe faktin se si është hartuar dhe miratuar ai. Legjislacioni për zgjedhjet duhet të gëzojë përkrahje sa më të gjerë ndër faktorët politikë të një vendi. Për rrjedhojë, kuadri ligjor duhet hartuar në mënyrë të hapur e gjithëpërfshirëse me qëllim që të sigurojë besim në shkallë të gjerë ndër partitë politike konkurruese, kandidatët dhe votuesit. Pak kohë para zgjedhjeve nuk duhet të bëhen ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor, pasi kjo gjë mund të shkaktojë pësjtjellim dhe të kri-

<sup>16</sup> *Guidelines for Reviewing a Legal Framework for Elections* [Udhëzues për Rishikimin e Kuadrit Ligjor për Zgjedhjet] (Varshavë, OSBE/ODIHR, 2001).

jojë një mjedis të paqëndrueshëm dhe të paparashikueshëm; këto ndryshime mund të bëhen vetëm në rrethana tejet të veçanta dhe në ato raste kur amendamentet gjejnë mbështetje të gjerë.

**LIGJE TË TJERA:** Kuadri ligjor i zgjedhjeve përfshin jo vetëm ligjin zgjedhor, por edhe një spektër më të gjerë ligjesh që kanë të bëjnë me çështjen në fjalë. Në varësi të rrethanave, analisti ligjor, dhe mundësisht edhe anëtarë të tjerë të MVZ-së, duhet gjithashtu të rishikojnë nenet e kushtetutës dhe aspekte të tjera të legjislacionit që kanë të bëjnë me zgjedhjet, duke përfshirë këtu edhe ligjin për partitë politike, ligjin për shtetësinë, ligjin për regjistrimin e votuesve, ligjin për financimin e fushatës, ligjin për median dhe, mundësisht, elementë të kodit penal e të kodit civil. Gjithashtu të rëndësishëm për procesin zgjedhor mund të jenë edhe ligjet lidhur me të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimin. Shpesh, rishikimi i normave dhe dekreteve, si dhe i ligjeve, është diçka e nevojshme.

**ZBATIMI:** Zbatimi i paanshëm dhe i vazhdueshëm i kuadrit ligjor është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe meriton vëmendjen dhe përkujdesin e MVZ-së. Zakonisht ka disa organizma që janë përgjegjës për zbatimin e ligjit: komisionet zgjedhore, zyra e prokurorit dhe zyra të tjera qeveritare, autoritetet qeverisëse qendrore dhe lokale, organet rregullatore të medias dhe policia. MVZ-ja vëzhgon se deri në ç'shikallë secili prej këtyre organizmave i plotëson detyrimet ligjore dhe respekton angazhimet e OSBE-së dhe parimet e tjera universale. Përvoja ka dëshmuar se një faktor kyç në të gjitha zgjedhjet është vullneti politik i autoriteteve për ta realizuar procesin në mënyrë të paanshme, transparente dhe të përgjegjshme. Edhe atëherë kur ligjet pajtohen plotësisht me standardet ndërkombëtare, kjo gjë nuk do të kish asnjë vlerë në qoftë se nuk do të zbatoheshin plotësisht e me ndershmëri.

### Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:

- Ligje që nuk plotësojnë të gjitha angazhimet e OSBE-së dhe parimet e tjera universale;
- Ligje që nuk gëzojnë besimin e aktorëve kryesorë të zgjedhjeve;
- Ligje të paqarta, që janë objekt interpretimesh të ndryshme dhe që nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme për respektimin e të drejtave civile dhe politike;
- Ligje ose rregulla administrative që nuk mbrojnë ashtu si duhet të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
- Moszbatimi i ligjeve në mënyrë jo partiake, konsistente e transparente; dhe
- Rregulla që mund të dhunojnë frymën e ligjit.

### B. Ankesat dhe apelimet

Një tjetër element i rëndësishëm i kuadrit ligjor është edhe procesi i ankesave dhe apelimeve, i cili duhet të sigurojë në mënyrë të efektshme dhe në kohën e duhur zgjidhjen e tyre në rastet kur është shkelur ligji. Ankesat që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor duhet të shqyrtohen me drejtësi, transparencë dhe sipas ligjit përkatës. Procedurat dhe afatet kohore duhet të përcaktohen qartë në ligjin për zgjedhjet. Afatet kohore duhet të jenë mjaftueshmërisht të shkurtra në mënyrë që të sigurojnë zgjidhje të arësyeshme të problemit. Për depozitimin e ankesave duhet të ekzistojnë strukturat e duhura, të cilat të jenë lehtësisht të kontaktueshme.



E drejta për t'u ankuar tek organizmat zgjedhore dhe gjykatat duhet përcaktuar qartë e prerë, në mënyrë që të bëjë të mundur një proces ankimi të qartë, të kuptueshëm, të veçantë dhe sipas hierarkisë, proces që duhet të përcaktojë rolin e çdo komisioni zgjedhor në të gjitha nivelet, si dhe të të gjitha niveleve të gjyqësorit. Kjo gjë do të shmangë mundësinë që ankuesi t'i drejtohet atij organizmi që sipas tij mund ta shqyrtojë më mirë çështjen e tij dhe, nga ana tjetër, kjo do të sigurojë që të gjitha ankesat të trajtohen në mënyrë konsistente. Në qoftë se ankuesve iu kërkohet të ankohen së pari tek organizmat zgjedhorë, ligji, gjithsesi, duhet të sigurojë të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate si instancë e dytë dhe/ose e tretë. Vëzhguesit duhet t'i kushtojnë vëmendje pavarësisht dhe paanshmërisë së gjykatave. Përgjigjet ndaj ankesave duhet të jepen në kohën e duhur dhe të gjitha seancat, si të dëgjimit ashtu edhe të dhënies së vendimit, duhet të jenë të hapura për publikun.

Analisti ligjor duhet të ndjekë ankesat e regjistruara gjatë fushatës dhe mënyrës se si janë zgjidhur. Një listë ankesash mund të shërbejë si tregues i çështjeve që kërkojnë vëmendje të mëtejshme nga ana e MVZ-së.

### Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:

- Proces i paqartë ose i diskutueshëm për sa i përket paraqitjes së ankesave;
- Gjyqësor jo i pavarur nga ekzekutivi;
- Mungesa e procesit të duhur në procedurat gjyqsore;
- Vonesa në dhënien e vendimit lidhur me ankesën pas përfundimit të procesit zgjedhor;
- Mungesë transparence në kryerjen e proceseve të ankimit; dhe
- Mosmbajtja përgjegjësi nga ana e atyre që kanë shkelur ligjet.

## 7.2 Administrata zgjedhore

### A. Përbërja e administratës zgjedhore

**KOMISIONET ZGJEDHORE:** Administrata kombëtare zgjedhore, siç është komisioni qendror zgjedhor, ose një organ ekuivalent, është përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve. Sipas rasteve, gjyqësori mund të mbikëqyrë procesin zgjedhor. Pavarësisht se çfarë organi ngrihet për të administruar një proces të caktuar zgjedhor, puna e tij duhet të jetë kolegjiale, jo partiake, transparente dhe e pavarur nga autoritetet dhe ndikimet e ndryshme politike.

Pavarësia e një komisioni qendror zgjedhor forcohet në qoftë se ai përbëhet nga persona të respektuar dhe me kualifikimet e duhura, të emëruar sipas interesash të drejtpeshuara. Komisioni duhet të jetë në gjendje të vërë në jetë e të zbatojë legjislacionin zgjedhor dhe normat përkatëse pa ndërhyrje, kërcënime, si dhe pa u penguar në kryerjen e detyrave të tij. Organi administruar duhet gjithashtu të përbëhet nga një përfaqësi e ekuilibruar personash të emëruar nga partitë politike. Drejtpeshimi midis përfaqësuesve të partive të ndryshme mund të shërbejë si mjet për të verifikuar keqadministrimin ose abuzimet e mundshme me detyrën, sidomos në qoftë se partitë janë të përfaqësuara në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Në qoftë se komisionet zgjedhore përbëhen nga persona të emëruar nga partitë politike, atëherë atyre u duhet ndaluar të bëjnë fushatë për partitë që përfaqësojnë dhe duhet

të jenë të aftë e në gjendje të veprojnë në mënyrë të pavarur, pa pasur frikë nga shpagimet ose se mund t'i heqin.

Në qoftë se me administrimin e zgjedhjeve ngarkohet një organ gjyqësor, atëherë lypset të sigurohet pavarësia e tij nga autoritetet e pushtetit ekzekutiv dhe forcat politike, dhe kjo duhet bërë nëpërmjet procedurave transparente. Të përzgjedhurit e gjyqësorit duhet të jenë të imunizuar nga autoriteti i atyre që synojnë të zenë një vend në ekzekutiv.

Një organ qendror administrimi mund të jetë strukturë e përhershme ose, të paktën, të ketë një komitet ekzekutiv të qëndrueshëm. Në rastet kur nuk është organ i përhershëm, pavarësia e tij duhet garantuar me anë të përcaktimit të afateve kohore të qëndrimit të detyrë të anëtarëve të tij, si dhe me anë të ruajtjes së drejtës për t'u kthyer në ato vende pune që kanë patur më parë.

Kur të gjitha takimet e administratës zgjedhore janë të hapura, transparencja rritet në mënyrë të ndjeshme, duke kontribuar kështu në rritjen e besimit publik te sistemi. Po ashtu, organet e administrimit të zgjedhjeve duhet të publikojnë të gjitha vendimet e marra, si dhe të organizojnë rregullisht takime informative me median.

Administratat zgjedhore gëzojnë besimin e publikut atëherë kur e organizojnë punën në bazë konsensusi, ose kolegjaliteti. Të gjitha mbledhjet duhet të njoftohen në kohë, dokumentat përkatëse duhet t'u shpërndahen njëllor të gjithë anëtarëve të komisionit që ata të kenë kohë të mjaftueshme për t'i shqyrtuar para sesionit. Gjatë mbledhjeve, duhet të mbahen rregullisht proces-verbale.

Në një mjedis ku transparencja është e mangët, MVZ-ja, dhe në mënyrë të veçantë, analisti zgjedhor, duhet të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e administratës qendrore zgjedhore, ndërkohë që VAGj-ët duhet të jenë të pranishëm në mbledhjet e administratës zgjedhore lokale dhe rajonale. Edhe vëzhguesit vendas duhet gjithashtu të lejohen të marrin pjesë dhe të ndjekin procedurat e takimeve të komisioneve zgjedhore.

**ORGANE TË TJERË TË ANGAZHUAR NË ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE:** Përveç komisioneve zgjedhore, mund të kërkohet që ministri të ndryshme dhe zyrtarë lokalë e rajonalë të ndërmarrin operacione administrative dhe logjistike në funksion të përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve. Ata mund të jenë përgjegjës për përgatitjen e regjistrit të votuesve dhe shpërndarjen e listave të votuesve, fletëve të votimit, kutive të votimit, kabinave të votimit, vulave zyrtare, si dhe një sërë materialesh të tjera që nevojiten me këtë rast, por edhe për përcaktimin e vendeve dhe marrjen e masave për magazinimin, shpërndarjen dhe sigurinë. Shpesh autoriteteve lokale u kërkohet të sigurojnë mjediset për qendrat e votimit.

Të gjithë organizmat që merren në përgatitjet për zhvillimin e zgjedhjeve duhet t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë transparente dhe me përgjegjësi. Vëzhguesit duhet të njohin rolin e ministrive dhe autoriteteve lokale në organizimin e procesit zgjedhor, si edhe kontributin e këtij roli në administrimin e duhur të zgjedhjeve.

## Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:

- Komisione zgjedhore që nuk gëzojnë besimin e plotë të aktorëve kryesorë të zgjedhjeve;
- Komisione që janë nën trusninë e politikës ose që nuk janë të pavarura nga ekzekutivi;
- Komisione që janë të prirur t'i marrin vendimet duke votuar sipas orientimeve politike dhe jo me marrëveshje me bazë të gjerë;
- Komisione që mbledhjet e tyre nuk i kanë të hapura për publikun, ose që nuk i publikojnë tërësisht vendimet e marra;
- Vështirësi të ndryshme me të cilat hasen aktorët kryesorë të zgjedhjeve për të zënë vendet që u takojnë në komisione;
- Ndryshimet e minutës së fundit në përbërjen e komisioneve zgjedhore ose tërheqjet e pajustificuara të anëtarëve të komisioneve; dhe
- Mungesa e koordinimit të duhur ndërmjet komisioneve zgjedhore dhe punonjësve rajonalë ose lokalë që përgjigjen për mbështetjen e organizimit të procesit zgjedhor.

### B. Burimet

**BURIMET MATERIALE:** Pavarësisht nga veçoritë e sistemeve të ndryshme kombëtare për sa i përket financimit të proceseve të ndryshme zgjedhore, gjithësesi, administrata zgjedhore duhet të pajiset, në mënyrë transparente, me fonde të mjaftueshme nga buxheti i shtetit ose ai bashkiak për të kryer përgjegjësitë e veta. Pavarësia e administratës zgjedhore mund të rritet në qoftë se ajo ka një buxhet të përcaktuar dhe jo të dhënë në mënyrë *ad hoc* nëpërmjet procedurave buxhetore.

Vëzhguesit duhet të shohin nëse administrata zgjedhore ka një ide realiste për fondet që i nevojiten si edhe mjetet e duhura për t'iu përgjigjur kërkesave për të realizuar një proces zgjedhor të efektshëm. Këtu hyjnë fondet për rimbursimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore, një numër i mjaftueshëm objektesh të volitshme për qendrat e votimit, pajisje për qendrat e votimit (fletë votimi, kuti votimi të përshtatshme e të sigurta, kabina votimi të volitshme), si dhe kapacitete komunikimi e kompjuteristike.

**BURIMET NJERËZORE:** Për të pasur një proces zgjedhor sa më të efektshëm, lypsen domosdoshmërisht burime njerëzore të përshtatshme dhe njohuri të specializuara. Vëzhguesit duhet të sigurohen se është caktuar numri i duhur i punonjësve zgjedhorë, se zyrtarëve zgjedhorë u janë dhënë udhëzime dhe detyra të qarta dhe se punonjësit zgjedhorë i dinë detyrat që duhet të kryejnë ditën e zgjedhjeve.

Vëzhguesit duhet të vlerësojnë nëse anëtarët e komisionit zgjedhor, duke përfshirë këtu edhe anëtarët e emëruar nga partitë politike, janë trainuar në mënyrë të njëllojtë në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore. Kurdoherë që kanë mundësi, VAGj-ët duhet të vëzhgojnë seancat e trainimit të punonjësve rajonalë e lokalë.

## Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:

- Komisione zgjedhore që nuk kanë buxhet publik;
- Paqartësi nëse janë autoritetet shtetërore apo lokale ato që përgjigjen për gjetjen e fondeve të ndryshme ose për sigurimin e ndihmës;
- Mungesë fondesh për zgjedhje të paparashikuara;
- Pajisje të papërshtatshme për votim;
- Qendra votimi në mjedise që janë tejet të vogla dhe krejt të papërshtatshme për votues të paaftë fizikisht;
- Punonjës pa përvojë në qendrat e votimit;
- Trainim i papërshtatshëm për punonjësit e qendrave të votimit;
- Mungesë udhëzimesh të qarta me shkrim rreth procedurave të votimit; dhe
- Personel i caktuar pranë qendrave të votimit pa trainimin e duhur.

### C. Regjistrimi i kandidatëve dhe i partive politike

Zakonisht administrata zgjedhore është përgjegjëse për regjistrimin e kandidatëve në një proces zgjedhor. Të njëjtat parime të përgjithshme që përcaktojnë të drejtën për të votuar vlejné edhe përsa i takon të drejtës për të qenë kandidat. Të gjitha forcat dhe lëvizjet politike duhet të jenë në gjendje të emërojnë dhe paraqesin kandidatë lirshëm dhe në raporte të barabarta. Çdo praktikë arbitrare ose diskriminuese që synon të skualifikojë ose minojë kandidatë ose forca të caktuara politike bie ndesh me angazhimet e OSBE-së.

Për asnjë kandidat nuk duhet të ekzistojë kurrfarë kufizimi për shkak të racës, seksit, fesë, përkatësisë politike, origjinës etnike ose gjendjes ekonomike. Sidoqoftë, praktikat më të mira nuk përjashtojné kuota të arsyeshme ose preferenca për të siguruar një përfaqësim sa më të barabartë të grave ose grupeve të pakicave.

Gjithësesi, ka një sërë kufizimesh të arsyeshme që mund të përdoren në rastin e atyre individëve që dëshirojnë të garojné për një post të caktuar. Fjala vjen, tingëllon krejt i arsyeshëm përjashtimi i të gjithë atyre personave që për momentin janë duke shlyer në burg dënimin për një krim të rëndë që kanë kryer. Gjithësesi, edhe në këtë rast, humbja e të drejtës për kandidim duhet të jetë proporcionale në raport me krimin e kryer, prandaj e drejta për të kandiduar duhet t'i kthehet personit automatikisht fill pas shlyerjes së dënimit. Një tjetër shembull ka të bëjë me vendbanimin, çka do të thotë se është e arsyeshme t'i kërkohet një personi të ketë banuar në një vend të caktuar për një periudhë kohe para se të kandidojë. Kufizime të tjera mund të jenë ato lidhur me një prag të arsyeshëm moshe ose me faktin se lypsen prova, qoftë edhe minimale, të përkrahjes në gjirin e votuesve. Çdo prag gjuhësor nuk ka pse të përbëjë një kufizim të paarsyeshëm për kandidatët, megjithatë, çdo test gjuhësor lypset të jetë transparent, objektiv, racional, dhe jo diskriminues. Është e arësyeshme që punonjësve civilë, personelit ushtarak, ose atij të sigurisë, si dhe gjykatësve t'u kufizohet e drejta për të kandiduar përse kohë që janë në detyrë, por në rast se japin dorëheqjen nga pozicionet e tyre, e gëzojnë këtë të drejtë.

Klauzolat lidhur me regjistrimin e kandidatëve duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë kandidatët ose partitë. Kërkesat që lidhen me regjistrimin, si të kandidatëve

ashtu edhe të partive, duhet të jenë të qarta e të parashikueshme dhe nuk duhet të përbajnë kërkesa diskriminuese, siç janë depozitimi i shumave të mëdha, përfaqësim partiak, ose mandat përkrahjeje rajonale, si dhe një numër të paarsyeshëm emrash në petitionin për regjistrim.

Nisur nga parimi i proporcionalitetit, partitë ose kandidatët nuk duhet kurrsesi të skualifikohen nga pjesëmarrja në zgjedhje, veçse për arsye nga më të rëndat. Atyre duhet t'u jepet mundësia të korrigjojnë mangësitë teknike në formularët e regjistrimit; askujt prej tyre nuk duhet t'i refuzohet regjistrimi ose të skualifikohet për shkaqe teknike. Për çdo rast refuzimi për të regjistruar një kandidat ose parti, duhet të ekzistojë e drejta për t'iu drejtuar një organi të gjyqësorit, por apelimi duhet të shqyrtohet brenda një afati kohor të arsyeshëm para zhvillimit të zgjedhjeve.

Duke qenë se regjistrimi i kandidatëve dhe i partive politike është një element kyç i çdo procesi zgjedhor që ndikon drejtpërdrejtë në natyrën konkurruese dhe cilësinë e procesit, duhet të mbikqyret nga MVZ-ja. Në qoftë se një MVZ mbërrin në vendin ku do të kryhen zgjedhjet pasi procesi i regjistrimit të kandidatëve është kryer në mënyrë të plotë ose të pjesshme, atëherë ai duhet të synojë të vlerësojë ndershmërinë dhe efektshmërinë e procesit nëpërmjet diskutimeve me punonjës, përfaqësues të partive dhe kandidatë, si dhe me ata kandidatë që u është mohuar regjistrimi.

### Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:

- Ndalimi, pezullimi ose çregjistrimi i partive ose kandidatëve;
- Politikat kufizuese ose diskriminuese në lidhje me krijimin ose veprimin e partive politike dhe grupeve të shoqërisë civile;
- Zbatim selektiv i ligjit në lidhje me regjistrimin e partive ose kandidatëve;
- Kërkesa për depozita të tepëruara, përfaqësim i detyruar rajonal, ose numër i tepëruar firmash për t'u regjistruar;
- Kërkesa të tepëruara gjuhësore;
- Skualifikimi i kandidatëve për shkelje të mëparshme të kodit administrativ ose rregullave administrative;
- Skualifikimi i kandidatëve ose partive për shkak të problemeve teknike në kërkesat e tyre; dhe
- Vonesa pa shkak ose pengesa administrative për regjistrimin e partive politike.

#### D. Regjistrimi i votuesve

**KRITERE TË PËRGJITHSHME PËR REGJISTRIMIN:** Të gjithë shtetasit e një vendi kanë të drejtë të votojnë me kusht që të kenë mbërritur moshën e caktuar dhe të mos jenë deklaruar të paaftë mendërisht nga një gjykatë. Regjistrimi i votuesve synon të sigurojë se të gjithë shtetasit kanë mundësi ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda një sistemi që lehtëson gjithashtu administrimin e zgjedhjeve dhe pengon votimin në grup. Përpilimi dhe mirëmbajtja e një regjistri votuesish në nivel kombëtar, ose e një liste votuesish në nivelin lokal ose rajonal, mund të jetë një nga elementët më të vështirë të një procesi zgjedhor. Vlerësimi i saktësisë së regjistrit të votuesve mund të jetë një sfidë për vëzhguesit.

Vendime të rëndësishme duhen marrë edhe lidhur me faktin nëse votuesit duhet të votojnë vetëm në vendbanimet e tyre të përhershme, apo nëse kanë të drejtë të votojnë edhe në vendbanimet e përkohshme apo kudoqoftë. Në qoftë se miratohet përçqasja e dytë, atëherë lind nevoja të zbatohet një sistem kontrolli e verifikimi për të parandaluar mundësinë e regjistrimeve të dyfishta dhe, së fundmi, mundësinë e votimit të dyfishtë.

Duhet të ketë klauzola të qarta ligjore për metodën e regjistrimit; afatin kohor të regjistrimit; kualifikimin dhe skualifikimin lidhur me shtetësinë, moshën dhe vendbanimin; mungesën e përkohshme; mjetet e identifikimit (dëshmi se e ka këtë të drejtë); formularin e regjistrimit; formatin e regjistrimit; publikimin e regjistrimit paraprak; vlefshmërinë dhe të drejtën për të kontrolluar regjistrin; procedurat për ankesa dhe padi; si dhe për publikimin e regjistrimit përfundimtar.

Sistemi eficient i regjistrimit të votuesve kërkon që popullsia të jetë aktive dhe të raportojë ndryshimin e vendbanimit të përhershëm, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme të statusit civil. Procedurat dhe mjetet e regjistrimit duhet të jenë sa më të thjeshta që të jetë e mundur dhe plotësisht të disponueshme për elektoratin. Listat e votuesve (ashtu siç janë nxjerrë nga regjistri kombëtar i votuesve, atje ku mund të bëhet kjo gjë) duhet të bëhen të ditura shumë kohë para zgjedhjeve, që të ketë mundësi për ankimime në rast përfshirjesh apo përgjashimesh të parregullta, si dhe për pasaktësi të tjera. Listat e votuesve nuk duhet të përmbajnë, ose duhet të mbrojnë me kujdes, të dhëna personale përtej atyre që kërkohen për të identifikuar një votues dhe për të përcaktuar të drejtën e tij ose të saj për të votuar.

Procesi i saktë i regjistrimit të votuesve mund të garantohet më së miri duke patur një regjistër të përhershëm, qendror, shtetëror votuesish, që mirëmbahet dhe përditësohet në mënyrë të rregullt. Një listë gjithëpërfshirëse dhe e kompjuterizuar mund t'i ndihmojë autoritetet për verifikimin e regjistrimit individual të qytetarëve dhe shmagjien e duplikimeve, duke përforcuar kështu ndryshimin e regjistrimit të votuesve. Gjithsesi, ka vende që nuk i kanë mundësitë për të përgatitur një regjistër votuesish të kompjuterizuar. Në sistemet federale, autoritetet rajonale e lokale mund të jenë përgjegjëse për listat e votuesve në nivel rajonal ose lokal. Për rrjedhojë, metodat e regjistrimit ndryshojnë nga vendi në vend, në varësi të rrethanave lokale.

**SISTEMET E REGJISTRIMIT TË VOTUESVE:** Vende të ndryshme kanë përdorur mjete të ndryshme për regjistrimin e votuesve. Sistemet e regjistrimit *aktiv* ose *afirmativ* kërkojnë që vetë votuesit të bëjnë kërkesë për t'u regjistruar gjatë një procesi zgjedhor. Në sistemet pasive, autoritetet hartojnë automatikisht regjistrin e votuesve në bazë të vendbanimit, regjistrin të shtetësisë ose dokumenteve të tjera të kësaj natyre. Të dy këto lloj sistemesh janë të pranueshëm, po që se mund të prodhojnë një regjistër votuesish gjithëpërfshirës, transparent dhe të saktë. Kohë pas kohe, mund të përdoren të dy tipet e sistemeve të regjistrimit. Disa prej shteteve anëtare lejojnë regjistrimin edhe ditën e votimit nëpërmjet një liste shtesë për ata votues emrat e të cilëve janë lenë jashtë listave të votuesve, dhe të cilët janë në gjendje të provojnë të drejtën e tyre ligjore.

Në disa vende, autoritetet përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrimit të votuesve mund të ngarkohen të lëshojnë certifikata të posaçme, edhe në ditën e votimit, në mënyrë që t'u japin mundësi votuesve, emrat e të cilëve nuk gjenden në listat lokale të votuesve, të votojnë.

Ndërkohë që kjo gjë u jep mundësi më të mëdha votuesve të ushtrojnë të drejtën e votës, këto lloj sistemesh kanë të ngjarë të jenë të hapur për shkelje. Kur përdoren këto çertifikata, vëzhguesit duhet të ndjekin hap pas hapi se si po zbatohet sistemi.

Në raste shumë të veçanta, votuesit mund të mos regjistrohen fare zyrtarisht, por duhet t'u kërkohet të dëshmojnë identitetin e tyre dhe të drejtën për të votuar ditën e votimeve në qendrën e votimit. Në raste të tilla duhet të merren masa të posaçme për t'u mbrojtur nga votimi në grup, siç është shenjimi i dokumenteve të identifikimit të votuesve, ose përdorimi i praktikës së bojës së pashlyeshme në gishtin e çdo votuesi.

**GARANTIMI I SAKTËSISË SË REGJISTRIT TË VOTUESVE:** Regjistri kombëtar i votuesve (në ato vende ku përdoret), ose listat rajonale e lokale kërkojnë përditësim të vazhdueshëm për të ruajtur saktësinë. Emigrimi dhe migrimi i brendshëm, ose zhvendosjet, mund të shkaktojnë lëvizje të konsiderueshme të popullsisë midis dy procesve zgjedhore. Vështirësia e identifikimit dhe regjistrimit ose reregjistrimit të një numri të madh votuesish të zhvendosur është një sipërmarrje kryesisht teknike, që kërkon fshirjen e emrave të një numri votuesish nga listat e vendbanimeve të dikurshme dhe shtimin e tyre në listat e vendbanimit të ri.

Duhet të ekzistojnë mjete mbrojtëse për të shmangur regjistrimin e shumëfishtë. Në qoftë se votuesit pajisen me një kartë të poscme votimi, atëherë duhen marrë masa të përshtatshme sigurie për të shmangur duplikimin e kartave. Në të gjithë vendet duhet të ketë një sistem që bën të mundur që personat e vdekur të hiqen nga listat, ndërsa ata që kanë arritur moshën e votimit të futen në lista. Kur gratë ndryshojnë emrat mbas martesës ose divorcit, ka rëndësi të sigurohemi që listat janë përditësuar në mënyrë që këto gra të mos humbasin të drejtën për të votuar. Sigurisht do të ishte ideale të merrreshin masa që shtetasit që janë jashtë shtetit të regjistroheshin e të votonin.

Vëzhguesit duhet të bëjnë kujdes e të vlerësojnë efektivitetin dhe gjithëpërfshirjen në procesin e regjistrimit të votuesve. Në mënyrë të veçantë, ata duhet të sigurohen se gjatë procesit të regjistrimit të votuesve nuk janë zbatuar kufizime të paarsyeshme. Kufizime të paarsyeshme janë të gjitha ato që mbështeten te raca, seksi, feja, origjina etnike, përkatësia politike në të shkuarën, gjuha, analfabetizmi, pronësia ose aftësia për të paguar një taksë regjistrimi. Ndërsa kufizimet e arsyeshme mund të përfshijnë faktorë të tillë si vendbanimi, shtetësia, burgosja për kryerjen e një krimi dhe paaftësia mendore e përcaktuar nga gjykata.

### **Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:**

- Mungesa e një regjistri qendror të votuesve;
- Regjistra dhe/ose lista jo të hapura ndaj publikut ose jo lehtësisht të kontrollueshme;
- Mungesa e rregullave të qarta për regjistrimin ose korigjimin e gabimeve në regjistra dhe/ose në lista;
- Mungesa e efektshmërisë në proceset e apelimit;
- Praktika diskriminuese;
- Mosregjistrimi i personave të zhvendosur brenda vendit;
- Procese regjistrimi që nuk janë lehtësisht të përdorshme për të gjithë shtetasit;
- Mosedukimi i votuesve lidhur me regjistrimin;

- Pasaktësi të mëdha në regjistër dhe/ose lista;
- Regjistra dhe/ose lista që përmbajnë të dhëna të panevojshme si etniciteti; dhe
- Moskthimi në mënyrë automatike i të drejtës për të votuar atyre personave që e kanë shlyer dënimin me burg.

## E. Votimi

**MODELI I FLETËS SË VOTIMIT:** Kompleksiteti ose thjeshtësia e fletës së votimit lidhet drejtpërdrejt me efektivitetin e procesit të votimit. Fletët e votimit duhet të jenë sa më thjeshta që të jetë e mundur dhe të atilla që të jenë të lehta për t'u kuptuar dhe për t'u mbushur nga votuesit. Fletët e votimit të ngatërruara dhe të stërgjata mund të shkaktojnë paqartësi në radhët e votuesve dhe të ngadalësojnë procedurat e votimit dhe të numërimit të votave. Në shoqëri shumëgjuhëshe, fletët e votimit duhet të përgatiten edhe në gjuhët përkatëse të minoriteteve më të mëdha. Në një shoqëri me shkallë të lartë analfabetizmi, do të ishte një praktikë e mirë që në fletët e votimit të përfshiheshin simbole lehtësisht të dallueshme përbri emrave të kandidatëve ose të partive. Renditja e kandidatëve në fletën e votimit duhet të përcaktohet me short ose në një mënyrë tjetër të ndershme.

**ELEMENTËT E SIGURISË NË FLETËN E VOTIMIT:** Fletët e votimit dhe materiale të tjerë po kaq sensitive të procesit zgjedhor duhet të mbikëqyren e të sigurohen gjatë gjithë kohës. Për të vlerësuar këto procese, vëzhguesit duhet të shikojnë se ku dhe si janë shtypur fletët e votimit, ku dhe si janë depozituar dhe shpërndarë, si dhe kur është kryer kjo gjë para fillimit të zgjedhjeve. Palëve të interesuara duhet t'u njihet e drejta për të vëzhguar shtypjen, shpërndarjen, dhe magazinimin e fletëve të votimit. Në disa vende, formulari i "protokollit të rezultateve", ose edhe materiale të tjera mund të jenë po aq sensitive sa edhe fletët e votimit, ndaj duhet që edhe ato t'u nënshtrohen masave të sigurisë. Sistemi i dëftësive për marrjen në dorëzim të tyre ndihmon për të rritur përgjegjshmërinë gjatë transportit, dorëzimit e magazinimit të fletëve të votimit, por edhe të materialeve të tjera të procesit zgjedhor.

Si një masë shtesë sigurie dhe mbrojtjeje kundër mashtrimit, në një sërë vendesh, gjatë procedurës së votimit, kërkohet që fletët e votimit të futen në zarf para se të hidhen në kutinë e votimit. Në të tilla raste, është jashtëzakonisht e rëndësishme të kuptohet se vota mund të identifikohet më shumë me përmbajtjen e zarfit se sa me fletën e votimit në vetvete, në varësi të fletës së votimit.

Në sistemet e votimit mund të përfshihen një numër masash të tjera mbrojtëse për të mbrojtur sigurinë dhe fshehtësinë e fletës së votimit, për shembull:

- Vulosja e fletëve të votimit me vulën e posaçme të qendrës së votimit në çastin kur u jepen votuesve, ose para se të futen në kutinë e votimit;
- Prania e një ose më shumë zyrtarëve në qendrën e votimit, të cilët firmosin në pjesën e pasme të fletës së votimit të paplotësuar, në kohën kur ajo i dorëzohet votuesit;
- Përdorimin e amës së bllokut të fletëve të votimit për të mbikëqyrur numrin e votave në kutitë e votimit;
- Përdorimi i një vule në vend të një pene për të shenjuar fletët e votimit;



- Përdorimi i një letre të trashë për fletët e votimit në mënyrë që shenjat të mos mund të shihen në pjesën e pasme të fletës së votimit; dhe
- Shtypja e fletëve të votimit në letër me përmbajtje filigrani ose mjete të tjera sigurie në mënyrë që të vështirësohet falsifikimi i tyre.

**SISTEMET E VOTIMIT TË REGJISTRIMIT TË DREJTPËRDREJTË ELEKTRONIK (RDE):** Teknologjitë e reja zgjedhore që përdorin pajisjet e regjistrimit të drejtpërdrejtë elektronik (RDE), (votimi elektronik, votimi automatik) kanë mundësi të lehtësojnë pjesëmarrjen e votuesve. Megjithatë, këto teknologji të reja mund të përbëjnë sfida përvoja të përkohshme të transparencës dhe llogaridhënjes gjatë një procesi zgjedhor. Veç kësaj, ato mund të influencojnë mendimet rreth sigurisë së votës, por mund të ndikojnë edhe në besimin e votuesve. Prandaj, është e rëndësishme të shihet mundësia e futjes së pajisjeve për votimin me RDE, atje ku gjykohet e përshtatshme, dhe nëse futja e këtij sistemi të ri do të ketë ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në mundësinë e vëzhgimit të procesit të votimit, krahasuar me votimin konvencional. Të gjitha këto çështje duhet të ndiqen nga afër nga një MVZ i ODIHR-it, kur shihet e arësyeshme.

Vëzhguesit ndërkombëtarë nuk mund t'i certifikojnë sistemet e votimit RDE. Gjithsesi, ata duhet të kenë akses të plotë në procesin e certifikimit dhe të verifikimit të pavarur vendas. Kriteret që përdorin autoritetet zgjedhore kur zgjedhin sistemet e votimit RDE, si dhe mënyra e futjes së tij në përdorim, duke përfshirë edukimin e votuesve dhe testimin pilot, janë po ashtu çështje të cilat duhet t'i mbikqyrë MVZ-ja.

Masat e mëposhtme mund të rezultojnë thelbësore për të rritur besimin e votuesve të teknologjitë e reja në procesin e votimit:

- Leje për individë kompetentë, institucione akademike ose grupe të shoqërisë civile që në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të pavarur të testojnë pajisjet e votimit automatik, duke iu nënshtruar kufizimeve të arsyeshme që lidhen vetëm me ligjin për patentat ose për të drejtën e autorit. Sidoqoftë, ky testim nuk duhet parë si një mjet zëvendësues për vendosjen e procedurave përfshirëse e transparente të certifikimit;
- Rregulla që ofrojnë garanci kundër konflikteve të mundshme të interesit të shitësve;
- Mjete që sigurojnë regjistrim të përhershëm në letër me mundësi kontrolli manual dhe që marrin seriozisht parasysh sigurimin e verifikimit të votës me gjurmë të shenjara në letër; dhe
- Përcaktimin e ndarjes së qarta të përgjegjësisë midis shitësve, agjencive të certifikimit dhe administratorëve zgjedhorë për të siguruar përgjegjëshmëri të plotë dhe zgjidhje të efektshme në rast dështimi të pajisjeve të RDE-së.

### **Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:**

- Fletë votimi panevojshmërisht të gjata ose komplekse që mund të pëshpëllojnë votuesit;
- Masa jo të duhura ose mungesë përgjegjëshmërie në çdo fazë të prodhimit të fletëve të votimit ose procesit të shpërndarjes;
- Fletë votimi që qarkullojnë jashtë qendrave të votimit ditën e votimit ose ditë më parë;

- Procedura në qendrën e votimit që mund të kompromentojnë fshehtësinë e votimit; dhe
- Sisteme të votimit elektronik që nuk sigurojnë verifikimin e votës sipas shenjave të qëndrueshme në letër ose kapacitete të tjera auditimi manual.

## F. Informimi i votuesve

Informimi dhe edukimi i mjaftueshëm lidhur me të drejtat qytetare si votues mund të jetë i nevojshëm për t'u siguruar që pjesëmarrësit në procesin elektoral të jenë plotësisht të informuar rreth të drejtave dhe përgjegjësi të tyre si votues. Këto përpjekje mund të shtojnë dijet dhe interesin rreth procesit zgjedhor, si dhe të krijojnë klimën e duhur për debat të hapur. Vëzhguesit duhet të vlerësojnë shkallën dhe efektivitetin e informacionit dhe edukimit qytetar e votues.

Edukimi i votuesve duhet t'i informjë votuesit se kur, si dhe ku të regjistrohen për të votuar, ose të verifikojnë që janë regjistruar ashtu siç duhet. Nga ana tjetër, duhet gjithashtu të shpjegojë se kur, si, dhe ku duhet të shkojë për të votuar ditën e votimit. Është thelbësore që ky informacion të jepet në kohën e duhur, duke iu dhënë mundësi votuesve ta përdorin informacionin e përfituar. Përpjekjet për edukimit qytetar të votuesve mund të përqëndrohen edhe në zgjedhjet që mund të bëjë një votues si dhe në rëndësinë e këtyre zgjedhjeve në kuadrin e sistemit politik përkatës.

Informacioni duhet të jetë i lirë dhe i disponueshëm për të gjithë votuesit. Ndërsa partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile mund të kontribuojnë në përpjekjet e edukimit qytetar e votues, tekefundit përgjegjësia është e autoriteteve, duke përfshirë këtu administratën zgjedhore, për të siguruar që votuesit të përfitojnë një informacion objektiv, të paanshëm, dhe në kohën e duhur. Media shtetërore, ose ajo që financohet me fonde publike, ka gjithashtu një përgjegjësi të veçantë për të siguruar që votuesit të marrin informacion të balancuar dhe të mjaftueshëm për kandidatët dhe çështjet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor në mënyrë që t'u japin atyre mundësi të bëjnë zgjedhje të mirinformuara.

Është mëse e arsyeshme që të bëhen përpjekje të veçanta për edukimin e votuesve të atyre segmenteve të popullsisë që kanë tradicionalisht një përqindje të ulët në votime; në disa vende këtu mund të hyjnë grupet e pakicave, gratë, ose të rinjtë. Do të ishte një praktikë e mirë që edukimi i votuesve të bëhej në gjuhët e grupeve më të mëdha të minoriteteve, si edhe në gjuhën mbizotëruese të vendit.

### Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:

- Informacioni rreth procesit zgjedhor mund të merret tepër vonë;
- Informacioni i dhënë nga autoritetet lokale ose qendrore mund të jetë i njëanshëm, p.sh. duke treguar një fletë votimi të mbushur në favor të një prej kandidatëve;
- Grupe të caktuara votuesish mund të mos marrin fare informacion ose mund të mos e kuptojnë informacionin;
- Ndryshimet në procedurat zgjedhore mund të mos bëhen të ditura publikisht aq sa duhet;
- Qytetarët që votojnë për herë të parë mund të mos i njohin procedurat; dhe
- Qytetarët që ndodhen jashtë vendit si refugjatë ose persona të zhvendosur mund të mos i kuptojnë procedurat e kërkuara.

## 7.3 Fushata Zgjedhore

### A. Fushata politike

**LIRIA PËR TË BËRË FUSHATË:** Angazhimet e OSBE-së kërkojnë që ligji dhe puna për politikat publike të lejojnë që fushata politike të kryhet në një atmosferë të lirë e të ndershme, ku as veprimet administrative, as kanosjet e ndryshme të mos i pengojnë partitë dhe kandidatët që të paraqesin lirshëm pikëpamjet dhe dijet e tyre. Liritë themelore, siç janë e drejta e lirisë së shprehjes, mbledhjes dhe shoqërimit duhet të respektohen në të gjitha kohët. Nuk duhet të ketë kurrfarë kufizimesh arbitrare ose të paarsyeshme përsa u takon veprimtarive të fushatës, takimeve dhe tubimeve. Në qoftë se lypsen leje për tubimet ose demonstrimet publike, ato duhet t'u jepen njëllloj të gjitha palëve në fushatë. Qeveria është përgjegjëse për respektimin e të gjitha këtyre të drejtave.

Ka rëndësi të veçantë që fushata të zhvillohet në një atmosferë të lirë nga frika dhe dhuna. Nuk duhet të ketë prishje të takimeve të njëjës palë në fushatë. Qytetarët nuk duhet t'u tremben ndëshkimeve, siç mund të jetë humbja e vendit të punës, për t'u aktivizuar në fushatë. Të gjithë njerëzit duhet të jenë të lirë nga frika e autoriteteve; vëmendje e veçantë në këtë drejtim duhet t'u kushtohet grupeve të tilla si studentëve, ushtarëve, ose udhëheqësve lokalë. Veprimtarët politikë nuk duhen ngacmuar, siç mund të jetë me anë të ndalesave administrative ose taksave të papritura të auditimit.

Teksa autoritetet janë përgjegjëse për të siguruar një mjedis të qetë e të sigurtë për veprimtaritë e fushatës, problemet e sigurisë nuk duhet të keqpërdoren e të shfrytëzohen si pretekst për të kufizuar liritë themelore. Gjatë gjithë fushatës zgjedhore dhe procesit të votimit, forcat e sigurisë duhet të të mos i frikësojnë të tjerët dhe, nga ana tjetër, duhet të pengojnë frikësimet prej të të tjerëve. Frika e kanosjeve e ushtruar nga forcat e sigurisë mund të kenë një efekt tejet të mbarshtë të kandidatët dhe votuesit. Ndërkohë që mund të jetë e vështirë t'i llogarisësh rastet e kanosjes dhe, në disa raste, edhe t'i provosh ato, tendencat e përhapura të kanosjes, sidomos nga forcat e sigurisë, mund të dallohen qartë.

Duhet të ekzistojnë rrugëzgjidhje efektive gjyqësore, që të shërbejnë për të gjitha ato raste kur gjatë fushatës shkelen të drejtat e kandidatëve ose të partive, ose për ato raste kur imponohen kufizime të paarsyeshme ndaj zhvillimeve të fushatës. E megjithatë, në qoftë se gjatë fushatës përdoret gjuha e urrejtjes, ose gjatë fjalimeve bëhet thirrje për dhunë, atëherë kjo gjuhë duhet censuruar dhe përdoruesit e saj duhet të përgjigjen para ligjit.

**KONTEKSTI POLITIK:** Ndonëse interesimi parësor i vëzhguesve është procesi zgjedhor, gjithësesi, ata duhet të kenë njohuri për kontekstin politik dhe për çështjet që lidhen me procesin zgjedhor konkret. Për këtë arsye, vëzhguesit duhet të takohen me kandidatë dhe parti, të vëzhgojnë mitingjet, si dhe t'u hedhin një sy materialeve të fushatës me qëllim që të kuptojnë proceset politike në vend dhe çështjet që mbizotërojnë në fushatën zgjedhore. Vëzhguesit duhet të vlerësojnë se deri në ç'shikallë popullsia – duke përfshirë këtu edhe grupet e pakicave dhe gratë – është aktive në procesin politik, si dhe të përpiqet të kuptojë arsyet e të mos qenit aktiv. Përveç partive politike dhe kandidatëve, burime të tjera të mira informimi në lidhje me fushatën mund të jenë edhe organizatat jo qeveritare, grupet e vëzhguesve vendas, akademikët dhe specialistët, si dhe përfaqësuesit e medias.

## Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:

- Format e dhunës në fushatë;
- Ndalimi i kandidatëve ose aktivistëve;
- Ndërhyrjet dhe prishjet e takimeve gjatë fushatës, ose të gjitha mënyrat e kufizimeve të mbledhjeve ose mitingjeve, duke përfshirë këtu edhe refuzimet për të dhënë leje;
- Raportimet për rastet e kanosjeve ose formave të tjera të dhunës;
- Përjashtimi i grave ose grupeve minoritare nga procesi politik;
- Përpjekjet sistematike për të shkullur ose deformuar pllakatat e fushatës; dhe
- Vendosja e materialeve të paatribuara për fushatën.

### B. Burimet e fushatës

**FINANCIMI I FUSHATËS:** Financimi i fushatës duhet të jetë transparent, ndaj dhe lypset një legjislacion ose rregulla të qarta që përcaktojnë mënyrën e administrimit të fondeve të fushatës. Ky legjislacion duhet të zbatohet njëllë për të gjithë kandidatët dhe partitë. Një praktikë pozitive është ajo e bërjes publike e të gjitha shpenzimeve të kryera gjatë fushatës, para edhe pas saj, prejardhja e fondeve, dhe mënyra e kryerjes së shpenzimeve. Në ato raste kur qeveria jep fonde për fushatën, kjo gjë duhet bërë në baza barazie dhe ndershmërie.

Kufizimet lidhur me mbledhjen e fondeve dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatës nuk duhet të bëhen aq shtrënguese sa kandidatët të mos kenë mundësi të mbulojnë shpenzimet bazë të fushatës, siç janë rrogat, transporti, shpenzimet e zyrës, blerja e hapësirës në media, si dhe shtypja dhe shpërndarja e materialeve të fushatës. Kufizime të arsyeshme mund të jenë të gjitha ato që, fjala vjen, kanë të bëjnë me ndalimin e financimit të fushatës nga burime të huaja, korporata publike, ose burime anonime.

**PËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE:** Është detyrë e qeverisë të sigurojë që burimet publike dhe administrative, si materiale, ashtu edhe njerëzore, të mos përdoren në mënyrë abuzive në përkrahje të një kandidati ose partie të veçantë. Për shembull, mjediset e zyrave qeveritare, automjetet dhe pajisjet e telekomunikacionit nuk duhet të përdoren për qëllime partiake, me përjashtim të rastit kur të gjitha palëve në garë u ofrohet akses i barabartë. Në qoftë se ndërtesat publike ose mjediset e tjera publike janë të disponueshme për zyra ose mbledhje gjatë fushatës, ato duhet t'u ofrohen të gjitha palëve në mënyrë të barabartë.

Ligji duhet të jetë i qartë përsa i takon shkallës së angazhimit të punonjësve civilë ose nëpunësve të tjerë publikë gjatë fushatës zgjedhore. Nëpunësit publikë duhet që të paktën të ndajnë qartë e prerazi rolin e tyre si punonjës civilë nga veprimtaritë e fushatës ku mund të angazhohen. Nëpunësve publikë nuk duhet t'u kërkohet të marrin pjesë në ngjarjet e fushatës, ose të shtrëngohen për të votuar për një parti ose kandidat të caktuar.

**KOHA SI BURIM:** Koha është gjithashtu një burim i rëndësishëm për të zhvilluar një fushatë zgjedhore kuptimplotë. Të gjithë konkurrentët duhet të kenë një periudhë të barabartë kohe për të zhvilluar fushatën. Kohëzgjatja e fushatës duhet të jetë e tillë që t'u japë mundësi konkurrentëve të organizohen efektivisht e t'i përcjellin programet e tyre politike elektoratit.

Ligji duhet të jetë i qartë për sa i përket veprimtarive politike që lejohen jashtë periudhës zyrtare të përcaktuar me ligj, dhe kur lejohen, duhet të përcaktojnë shkallën deri sa lejohen.

### Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:

- Rregulla të paqarta ose të diskutueshme lidhur me financimin e fushatës;
- Fondet publike të fushatës që nuk janë marrë në kohën e duhur;
- Kufij tepër të ulët për mbledhjen dhe shpenzimet e fondeve për të mundësuar bërjen e një fushate efektive;
- Mungesa e transparencës për financimin e fushatës dhe për shpenzimet e kryera gjatë saj;
- Përdorim jo i barabartë i burimeve publike nga palët;
- Përfshirja në fushatë e punonjësve civilë dhe e drejtuesve ushtarakë;
- Fushatë tepër e shkurtër nga pikpamja kohore për t'iu dhënë mundësi partive të organizohen dhe të përcjellin mesazhet e tyre; dhe
- Mungesa e një date të qartë për fillimin e fushatës dhe/ose regjistrime në kohë të ndryshme të kandidatëve si rrjedhojë e të cilës periudhat kohore për zhvillimin e fushatës bëhen të pabarabarta.

## 7.4 Media

**LIRIA E MEDIAS:** Një media e lirë dhe e pavarur është element jetik në një proces zgjedhor të vërtetë demokratik. Autoritetet duhet të sigurojnë që media të ketë të drejtë të mbledhë informacione e t'i raportojë ato lirisht, pa u ndjerë e kërcënuar ose e penguar, dhe që të mos ushtrohet asnjëfarë censure mbi median dhe kandidatët. Angazhimet e OSBE-së, të pranuar nga të gjithë vendet anëtare, bëjnë thirrje për një përdorim pa pengesa dhe pa dallime të medias nga të gjitha grupimet politike dhe individët që dëshirojnë të marrin pjesë në një proces zgjedhor.

Media, e marrë në tërësi, ka përgjegjësinë që të ofrojë informacion të balancuar e të mjaftueshëm në mënyrë që t'u japë mundësi zgjedhësve të bëjnë zgjedhje sa më të mirinformuara. Në qoftë se spotet e paguara politike lejohen në median publike dhe private, atëherë kostoja dhe kushtet duhet të jenë sa më të arsyeshme dhe të barabartë për të gjithë kandidatët.

**MEDIA PUBLIKE:** Mediat shtetërore ose mediat publike kanë një përgjegjësi të veçantë për të siguruar një informacion asnjansës dhe të balancuar për zgjedhjet dhe palët e angazhuara në to. Të gjitha mendimet e kundërta duhet të komunikohen në mënyrë të ndershme e të barabartë. Është praktikë e mirë ajo e medias publike që të paktën u ofron kohë të lirë për transmetim ose hapësirë në shtypin e shkruar kandidatëve ose partive. Ndërkohë që ofiqarët zyrtarë mund të përfitojnë mbulim mediatik falë funksioneve të tyre zyrtare, kjo gjë nuk duhet shfrytëzuar si mjet për t'u siguruar atyre përfitime të pamërituara; pra, evenimentet e fushatës nuk duhen ngatërruar me punët e shtetit.

**MEDIA PRIVATE:** Në varësi të rregullave dhe ligjeve të vendit, media private nuk është e thënë të ketë të njëjtën përgjegjësi si media publike për të ruajtur neutralitetin dhe balancën. Për shembull, gazeta e një partie politike është mëse e natyrshme që të shërbejë si platformë për një parti të caktuar politike dhe nuk do të ishte aspak e paarsyeshme që një gazetë private të

mbështeste një kandidat në politikën e vet editoriale. Sidoqoftë, një MVZ e ka për detyrë të monitorojë si organet e medias publike ashtu edhe të asaj private, për të parë ndikimin e tyre mbi fushatën dhe nëse elektorati përfiton nga të gjitha burimet informacion të mjaftueshëm e të balancuar për të marrë vendime sa më të informuara.

**MONITORIMI I MEDIAS:** ODIHR përdor një metodologji specifike për të vlerësuar mbulimin nga mediat të fushatës zgjedhore, si në aspektin sasior, ashtu edhe atë cilësor. Analisti i medias koordinon ekipin e analistëve, i cili monitoron stacionet e mëdha televizive dhe gazetatat, dhe vlerëson si sasinë e kohës, ashtu edhe hapësirën që i kushtohet secilës palë, dhe nëse ky mbulim është pozitiv, negativ ose neutral. Kjo analizë përbën bazën kryesore për vlerësimin e rolit të medias në zgjedhje. Një MVZ sheh gjithashtu nëse ligjet për median lejojnë lirinë e medias gjatë fushatës, sa mirë respektohet kjo liri, sa dhe si po i përmbushin detyrimet e tyre organet rregulluese të medias, nëse ankesat e parashtuara trajtohen me ndershmëri e në mënyrën e duhur, dhe nëse zbatohen sanksionet që mund të jenë vendosur.

### **Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:**

- Shpifje për kandidatët ose shtrembërim i mesazheve të kandidatit nga ana e medias;
- Trajtim jo i barabartë i partive ose kandidatëve nga media publike;
- Mbyllje e organeve të medias elektronike ose asaj të shkruar;
- Kërcënim ose ngacmim i medias;
- Ndalimi ose ngacmimi i gazetarëve;
- Gjykim për shpifje kundër organeve të medias;
- Manipulim me mjetet e furnizimit me letër ose bojë;
- Ndërhyrje në rrjetet e shpërndarjes së medias së shkruar;
- Pagesa tejet të larta për hapësira publicitare;
- Hapësirë e lirë transmetimi e caktuar në kohën e shikueshmërisë më të ulët; dhe
- Organe të paefektshme rregullatore të medias, që nuk ndërmarrin veprimet e duhura rregulluese.

# 8.

## Vëzhgimi ditën e zgjedhjeve



Përgjegjësia për vëzhgimin e veprimtarive ditën e zgjedhjeve bie mbi ekipin bërthamë, VAGj-ët dhe VASH-ët. E megjithatë, VASH-ët janë burimi i parë i misionit për vëzhgimin dhe vlerësimin e procedurave në qendrat e votimit gjatë ditës së zgjedhjeve, si dhe në nivele të ndërmjetme të administratës zgjedhore. Ditën e zgjedhjeve VASH-ët dërgohen në të gjithë vendin, të ndarë në ekipe me përbërje ndërkombëtare prej dy vetësh, për të vëzhguar qendrat e votimit si dhe qendrat e numërimit të votave.

Vëzhgimi gjatë ditës së zgjedhjeve mund të jetë një përvojë shumë individuale, çka varet nga zona ku janë vendosur si dhe nga numri i rrethanave me të cilat shkon e përballet çdo ekip vëzhguesish në qendrat e votimit që vizitojnë. Disa prej vëzhguesve mund të ndeshen me probleme të mëdha, të tjerë mund të mos hasin kurrfarë problemi dhe një tjetër grup mund të shohë një pamje të përzierë. Metodologjia e vëzhgimit të zgjedhjeve nga ana e ODIHR-it, që parashikon kontributin e ofruar nga çdo skuadër vëzhguesish, është ndërtuar në mënyrë të atillë që të japë një pamje gjithëpërfshirëse të ecurisë së ditës zgjedhore. Vëzhguesit plotësojnë formularë në çdo qendër votimi dhe qendër numërimi që vizitojnë, çka jep një informacion të hollësishëm rreth procesit të votimit dhe të numërimit dhe që, nga ana e vet, e pajis misionin e vëzhgimit zgjedhor me një përshkrim gjithëpërfshirës të veprimtarive të qendrave të votimit në mbarë vendin, mbi të cilin më pas mund të nxirren konkluzione bazuar mbi një përvojë kolektive.

Prandaj dhe metodologjia e ODIHR-it për ditën e zgjedhjeve rrok dy aspekte, si atë cilësor ashtu edhe sasior. Plotësimi i formularëve në qendrat e votimit siguron bazën për një analizë statistikore në të gjithë vendin lidhur me zbatimin e procedurave kyçe ditën e votimit. Ndërkohë që ekziston një formular standard i hartuar si një listë verifikimi për procedurat e ndjekura në qendrat e votimit dhe ato të numërimit, formularët ndryshojnë në varësi të procedurave konkrete të çdo vendi (shih Aneksin B për modelin e një formulari). Formulari siguron që të ndiqen dhe raportohen si duhet të gjitha aspektet e rëndësishëm të procesit ditën e zgjedhjeve, dhe të përcaktohen në mënyrë të drejtë tendencat më të spikatura. Analisti statistikor i MVZ-së përgatit një analizë sasimore të rezultateve të vëzhgimit.

Përveç plotësimit të formularëve, VASh-ëve u kërkohet të bëjnë komente mbi vëzhgimet e kryera prej tyre ose të japin përshtypje që ia vlejné të përmenden si me shkrim në formular, ashtu edhe me gojë gjatë shkëmbimit të informacionit. Ngandonjëherë atyre mund t'u kërkohet të përgatisin raporte të veçantë me shkrim lidhur me ndonjë incident, ose për pjesë të veçuara gjatë vëzhgimit. Komentet e bëra me kujdes nga ana e VASh-ëve mund të jenë jashtëzakonisht të rëndësishme për të përcaktuar nëse shkelje të caktuara gjatë ditës së votimit kanë ndodhur në të gjithë vendin, apo vetëm në rajone të veçanta. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që VASh-ët të përcaktojnë në formularë nëse i kanë pare me sy parregullsitë e vërejtura, apo u janë raportuar nga të tjerë, fjala vjen nga ndërmjetës, punonjës të qendrave të votimit, apo nga vëzhgues vendas.

Vëzhguesit duhet të demonstrojnë nivelin më të lartë të maturisë vetjake dhe sjelljes profesionale gjatë gjithë kohës që janë duke kryer detyrat e tyre si vëzhgues. Ata nuk duhet të harrojnë se janë ftuar për të vëzhguar procedurat e procesit zgjedhor të vendit pritës përkatës dhe se, gjatë këtij procesi, nuk përfaqësojnë as vetveten, as vendin prej nga ardhur, por një organizatë ndërqeveritare. Për rrjedhojë sjellja e tyre do të ndikojë në imazhin e OSBE-së. Vëzhguesit duhet të mbajnë shenjat e identifikimit dhe të paraqesin kartat e akreditimit kur u kërkohet.

Ndërkohë që vëzhguesve nuk u lejohet t'u japin këshilla ose udhëzime punonjësve zgjedhorë, ata mund të tërheqin vëmendjen e këtyre të fundit për probleme ose parregullsi të ndryshme dhe të vëzhgojnë se si e në ç'mënyrë i trajtojnë ata problemet e paraqitura. Vëzhguesit duhet të regjistrojnë të gjitha shkeljet dhe parregullsitë. Formularët dhe informacionet gojore të vëzhguesve do të shpalosin eventualisht shkallën dhe seriozitetin e këtyre problemeve.

## 8.1 Shpërndarja

Ekipi bërthamë dhe VAGj-ët përgatisin planin e shpërndarjes së VASh-ëve në mënyrë të atillë që ekipet e vëzhguesve të mbulojnë në mënyrë të balancuar vendin ditën e zgjedhjeve dhe që ekipet e vëzhguesve të mos duplikojnë punën e njëri-tjetrit. Në mënyrë që vëzhgimi i zgjedhjeve të jetë sa më efektiv, është më se i nevojshëm të ketë një element befasie në vizitat në qendrat e votimit dhe qendrat e numërimit; kështu, planet e shpërndarjes së vëzhguesve nuk bëhen publike para se të fillojë shpërndarja.

Plani i shpërndarjes mbulon si zonat urbane, ashtu edhe ato rurale dhe mban parasysh diversitetin social të një vendi. Plani i shpërndarjes duhet gjithashtu të sigurojë që disa prej vëzhguesve të vizitojnë komisionet elektorale rajonale. Në ato raste kur votimi kryhet në kazermat e ushtrisë, burgje ose spitale, ose nëpërmjet kutive të lëvizshme të votimit, plani i shpërndarjes duhet të mbajë parasysh edhe këtë lloj të veçantë të procedurës së votimit.

Vëzhguesit duhet të dërgohen në ekipe prej dy vetësh. Përvojat e ndryshme të vëzhguesve të një ekipi, që përfshin qytetarë nga vende të ndryshme pjesëtare të OSBE-së, ndihmojnë për të krijuar një ide sa më të gjera e më të balancuar të punës që bëhet në çdo qendër votimi. Çdo ekip duhet të plotësojë vetëm një formular për një qendër votimi; kjo kërkon që VASh-ët e çdo ekipi të merren vesh me njëri tjetrin për përfundimet e arritura. Kjo gjë siguron një verifikim shtesë lidhur me saktësinë e përfundimeve të arritura prej çdo ekipi vëzhguesish.



Normalisht VASh-ët dërgohen në zonën që kanë nën përgjegjësi të paktën një ditë të plotë para ditës së zgjedhjeve. Kjo gjë bëhet për të siguruar që VASh-ët të kenë kohë për t'u familjarizuar me zonën ku do të kryejnë vëzhgimin si dhe për të marrë udhëzimet në vend para ditës së votimit.

Në varësi të kushteve gjeografike dhe rrethanave që mund të hasen në qendrat e votimit, një ekip vëzhguesish mund të vizitojë afërsisht 10 qendra votimi gjatë ditës së zgjedhjeve. Çdo ekipi VASh-ësh i jepet një listë konkrete e qendrave të votimit, por janë vetë vëzhguesit që vendosin rendin sipas të cilit ata do të vizitojnë qendrat e votimit. E megjithatë, nuk është e thënë që vëzhguesit të kenë kohë t'i vizitojnë të gjitha qendrat e votimit brenda një dite. Ata duhet të qëndrojnë jo më pak se gjysmë ore në çdo qendër që vizitojnë. Ata mund të vendosin të kthehen në të njëjtën qendër votimi më shumë se një herë, sidomos në qoftë se besojnë se në aksh qendër ka probleme që meritojnë të vëzhgohen nga afër. Në të tilla raste, ekipi do të mbushë një formular të veçantë për çdo vizitë. Vëzhguesit duhet ta kenë të qartë se vëzhgimi i zgjedhjeve nuk është një garë për të vizituar numrin më të madh të qendrave të votimit, kështu që, ngadonjëherë mund të jetë më dobiprurëse të vizitohen më pak qendra votimi, por të qëndrohet një kohë më të gjatë në to.

Është e rëndësishme që VASh-ët t'i përmbahen planit të shpërndarjes, si dhe udhëzimeve se kur e si të dorëzojnë formularët, dhe të marrin pjesë në seancën e shkëmbimit të mendimeve. Mosvajtja në qendrën e votimit që është caktuar ose të vizituarit e qendrave të votimit që nuk janë në listën e tyre, mund të shpjerë në duplikimin e punës me vëzhguesit e tjerë dhe në shprishjen e balancës së ndërtuar në planin e shpërndarjes së tyre në të gjithë vendin. Mosraportimi sipas afatit kohor të paracaktuar mund të bëjë që formularët të merren tepër vonë dhe të mos kihen parasysh në kohën e përgatitjes së deklaratës paraprake të MVZ-së.

## 8.2 Aktivitetet në qendrën e votimit

Qëllimi kryesor i vëzhgimit të zgjedhjeve në nivel qendre votimi është të vlerësojë nëse procesi i votimit dhe i numërimit të votave është kryer në mënyrë korrekte dhe të rregullt, si dhe në përputhje me rregullat zgjedhore, angazhimet e OSBE-së dhe parimet e tjera universale. Vëzhguesit duhet të jenë të vetëdijshëm se ndonjë gabim i kryer nga punonjësit zgjedhorë mund të ndodhë më shumë për shkak të mungesës së përvojës ose mostrainimit, se sa për shkak të ndonjë veprimi të qëllimtë për të komprometuar ndershmërinë e procesit. Nga ana tjetër, parregullsitë e bëra me dashje dhe në mënyrë sistematike kanë të ngjarë ta shtrembërojnë procesin, ndaj dhe përfundimet e përgjithshme të raporteve të VASh-ëve duhet të vënë pa ngurrim në pah parregullsitë e vazhdueshme.

Në rast të konstatimit të parregullsive, vëzhguesit duhet t'i sjellin në vëmendjen e zyrtarëve zgjedhorë, por në asnjë mënyrë nuk duhet të marrin përsipër të japin këshilla apo udhëzime, ose të përpiqen t'u kundërvihen vendimeve të marra nga punonjësit zgjedhorë. Gjithsesi, ata duhet të vëzhgojnë se si dhe nëse zyrtarët zgjedhorë i trajtojnë parregullsitë e raportuara, si dhe ta përfshinë këtë informacion në raportet e tyre. Në rast parregullsish serioze, siç mund të jenë tejmbushja e kutive të votimit ose ndryshimi i protokolleve të rezultateve në çdo nivel të administratës zgjedhore, vëzhguesit duhet t'u a bëjnë menjëherë të ditur VAGj-ëve që janë përgjegjës në zonën përkatëse ku janë vendosur.

Në rast ushtrim dhune ose kërcënimesh serioze për dhunë, VASH-ët duhet të largohen menjëherë nga zona. Ata nuk duhet të venë vetveten, përkthyesin, apo shoferin në rrezik për jetën. Edhe këto lloj incidentesh duhet t'u raportohen menjëherë VAGj-ëve.

Zakonisht vëzhguesit duhet të mbërrin në kohë në qendrën e parë të votimit për të vëzhguar procedurat e hapjes. Momente të rëndësishme për t'u vëzhguar në çastin e hapjes janë nëse qendra e votimit është hapur në kohën e parashikuar, nëse komisioni i qendrës zgjedhore është i njohur me procedurat dhe nëse votimi në qendrën përkatëse të votimit fillon në mënyrë eficiente dhe sipas rregullave. Është e rëndësishme të shënohet nëse kutitë e votimit janë të zbrazura pa filluar procesi; nëse janë vulosur siç duhet; dhe nëse qendra e votimit ka marrë e zotëron në sasi të nevojshme fletë votimi të pambushura, si dhe gjithë materialet e tjera të domosdoshme. VASH-ët janë të pajisur me një formular të veçantë për ta plotësuar me përshtypjet dhe komentet e tyre lidhur me procedurat e hapjes së qendrave të votimit.

#### **A. Vëzhgime të kryera jashtë qendrës së votimit dhe pas hyrjes në qendër**

VASH-ët duhet të vëzhgojnë kushtet e përgjithshme jashtë dhe rreth e qark qendrave të votimit. Në këtë rast ka një sërë çështjesh që janë të rëndësishme:

- A ka materiale të fushatës ose veprimtari që flasin për fushatë brenda ose në afërsi të qendrës së votimit?
- A ka turma njerëzish rreth e qark qendrës së votimit? Në qoftë se votuesit janë duke pritur jashtë radhën për të votuar, a janë duke e kryer këtë gjë me qetësi e me rregull? Në qoftë se njerëzit që përbëjnë turmën nuk janë votues, a ka ndonjë tregues që të thotë se kujt i përkasin?
- A ka dëshmi frikësimi ose shqetësimesh?
- A nxiten votuesit të votojnë në një mënyrë të caktuar?
- A ka personel sigurie të pranishëm dhe në qoftë se po, a sillen në mënyrën e duhur ose jo?
- A paraqet vështirësi hyrja në qendrën e votimit? A ka gjasë që një person i paaftë fizikisht të hyjë në qendër pa ndihmën e duhur?

Vëzhguesit duhet të jenë të vetëdijshëm për çdo tension të pazakontë që mund të ekzistojë kur ata hyjnë në qendrën e votimit, si për shkak të pranisë së tyre ose për arsye të tjera. Pikërisht ato pak minuta të para mund të jenë vendimtare për krijimin e një përshtypjeje të menjëhershme e realiste të situatës në qendrën e votimit. Sidoqoftë, për ta vlerësuar situatën në mënyrë më të hollësishme lypset më shumë kohë, ndaj dhe vëzhguesit duhet të rrijnë aty sa më shumë kohë që të jetë e mundur për të formuar një përshtypje sa më të saktë.

#### **B. Pyetje për komisionerët e qendrës së votimit**

Në çastin që hynë në qendrën e votimit, VASH-ët duhet së pari të prezantojnë vetveten si vëzhgues të akredituar te kryetari i komisionit të zgjedhjeve të qendrës së votimit dhe paskëtajt shkurtimisht të shpjegojnë natyrën e vizitës së tyre. Në qoftë se komisionerët e kundërshtojnë praninë ose veprimtarinë e tyre, atëherë VASH-ët duhet t'u shpjegojnë me qetësi se janë ftuar nga qeveria dhe se janë të akredituar zyrtarisht për të vëzhguar zgjedhjet. Gjithsesi, ata nuk duhet të debatojnë me kryekomisionerin/kryekomisioneren dhe duhet t'u binden udhëzime të tyre. Në qoftë se udhëzimet e dhëna e bëjnë të pamundur që VASH-ët të kryejnë detyrat e tyre, atëherë rrethanat duhet të përshkruhen në mënyrë të hollësishme në seksionin *Komente*

të formularit dhe t'i raportohen sa më parë që të jetë e mundur VAGj-it që është përgjegjës për atë zonë.

Kurdoherë që është e mundur, vëzhguesit duhet të flasin me një numër sa më të madh komisionerësh të ndryshëm në qendrat e votimit, sidomos kur ata përfaqësojnë parti të ndryshme politike. Ka një numër pyetjesh të dobishme që VASh-ët mund t'u bëjnë komisionerëve në qendrat e votimit. Një pjesë e tyre gjenden edhe në formularët e vëzhgimit. Pyetjet e tjera mund edhe të mos jenë në formularë, por i ndihmojnë VASh-ët të përftojnë një përshtypje të qartë dhe kuptim sa më të mirë të procedurave zgjedhore. Pyetjet e mundshme për komisionerët në qendrat e votimit janë si më poshtë:

- Si janë zgjedhur komisionerët e qendrave të votimit? A përfaqësojnë ndonjë parti politike? Çfarë pune bëjnë zakonisht?
- A janë të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit? A i kanë nxjerrë pengesa ndonjë anëtar i komisionit për të shërbyer pranë qendrës së votimit?
- Si janë ndarë detyrat midis komisionerëve në mënyrë që votuesit të përfitojnë nga një procedim eficient dhe i sigurtë?
- A i janë nënshtruar trainimit zyrtar komisionerët e qendrës së votimit?
- Në ç'kohë janë marrë fletët e votimit dhe materialet e tjera të procesit zgjedhor, dhe si janë siguruar para ditës së zgjedhjeve?
- Sa fletë votimi janë marrë nga qendra përkatëse e votimit?
- A janë të mjaftueshme fletët e votimit si dhe materialet e tjera të nevojshme për një proces normal zgjedhor?
- Sa është numri i përgjithshëm i votuesve sipas listës së votuesve në qendrën e votimit dhe sa votues kanë votuar deri në atë moment? (Kjo mund t'u shërbejë vëzhguesve për të krijuar një ide rreth prirjes për të marrë pjesë në votime.)
- A ka ndonjë listë votuesish shtesë për të sëmuret dhe të moshuarit që duan të votojnë në shtëpi me kuti votimi të lëvizshme dhe, në qoftë se po, a është jashtëzakonisht i lartë numri i emrave në listën shtesë të votuesve?
- A ka pasur votues që janë kthyer pa votuar ngaqë emri i tyre nuk gjendet në listën e votuesve të kësaj qendre votimi? Në qoftë se ka pasur votues që nuk kanë pasur me vete dokumentin e duhur të votimit, si është vepruar me ta?
- A ka pasur shqetësime, parregullsi ose ankesa dhe në rast se po, si janë zgjidhur?

Vëzhguesit duhet gjithashtu të përpiqen të vlerësojnë nëse komisionerët janë të trainuar siç duhet dhe të familjarizuar me procedurat e votimit. Ata duhet të vlerësojnë edhe nëse komisionerët ndjehen të lirë të flasin rreth detyrave të tyre. Dhe çka është më e rëndësishmja, vëzhguesit duhet të jenë vigjilentë për të pare nëse komisionerët po veprojnë në mënyrë të paanshme.

### **C. Vëzhgimi i procedurave në qendrat e votimit**

Përveç bisedave me komisionerët në qendrat e votimit, VASh-ët duhet të vëzhgojnë me kujdes të gjitha procedurat në qendrat e votimit. Ata duhet të udhëhiqen nga formularët që u janë dorëzuar, ku gjenden edhe pyetjet më të rëndësishme rreth procesit zgjedhor. Sidoqoftë VASh-ët duhet të shtien në punë gjykimin e tyre e të vlerësojnë në qoftë se ka çështje ose procedura që nuk përmenden në formularë por që përbëjnë shqetësim, gjë që duhet ta

shenojnë në seksionin e komenteve të formularit të tyre. Çështjet dhe procedurat që duhen vëzhguar përfshijnë si më poshtë:

- A ka shenja çorganizimi, siç janë radhë jashtëzakonisht të gjata njerëzish në mënyrë të pazakontë, ose vonesa të tepëruara?
- A ka shenja materialesh propagandistike në favor të ndonjë partie, ose veprimtarie fushatore brenda qendrës së votimit?
- A vërehen përpjekje që u kërkojnë njerëzve të votojnë në një mënyrë të caktuar, ose ushtrim trusnie kundrejt votuesve? A ka shenja frike e kërcënimi?
- A ka policë, forca të sigurisë ose zyrtarë të qeverisë në brendësi të qendrave të votimit?
- A ka persona të pranishëm në qendrën e votimit që duket se nuk kanë ndonjë funksion zyrtar?
- A ka persona të tjerë, përveç komisionerëve, që merren me administrimin e procesit të votimit ose që u japin udhëzime komisionerëve?
- Si identifikohen votuesit dhe a paraqesin ata gjithmonë dokumentat e duhura?
- Si procedohet me votuesit, p.sh., a ju vihet kryq emrave të tyre në listë, duke nënshkruar në listë apo duke u vulosur dokumentin e identitetit? A përdoret boja e pashlyeshme?
- Në qoftë se votuesit firmosin në listën e votuesve, a vihen re firma të ngjashme me të tjeret?
- A kthehen votuesit nga qendra e votimit ngaqë emrat e tyre nuk gjenden në listën e votuesve?
- A gjendet në fletën e votimit një vulë zyrtare e posaçme për atë qendër votimi dhe/ose firma e komisionerit/ëve të qendrës së votimit?
- A u jepen votuesve më shumë fletë votimit se ç'duhet dhe, a ka tregues të votimit në grup?
- A ka dëshmi të tejmbushjes së kutisë së votimit?
- A duket se votuesit e kuptojnë procesin e votimit, apo ka një numër të madh votuesish që kanë nevojë për ndihmë? A janë të thjeshta për t'u përdorur fletët e votimit?
- A ka të ngjarë që organizimi i objekteve në brendësi të qendrës së votimit të zbulojë fshehtësinë e votës së një personi?
- A ka votues që lejohen të hyjnë në kabinën e votimit tok me të tjerë?
- A ka votues që nuk hyjnë në kabinën e votimit?
- A janë mjediset të përshtatshme për personat e paaftë fizikisht në mënyrë që ata t'i përdorin ato vetë?
- A u ofrohet ndihma e duhur personave që kanë nevojë për ndihmë?
- A janë vendosur kutitë e votimit në vend të dukshëm për të gjithë komisionerët dhe vëzhguesit?
- A janë vulosur siç duhet kutitë e votimit?
- A ndiqen në mënyrën e duhur dhe në mënyrë eficiente procedurat e votimit?

#### **D. Kontakte të tjera në qendrat e votimit**

Në vijim të diskutimeve me komisionerët e qendrave të votimit dhe vëzhguesit e pavarur, VASh-ët duhet të përpiqen të flasin edhe me vëzhguesit vendas. Këtu mund të hyjnë vëzhguesit e caktuar prej partive, përfaqësuesit e kandidatëve dhe vëzhguesit jo partiakë të shoqërisë civile. Vëzhguesit vendas, si ata partiakë ashtu edhe ata jo partiakë, duhet të lejo-

hen të hyjnë në qendrat e votimit, në përputhje me parimet e parashtruar në Dokumentin e Kopenhagenit të vitit 1990.

VASh-ët duhet të mbajnë shënim nëse vëzhguesit vendas janë të pranishëm në qendrat e votimit dhe nëse ata janë kufizuar ose janë penguar në mënyra të ndryshme për të kryer detyrat e tyre të vëzhgimit. VASh-ët duhet të flasin me një grup të madh njerëzish nga të gjitha kategoritë e vëzhguesve vendas kudo që është e mundur. Komentet e tyre mund të japin informacion shtesë lidhur me mjedisin e votimit në qendrën e votimit si dhe lidhur me sjelljen e komisionerëve.

Ndërkohë që vëzhguesit ndërkombëtarë mund të përfitojnë shumë nga këqyrjet e brendshme të rrjeteve të vëzhguesve vendas, është e rëndësishme të theksojmë se misionet e vëzhgimit zgjedhor të ODIHR-it janë krejtësisht të veçuar nga vëzhguesit vendas. VASh-ët gjatë bisedave të tyre, duhet tua bëjnë të qartë të gjithëve se nuk kanë kurrfarë të drejte për të ndrequr parregullsi ose shkelje të vërejtura, por vetëm për t'i raportuar ankesat në zyrat e tyre qendrore. VASh-ët duhet t'i informojnë të gjithë ata që kanë qenë dëshmitarë të shkeljeve ose të parregullsive se është e drejta e tyre t'i paraqesin ankesat e t'i ndjekin ato sipas procedurave zyrtare në vend.

VASh-ët duhet të përpiqen të hyjnë në bisedë me votues në mënyrë që të shohin deri në ç'shikallë është kuptuar procesi dhe sa besohet në të. Për shembull, kur procedurat e votimit mund t'u duken VASh-ëve se kompromentojnë fshehtësinë e votimit, mund t'i pyesin votuesit nëse besojnë se votat e tyre janë të fshehta? A kanë qenë votuesit të mirinformuar lidhur me zgjedhjen e bërë dhe të familjarizuar me procedurat e votimit? Në qoftë se do të kishte disa fletë votimi ose procedura të reja zgjedhore, a është kjo gjë pështjelluese për votuesit? Në qoftë se një votues është larguar nga qendra e votimit, a është bërë kjo gjë për ndonjë arsye të vlefshme? Sidoqoftë, VASh-ët nuk duhet kurrsesi t'i pyesin votuesit se për kë kanë votuar, po kështu ata nuk duhet t'u drejtojnë pyetje votuesve brenda qendrave të votimit, madje as atëherë kur njerëzit janë duke shkuar drejt qendrave të votimit për të votuar, gjë që mund të keqinterpretohet.

Gjatë gjithë bisedave, vëzhguesit duhet të kenë kurdoherë parasysh se ka njerëz që mund të përpiqen të manipulojnë informacionin e shkëmbyer me VASh-ët për qëllimet dhe interesat e tyre. Prandaj, VASh-ët duhet të përdorin gjykimin e tyre kur vlerësojnë vlefshmërinë e informacionit të përfituar. Kur raportojnë, duhet të jenë në gjendje të bëjnë një dallim të qartë midis informacionit të bazuar mbi vëzhgimet e tyre dhe informacionit të vjelë nga raportimet e të tjerëve. Në qoftë se VASh-ët raportojnë informacion të siguar nga të tjerët, ata duhet të përpiqen të shpjegojnë se deri në ç'shikallë e konsiderojnë informacionin të saktë.

#### **E. Procedurat e posaçme të votimit**

Në shumë vende ka klauzola për procedura të posaçme votimi që synojnë të lehtësojnë votimin ose ta bëjnë votimin të vlefshëm edhe për ata qytetarë, të cilët, për arsye nga më të ndryshmet mund të mos jenë në gjendje të paraqiten në qendrat e votimit. Procedurat e posaçme të votimit mund të përfshijnë përdorimin e kutive të lëvizshme të votimit të paracaktuara për të sëmurët dhe të moshuarit, votimet në spitale dhe burgje, votimet e parakohshme, votimin nëpërmjet postës, votimin në ambasada si dhe klauzolat e posaçme për votimin e ushtarakëve.

Votimi i posaçëm ka avantazhin e shtrirjes të së drejtës së votës edhe tek ata votues të cilët përndryshe nuk do të qenë në gjendje të votonin. E megjithatë, procedurat e posaçme të votimit mund të jenë shumë herë më të vështira për të siguruar një votim të sigurtë, pa marrë masa të caktuara mbrojtëse, ndaj dhe për rrjedhojë janë të hapura për abuzime të mundshme. Nga ana tjetër, edhe sigurimi i fshehtësisë së votës mund të jetë gjithashtu më problematik. Prandaj dhe një vlerësim i avantazheve të klauzoleve të votimit të posaçëm duhet peshuar përkundrejt aftësisë për t'i organizuar ashtu si duhet, në mënyrë të sigurtë dhe transparente, si dhe për të mos ulur shkallën e besimit në krejt procesin zgjedhor.

VASH-ët mund të udhëzohen të vëzhgojnë disa forma të votimit të posaçëm si pjesë e detyrave të tyre. Në këtë rast, ata duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë se deri në ç'shikallë ky votim ka qenë mjaftueshëm i rregullt, i sigurtë dhe transparent. Fjala vjen, në qoftë se listat shtesë të votuesve janë përdorur për të sëmuret dhe të moshuarit që do të votojnë në shtëpi, a është jashtëzakonisht i lartë numri i personave të përfshirë në këto lista? A kanë pasur material të bollshëm zgjedhor gjatë fushatës ushtarët, të burgosurit, pacientët e spitaleve apo të tjerë, që përdorin procedurat e posaçme të votimit, në mënyrë që të bëjnë zgjedhje të mirinformuara?

**VOTIMI TEK USHTARAKËT:** Ndërkohë që avantazhet e votimit të ushtarakëve sëbashku me popullsinë civile, si lidhur me besimin, ashtu dhe për transparencën, janë krejt të qarta, në disa vende edhe sot e kësaj dite kërkohet që ushtarakët të votojnë në kazermat ose bazat e tyre ushtarake. Në të këtylla rrethana, procesi i votimit tek ushtarakët duhet vëzhguar nga një pjesë e VASH-ëve, duke qenë se, sidomos, ushtarët mund të jenë të brishtë përkundrejt presioneve. Për shembull, trupat mund të urdhërohen të votojnë në sy të oficerëve dhe, në disa raste, mund të ndodhë që oficerët t'i udhëzojnë trupat e tyre se si të votojnë.

**SPITALET DHE BURGJET:** Kur mjediset e posaçme të votimit vendosen në spitale, burgje ose vende të tjera të vuajtjes së dënimit, disa prej vëzhguesve duhet të caktohen t'i vizitojnë këto qendra votimi të veçanta. Në një sërë vendesh, të dënuarit janë të përjashtuar nga votimet, por persona të ndaluar që nuk janë dënuar ende ruajnë të drejtën për të votuar. Si pacientët në spitale, ashtu edhe të burgosurit, përbëjnë gjithashtu një segment të elektoratit që mund të jetë veçanërisht i brishtë përkundrejt trusnive.

**KUTITË E LËVIZSHME TË VOTIMIT:** Në shumë vende sigurohen kuti të lëvizshme votimi me kërkesë të atyre votuesve që janë të moshuar, të sëmuret, ose të pamundur për të shkuar në një qendër votimi. Zakonisht kutitë e lëvizshme shoqërohen nga dy komisionerë, të cilët, në rastin më të mirë, përfaqësojnë interesa të ndryshme politike, atje ku kjo gjë është e mundur. Kontrolli i të gjitha kutive të lëvizshme të votimit nëpër qendra e votimit është diçka e pamundur. Votuesi që janë të detyruar të përdorin një kuti të lëvizshme votimi ka të ngjarë që të mos kenë intimitetin e duhur që të ofron një kabinë votimi. Disa prej VASH-ëve duhet të bëjnë çmos të ndjekin komisionerët me kutitë e lëvizshme të votimit në mënyrë që të jenë në gjendje të bëjnë një vlerësim të këtij procesi.

**VOTIMI HERËT DHE VOTIMI POSTAR:** Në përgjithësi, VASH-ët nuk janë kurdoherë në gjendje të monitorojnë votimin që nis herët ose votimin postar, të paktën atje ku kjo gjë lejohet. Gjithsesi është me dobi që vëzhguesit të saktësojnë se sa herët nis votimi dhe sa kuti postare janë siguruar para ditës së zgjedhjeve, në mënyrë që të jenë të pranishëm në hapjen dhe numëri-

min e këtyre kutive të votimit, si dhe të formojnë një përshtypje të përgjithshme të ecurisë së këtij procesi. Në rastin e votimit të hershëm, për vëzhguesit është gjithashtu e rëndësishme të saktësojnë se si është regjistruar dhe numëruar në protokollin e rezultateve të qendrës së votimit numri i votuesve të hershëm.

**VOTIMI JASHTË VENDIT:** Ka një sërë vendesh që u njohin të drejtën shtetasve të tyre të votojnë nëpër ambasada ose qendra votimi të krijuara enkas jashtë vendit. Përgjithësisht, vetëm një pjesë e vogël e popullsisë voton në këtë mënyrë. Por vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, fjala vjen, në rastet kur bëhet fjalë për një numër të madh personash të zhvendosur, merren masa të posaçme që një numër VASh-ësh ta vëzhgojnë nga afër këtë proces.

### 8.3 Kontaktet me median

Ditën e zgjedhjeve, përfaqësuesit e medias shpesh u kërkojnë vëzhguesve komente lidhur me procesin zgjedhor. Kodi i Sjelljes së Vëzhguesit ua ndalon vëzhguesve që të bëjnë komente personale në media rreth vëzhgimeve që kanë kryer. Vëzhguesve u ndalohet rreptësisht të flasin para medias rreth substancës së vëzhgimeve të kryera dhe përfundimeve të arritura. Në ato raste kur vëzhguesit vihen të diskutojnë në media rreth thelbit të përfundimeve të arritura gjatë vëzhgimit, atëherë do të vihet në dijeni vendi përkatës, ndërsa kartat e akreditimit mundet që menjëherë të tërhiqen.

E megjithatë, në qoftë se ndonjë vëzhgues bëhet objekt i ndonjë kërkimi të pazakontë të medias, ai ose ajo mund të japë një informacion të përgjithshëm me karakter njohës rreth rolit të tij ose të saj si vëzhgues i OSBE-së, por nuk duhet që të diskutojë me ta rreth çështjesh thelbësore ose përfundimeve të arritura. Nga ana tjetër, vëzhguesit duhet të përmbahen e të mos bëjnë krahasime të zgjedhjeve me zgjedhje të mëparshme në atë vend ose në ndonjë vend tjetër. Komentet e tyre të përgjithshme në media mund të përfshijnë si më poshtë:

- Se do të që pa vend të bënin komente rreth përshtypjeve të krijuara ose përfundimeve të arritura, mbasi kanë qenë dëshmitarë vetëm të një pjese të vogël të kuadrit të përgjithshëm votues mbarëkombëtar; se raportet e tyre do të përpunohen me një numër të madh raportesh të tjerë dhe vetëm kështu MVZ-të mund të nxjerrin përfundime të përgjithshme të bazuara në një numër të madh raportesh të hartuara nga vëzhguesit;
- Se të gjithë vendet e OSBE-së janë të angazhuara të ftojnë vëzhgues, duke patur parasysh faktit se vëzhgimi përmirëson transparencën dhe mund të përforcojë besimin e publikut te procesi zgjedhor;
- Numrin e përgjithshëm të VASh-ëve të ODIHR-it që janë duke vëzhguar si dhe numri i vendeve të ndryshme prej nga ata vijin (ky informacion zakonisht jepet ditën e udhëzimeve për VASh-ët);
- Sa qendra votimi mendojnë të vizitojnë;
- Se një ditë pas zgjedhjeve në kryeqytet do të mbahet një konferencë shtypi për t'i bërë me dije opinionit publik përfundimet paraprake të MVZ-së dhe se të gjithë përfaqësuesit e medias janë të mirëpritur në atë takim.

Në qoftë se ndonjë nga përfaqësuesit e medias këmbëngul në kërkesat e veta për të marrë informacion ose komente që shkojnë përtej pikave të përmendura në listën e mësipërme, atëherë kjo gjë duhet t'i referohet Kryetarit të Misionit. Sipas udhëzuesit të ODIHR-it, vetëm

kryetari i Misionit ose zyrtarë përgjegjës të ODHR-it mund të bëjnë komente të rendësishme me gazetarët. Në ato raste kur vëzhguesit bëjnë komente të përgjithshme në media, ata duhet të regjistrojnë emrin e intervistuesit/intervistueses si dhe organin ose organet që përfaqësonin.

### Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:

- Ushtrim dhune ose trazira;
- Frikësim i votuesve;
- Konfuzion ose çorganizim në qendrat e votimit;
- Prani e personave të paautorizuar në qendrat e votimit;
- Policë të veshur me uniformë ose zyrtarë lokalë brenda vendit ku votohet në qendrat e votimit ose pranë tyre;
- Veprimtari të tjera të papërshtatshme nga policia dhe/ose forcat e sigurisë, siç janë mbajtja shënim dhe raportimi lidhur me përqindjet e votuesve ose rezultatet me telefon;
- Vazhdimi i fushatës edhe gjatë periudhës së ndërprerjes së saj;
- Materiale propagandistike të fushatës në qendrën e votimit;
- Hapje me vonesë e qendrave të votimit;
- Mosndjekja nga komisionerët e procedurave të kërkuara;
- Kufizimi i së drejtës së personave me të drejtë vote të hedhin votën e tyre;
- Mosverifikimi i identitetit të votuesve;
- Mossigurimi i së drejtës për votim të fshehtë për shkak të kabinave të papërshtatshme, ekraneve ose mjeteve të ndriçimit;
- Pasaktësi në listat e votuesve;
- Votim në grup (familjar);
- Votim me ndërmjetës (me përjashtim të rasteve kur kjo gjë përcaktohet me ligj);
- Votim më shumë se një herë;
- Tejmushje e kutive të votimit;
- Kabina të votimit të pambyllura;
- Kuti votimi të pavulosura;
- Prani fletësh votimi të shenjuara paraprakisht;
- Përdorim i parregulluar i kutive të lëvizshme të votimit;
- Mungesë materialesh votimi të domosdoshme;
- Vonesa të papërligjura në administrimin e procesit të votimit;
- Veprimtari të papërshtatshme nga ana e partive politike ose përfaqësuesve të kandidatëve; dhe
- Ndërhyrje në punën e komisionerëve ose të vëzhguesve.



# 9.

## Vëzhgimi i numërimit të votave



Numërimi i votës është një fazë e rëndësishme gjatë procesit zgjedhor, ndaj dhe duhet ndjekur nga afër e vëzhguar tërësisht. Ndërkohë që votimi i afrohet fundit, dhe nis numërimi, të gjithë VASH-ëve iu kërkohet të vëzhgojnë procesin e numërimit. Normalisht numërimi i votave ndodh në nivelin e qendrës së votimit,<sup>17</sup> ndaj dhe VASH-ët duhet të përzgjedhin një nga qendrat e votimit për të vëzhguar procedurat e mbylljes e të qëndrojnë aty deri në fund të numërimit të votave. VASH-ët janë pajisur me formularë të posaçëm të cilët duhet t'i plotësojnë, dhe që përmbajnë një sërë pyetjesh konkrete rreth procedurës së mbylljes së qendrave të votimit dhe procedurave të numërimit.

Vëzhgimi i numërimit krijon një mundësi për të parë nëse fletët e votimit janë numëruar si duhet, duke pasqyruar edhe zgjedhjet e bëra nga vetë zgjedhësit. Përvoja ka dëshmuar se mashtrimi zgjedhor ka më shumë gjasë të ndodhë gjatë numërimit të votave ose tabelëzimit të rezultateve sesa gjatë kohës së votimit. Prandaj dhe VASH-ëve iu del për detyrë të jenë veçanërisht vigjilentë gjatë numërimit të votave dhe tabelëzimit të rezultateve.

Përgjithësisht ekziston një procedurë standarde e hollësishme për mbylljen e një qendre votimi dhe numërimin e fletëve. Procesi i votimit zakonisht nis me vulosjen e kutisë së votimit sapo të ketë përfunduar votimi; kutia duhet të mbetet e vulosur ndërkohë që komisionerët plotësojnë formularët e numërimit të të gjitha fletëve të votimit si dhe materialeve të tjera të procesit të votimit, dhe verifikojnë që numri i fletëve që u është shpërndarë votuesve përkon me numrin e votuesve të regjistruar që kanë votuar. Ky material duhet të vuloset veçan. Shpesh fletët e votimit të papërdorura zhvlerësohen para hapjes së kutive të votimit. Paskëtaj kutitë e votimit hapen dhe fletët numërohen sipas procedurës së përcaktuar.

Sikur në të njëjtën qendër votimi të ketë edhe një kuti votimi të lëvizshme, numërimi i votave duhet të fillojë vetëm mbasi të jetë përcaktuar veçanërisht numri i fletëve në kutinë e lëvizshme si dhe numri i tyre në kutinë e palëvizshme. Mbasi të jetë kryer kjo përllogaritje, fletët e kutisë

<sup>17</sup> Në pjesën më të madhe të vendeve, numërimi i votave zhvillohet në qendra votimi të veçanta. Kur fletët e votimit nuk numërohen në qendrat e votimit por transportohen në një vend numërimi qendror, kjo gjë shkakton probleme shtesë si për transparencën ashtu edhe për verifikimin. Një ekip vëzhguesish duhet të shoqërojë transportin e kutive të votimit në qendrën e votimit si dhe të vlerësojë procedurat për sigurinë e kutive dhe parandalimin e mashtrimeve gjatë kohës së zhvendosjes së kutive të votimit.

së lëvizshme duhet të përzihen me fletët e tjera dhe vetëm paskëtaj mund të fillojë numërimi i votave. Këto masa paraprake janë të nevojshme me qëllim që të parandalohet dhunimi i fshehtësisë së votës në kutinë e lëvizshme.

Rezultatet e votimit duhet të bëhen të njohura për publikun në nivelin e qendrës së votimit. Është një praktikë e mirë të vihen rezultatet jashtë çdo qendre votimi. Transparenca dhe ndershmëria e procesit përforcohen kur të gjitha partive dhe përfaqësuesve të kandidatëve ju jepen kopje zyrtare të rezultatit, ose të protokollit të mbajtur pranë çdo qendre votimi dhe kur kanë mundësin ta firmosin atë ose të regjistrojnë ankesat, në rast se ka. Vëzhguesit e brendshëm jo partiakë dhe vëzhguesit ndërkombëtarë duhet të kenë gjithashtu mundësi të marrin një kopje të rezultatit pranë qendrës së votimit. Në rast se sigurohet protokoll zyrtar, ose kopja e fletës së rezultateve, ato duhet t'i dërgohen menjëherë ekipit bërthamë, së bashku me formularët e plotësuar të numërimit. Në ato raste kur nuk është e mundur të sigurohet protokoll zyrtar ose një kopje e rezultateve të qendrës së votimit, VASh-ët duhet të regjistrojnë me kujdes rezultatet e plota të nxjerra nga qendra e votimit ku kanë vëzhguar procesin e numërimit.

## 9.1 Çështje që kanë të bëjnë me numërimin e votave

VASh-ët duhet të vëzhgojnë se si janë zbatuar procedurat e mëposhtme. Pyetjet që kanë lidhje me këto çështje ka të ngjarë të shfaqen në formularët që u kërkohet VASh-ëve të plotësojnë.

- A është kryer numërimi nga komisionerët e qendrës së votimit, apo nga persona të tjerë të përfshirë në këtë proces?
- A i kuptojnë procedurat dhe a iu përmbahen kërkesave të tyre komisionerët?
- A janë duke u numëruar fletët në mënyrën e duhur dhe të sigurtë?
- A është duke u kryer numërimi në një mjedis transparent me masa të përshtatshme për vëzhguesit vendas?
- A korrespondon numri i votuesve të rregjistruar që kanë votuar me numrin e fletëve të votimit të hedhura në kuti?
- Fletët e votimit të papërdorura, a janë siguruar, anuluar, ose shkatërruar mbasi janë numëruar?
- A janë identifikuar siç duhet në mënyrë të njëjtë fletët e pavlefshme? A janë hequr mënjanë sic duhet fletët e pavlefshme të votimit dhe ruajtur për shqyrtim?
- A përmbajnë ndonjë shenjë të pazakontë fletët e votimit me qëllim dhunimin e fshehtësisë së votës?
- A ngjan në mënyrë të panatyrshme i lartë numri i fletëve të pavlefshme?
- A i përmbahet votimi parimit se fleta gjykohet e vlefshme në qoftë se vullneti i votuesit është shprehur në mënyrë të qartë?
- A janë ndarë në mënyrë korrekte dhe numëruar një nga një fletët e votimit për çdo kandidat dhe parti?
- A janë zgjidhur në mënyrë të kënaqshme debatet ose ankesat?
- A janë plotësuar në mënyrë korrekte regjistrat zyrtarë të numërimit në fund të procesit të numërimit dhe firmosur nga të gjithë personat e autorizuar?

- A kanë mundur vëzhguesit vendas dhe këqyrësit e votimit të marrin kopje zyrtare të protokollit nga qendrat e votimit?
- A janë afishuar rezultatet për publikun pranë qendrës së votimit?
- A ka pasur aktivitete të papërshtatshme nga policia dhe/ose forcat e sigurisë, siç janë mbajtja shënim dhe raportimi i rezultateve me telefon?
- A kanë rënë dakord komisionerët e qendrës së votimit për procedurat e votimit dhe rezultatet e dala prej tyre dhe, në rast se jo, si kanë vepruar?

## 9.2 Tabelëzimi

Dhe së fundi duhet bërë vlerësimi nëse rezultatet janë tabelëzuar si duhet. Mbasi numërohen fletët, rezultatet e numërimit të qendrës së votimit zakonisht i transmetohen komisionit zgjedhor zonal, ku rezultatet zonale tabelëzohen dhe përcillen te niveli kombëtar. Procesi i tabelëzimit është një tjetër hap i rëndësishëm në procesin zgjedhor që duhet vëzhguar. Shpesh VASh-ëve iu kërkohet të shoqërojnë rezultatet zyrtare dhe materialet e tjera zgjedhore ndërkohë që transportohen nga qendra e votimit në qendrën e tabelëzimit dhe paskëtaj të vëzhgojnë nëse rezultatet e dala nga qendra e tyre e votimit janë hedhur me saktësi në tabelë. Nga ana tjetër, VASh-ët duhet të vlerësojnë nëse kutitë e votimit dhe materialet e tjera të procesit zgjedhor janë transportuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, të sigurtë dhe transparente (domethënë, a janë lejuar VASh-ët dhe vëzhguesit e tjerë t'i shoqërojnë rezultatet gjatë transportit?).

Në raste të tjera, skuadra të posaçme VASh-ësh mund të caktohen të vëzhgojnë procedurat e tabelëzimit pranë qendrave të caktuara. Qëllimi është që vëzhguesit të monitorojnë çdo nivel të procesit të tabelëzimit si dhe të jenë në gjendje të ndjekin rezultatet e çdo qendre votimi deri në nivel kombëtar për të verifikuar në vend se procesi i tabelëzimit ka qenë administruar ashtu si duhet. MVZ-ja mund ta organizojë punën me turne ose të dërgojë skuadra të posaçme për t'u siguruar që është realizuar ky synim. Në qoftë se VASh-ët caktohen në përbërje të skuadrave të posaçme për të vëzhguar tabelëzimin e rezultateve, në këtë rast, do t'u jepen udhëzime konkrete se si e qysh ta kryejnë vëzhgimin.

Në disa raste, autoritetet zgjedhore mund të përdorin kompjutera në rrjet për të transmetuar rezultatet paraprake. Me qëllim që të sigurohet transparencë në ushtrimin e tabelëzimit, vëzhguesit duhet të njihen me procedurat teknike që duhen ndjekur. Në qoftë se misioni i vëzhgimit zgjedhor ka ekspertizën e duhur, mund të kërkojë të përdorë programe kompjuterike për të vlerësuar se si është kryer puna. Veç kësaj, në të tilla raste, vëzhguesit mund të monitorojnë procesin dhe, në rast se është e mundur, duhet të marrin kopje të materialit të shtypur, të nënshkruar, e të vulosur nga autoriteti përkatës, ndërkohë që niset informacioni.

Tabelëzimi i rezultatit duhet të jetë i verifikueshëm dhe transparent në të gjithë nivelet e administratës zgjedhore. Për të qenë transparent dhe për të nxitur besimin te procesi zgjedhor, rezultatet për të gjithë nivelet e tabelëzimit duhet të bëhen menjëherë publike, në të gjitha fazat e procesit të tabelëzimit. Rezultatet e qendrave të veçanta të votimit përbëjnë një kampion rezultatesh të verifikuara, të cilat mund të kontrollohen përkundrejt rezultateve në nivel rrethi ose rajoni dhe, më pas, të kontrollohen një nga një përkundër rezultatit të përgjithshëm të publikuar. Normalisht kjo detyrë kryhet nga ekipi bërthamë.

### Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:

- Kuti votimi të tejmbushura;
- Ndërrimi i kutive të votimit;
- Shtimi i numrit të fletëve të shenjuara pas hapjes së kutisë;
- Procedura të parregullta numërimi;
- Përfshirja në numërim e personave të pa autorizuar, siç mund të jenë zyrtarë të puhstetit lokal, persona të sigurisë me uniformë ose të veshur civil, si dhe persona të tjerë të paidentifikuar;
- Numër jo i duhur i stafit dhe i mbikqyrësve;
- Nxjerrja jashtë nga qendrat e komisionerëve ose vëzhguesve;
- Zhvleftësim arbitrar ose i parregullt i fletëve të votimit;
- Humbje e fletëve të votimit ose kutive të votimit;
- Numërim dhe raportim i pandershëm i fletëve të votimit;
- Depozitim i pasigurtë i fletëve të papërdorura;
- Protokollit i rezultateve të qendrës së votimit i papërfunduar në qendrën e votimit;
- Protokollit i rezultateve të qendrës së votimit i plotësuar me laps në vend që të bëhej me penë me bojë;
- Mosafishimi i rezultateve zyrtare në qendrën e votimit;
- Refuzimi për t'i pajisur me kopje të rezultatit zyrtar përfaqësuesit e kandidatëve ose vëzhguesit;
- Transport i pasigurtë i materialeve zgjedhore pranë qendrave të tabelëzimit;
- Falsifikimi ose ndryshimi i protokollit të rezultateve; dhe
- Mungesë transparence ose procedura të parregullta në qendrat e tabelëzimit.

# 10.

## Raportimi, informimet, deklaratat



### 10.1 Raportimi i VASH-ëve

VASH-ët raportojnë gjatë gjithë ditës dhe natës së zgjedhjeve, duke plotësuar formularët në të gjitha qendrat e votimit. Formularët duhet të kthehen në pikat e caktuara të mbledhjes gjatë ditës së zgjedhjeve ose të nisen me faks në zyrat qendrore të MVZ-së, në varësi të udhëzimeve të dhëna nga ekipi bërthamë. Është e rëndësishme që VASH-ët t'i përmbahen programit të përcaktuar që më parë, me qëllim që raportet e tyre të përpunohen në kohë dhe vlerësimet e tyre të përfshihen në deklaratën e misionit të vëzhgimit lidhur me përfundimet dhe gjetjet paraprake.

Përveç formularëve, VASH-ët duhet t'u raportojnë menjëherë VAGJ-ëve të tyre për çdo problem të rëndësishëm ose parregullsi serioze që mund të ndodhë gjatë ditës së zgjedhjeve, siç janë rastet e ushtrimit të dhunës, mbushjet e kutive të votimit ose mashtrime të tjera elektorale, por edhe rastet e mospranimit të vëzhguesve në qendrat e votimit. Në të gjitha këto raste, VAGJ-ët duhet t'ia përcjellin menjëherë informacionin ekipit bërthamë në qendër. Gjatë zhvillimit të disa zgjedhjeve, VASH-ëve iu është kërkuar të takohen personalisht me VAGJ-ët në orë të caktuara të ditës.

Zakonisht VASH-ëve iu kërkohet të marrin pjesë në mbledhjet e shkëmbimit të informacioneve dhe mendimeve pas procesit zgjedhor. Normalisht këto mbledhje organizohen mbi baza rajonale nga çdo ekip VAGJ-ësh. Për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion për të mbledhur informacionin e nevojshëm për deklaratën publike, këto mbledhje ka fort të ngjarë të organizohen herët në mëngjes, një ditë mbas zgjedhjeve. Edhe pse VASH-ëve do t'u jetë dashur të qëndrojnë zgjuar deri në orët e vona të natës duke ndjekur procesin e numërimit e të tabelëzimit, mbledhjet e sipërpërmendura janë një rast i volitshëm për të gjithë vëzhguesit për të shkëmbyer e krahasuar me kolegët përfundimet e arritura gjatë procesit të zgjedhjeve. Përfundimet e arritura do të shërbejnë për nxjerrjen e konkluzioneve nga misioni vëzhgues se si janë zhvilluar zgjedhjet duke pasur parasysh angazhimet e OSBE-së. Këto mbledhje janë të mbyllura për shtypin dhe publikun e gjerë.

## 10.2 Aktivitetet e ekipit bërthamë

Ekipi bërthamë duhet të jetë i organizuar më së miri për të mbështetur vëzhguesit, si dhe për të marrë e përpunuar raportet e VASH-ëve gjatë ditës së zgjedhjeve dhe natën mbasi janë mbyllur kutitë. Për këtë qëllim, përgatitet një plan pune në mënyrë që gjatë gjithë ditës dhe natës në vazhdim të ketë staf të mjaftueshëm në krye të detyrës. Për këtë gjë duhet të mba-hen parasysht pikat e mëposhtme:

- Njësia e statistikave duhet të ketë staf të mjaftueshëm si dhe pajisjet e nevojshme që të përpunojë të gjithë formularët e VASH-ëve në kohën e duhur (një raport statistikor paraprak duhet të përgatitet qysh herët në mëngjes një ditë fill pas zgjedhjeve);
- Një numër anëtarësh të ekipit bërthamë janë caktuar të lexojnë të gjitha komentet e bëra në formularët e VASH-ëve dhe në bazë të tyre të hartojnë një përmbledhje të prirjeve të vërejtura gjatë zgjedhjeve dhe t'i nxjerrin në pah herët në mëngjes, një ditë fill pas zgjedhjeve;
- Koordinatori i VAGj-ëve ose një tjetër anëtar i ekipit bërthamë i caktuar si ndërlidhës me VAGj-ët duhet të qëndrojë në krye të detyrës gjatë gjithë kohës, ditën e zgjedhjeve dhe natën që e pason. Koordinatori i VAGj-ëve duhet të përgatisë një raport të shkurtër përmbledhës mëngjesin e hershëm të ditës pas zgjedhjeve, ku të përvijohen prirjet kyç të vërejtura gjatë procesit, si dhe të gjithë problemet e raportuar nga VAGj-ët;
- Ekipi i monitorimit të medias duhet të jetë i pajisur me staf gjatë gjithë kohës së zhvillimit të zgjedhjeve, ditën e natën, për të siguruar që misioni i vëzhgimit të jetë i vetëdijshëm për çdo zhvillim të rëndësishëm ose prirje të raportuar nga media. Ekipi i monitorimit të medias duhet të jetë i përgatitur t'i raportojë të gjitha përfundimet mëngjesin e së nesërme së zgjedhjeve;
- Analistit të zgjedhjeve do t'i duhet të kalojë natën duke ndjekur punën e komisionit qendror të zgjedhjeve dhe herët në mëngjes, një ditë pas zhvillimit të zgjedhjeve, duhet të raportojë të gjitha zhvillimet;
- Një operator telefoni dhe receptionist duhet të jenë në krye të detyrës në zyrat e misionit gjatë gjithë kohës, si dhe duhet të udhëzohen se si të veprojnë me informacionet, ankesat dhe kërkesat e ardhura në mision rreth procesit zgjedhor;
- Regjistri me ankesat që i janë raportuar MVZ-së duhet të mbahet nga ana e një punonjësi të ngarkuar me këtë detyrë qysh nga çasti i hapjes së qendrave të votimit deri kur të dalë deklarata paraprake;
- Një makinë, shofer dhe përkthyes duhet të jenë në gjendje gatishmërie gjatë gjithë kohës për të shoqëruar pjesëtarët e stafit të ekipit bërthamë në rast të shfaqjes së emergjencave; dhe
- Misioni duhet të marrë parasysht mbajtjen e disa skuadrave rezervë vëzhguesish gjatë ditës së zgjedhjes dhe natës që pason për t'iu përgjigjur menjëherë problemeve ose parregullsive të raportuara. Në këto ekipe vëzhguesish rezervë mund të përfshihen anëtarë të ekipit bërthamë që nuk janë të ngarkuar me detyra të tjera, të mbështetur nga shoferë dhe përkthyes.

## 10.3 Deklarata e përfundimeve dhe gjetjeve paraprake

Misioni i vëzhgimit zgjedhor zakonisht nxjerr një deklaratë lidhur me përfundimet dhe konkluzionet e arritura në një konferencë shtypi që mbahet pasditën e një dite pas zgjedhjeve.

Deklarata mbështetet në të gjithë punën e kryer nga MVZ-ja, duke përfshirë këtu si vëzhguesit afatgjatë dhe analistët, ashtu edhe raportet e përgatitura nga VASh-ët; kjo gjë pasqyron faktin se zgjedhjet janë një proces dhe jo ngjarje një ditore.

Deklarata është një përmbledhje e përfundimeve të rëndësishme dhe konkluzioneve për kuadrin ligjor, administratën zgjedhore, fushatën, dhe median, si dhe për proceset e votimit e të numërimit të votave gjatë ditës së zgjedhjeve. Deklarata përbën një vlerësim paraprak të shkallës së respektimit të angazhimeve të OSBE-së dhe parimeve universale, si edhe të zbatimit të ligjit të vendit për zgjedhjet dhe rregullave të procesit zgjedhor.

Deklarata quhet paraprake mbasi është nxjerrë para se të përfundojë krejt procesi zgjedhor. Në disa raste, numërimi i votave dhe tabelëzimi mund të mos ketë përfunduar në kohën që del deklarata paraprake. Por pothuaj në të gjithë rastet deklarata ka dalë para se rezultatet e zgjedhjeve të jenë bërë përfundimtare e zyrtare, dhe para se të jenë zgjidhur ankesat dhe ankimimet për ditën e zgjedhjeve. Me raste, ODIHR-it mund t'i duhet të nxjerrë edhe një deklaratë pasuese fill pas asaj paraprake për të trajtuar zhvillimet paszgjedhore para daljes së raportit përfundimtar.

Normalisht rekomandimet rezervohen për t'u futur në raportin përfundimtar të ODIHR-it. Gjithsesi, në rast të një raundi të dytë votimesh ose rrethanash të tjera të veçanta, rekomandimet e bëra në deklaratën paraprake mund të ndihmojnë për përmirësimin e cilësisë për pjesën e mbetur të procesit.





# 11.

## Vëzhgimi paszgjedor



Siç është përmendur edhe më parë, ODIHR ka mandat për të vëzhguar para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve, si konfirmim i faktit se zgjedhjet nuk janë ngjarje një ditore, por një proces i tërë. Në varësi të rrethanave të veçanta, pjesa më e madhe e procedurave zgjedhore në fakt mund të përfundojnë një ditë pas zhvillimit të zgjedhjeve, edhe pse mund të ketë një sërë çështjesh të mbetura për t'u zgjidhur. Vendimi se si do të vazhdohet me vëzhgimin e zhvillimeve paszgjedorë do të varet në një shkallë të madhe nga situata dhe kushtet konkrete.

Një pjesë e mirë e vendeve kanë një proces zgjedhor dy fazor, sipas të cilit, një raund i dytë votimesh ka të ngjarë të zhvillohet një ose dy javë (mundet edhe më vonë) pas raundit të parë, në qoftë se asnjëri nga kandidatët nuk merr numërin e detyrueshëm ligjor të votave gjatë raundit të parë. Në të tilla raste, MVZ-ja duhet të përcaktojë planet rezervë me kohë për të përcaktuar se si e qysh do të vëzhgojë raundin e dytë.

### 11.1 Shpallja e rezultateve

Misioni i vëzhgimit zgjedhor të OSBE-së është mandatuar për të vlerësuar shkallën e kryerjes së një procesi zgjedhor në përputhje me angazhimet e OSBE-së. Misioni nuk vlerëson, zhvlerëson ose certifikon rezultatin e zgjedhjeve. Duke qenë se MVZ e ODIHR-it është jo partiak, ai nuk bën kurrë komente rreth raporteve politike të një rezultati zgjedhor. MVZ është i interesuar për rezultatin zgjedhor vetëm përsa i takon faktit se deri në ç'skallë ky rezultat ka qenë i saktë, i ndershëm dhe i dhënë në kohën e duhur.

Deklarata paraprake e misionit të vëzhgimit zgjedhor praktikisht jepet para shpalljes së rezultatit zyrtar përfundimtar dhe, në disa raste, edhe para se të jetë bërë i njohur edhe rezultati paraprak i zgjedhjeve. Sidoqoftë, është e qartë se shpallja e rezultatit përfundimtar është pjesë e rëndësishme e procesit zgjedhor dhe, deri në atë shkallë sa të jetë e mundur, ai duhet të vëzhgohet nga misioni i vëzhgimit zgjedhor. Në qoftë se rezultatet kanë për t'u nxjerrë brenda ditëve të zgjedhjeve, atëherë pjesë e ekipit bërthamë duhet të qëndrojë në vend. Në qoftë se njoftimi i rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nuk pritet të dalë edhe pas një periudhe të konsiderueshme kohe pas zgjedhjeve, atëherë ka të ngjarë të mos jetë e mundur që

pjesëtarët e MVZ-së të qëndrojnë në vend. Të gjithë komentet lidhur me fazat përfundimtare të procesit zgjedhor, duke përfshirë edhe shpalljen e rezultatit përfundimtar, duhet të përfshihen në raportin përfundimtar të MVZ-së.

Në qoftë se ka ende elementë të rëndësishme të procesit për t'u përfunduar, ose në qoftë se ka çështje të diskutueshme të pazgjidhura, atëherë MVZ-ja duhet të marrë masat e duhura që të paktën një pjesë e ekipit bërthamë si dhe e VAGj-ëve të qëndrojnë në vend për të vëzhguar periudhën pas zgjedhore. Detyrat e ekipit me afat kaq të zgjatur për periudhën pas zgjedhore duhet të jenë tepër të qarta.

### **Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:**

- Vonesë e paarësyeshme në njoftimin e rezultatit të zgjedhjeve;
- Mbikëqyrje e pabalancuar ose e pamjaftueshme e tabelëzimit të rezultatit përfundimtar;
- Mohimi i së drejtës vëzhguesve për të ndjekur nga afër këtë proces;
- Mohimi i të drejtës edhe personave të tjerë të autorizuar;
- Mospublikimi i rezultateve të hollësishme pranë qendrave të votimit në nivel rrethi; dhe
- Mospërputhje midis rezultateve të regjistruara gjatë ditës së zgjedhjeve dhe rezultateve përfundimtare në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore.

## **11.2 Procesi i ankesave dhe apelimeve për periudhën pas zgjedhore**

Ankesat dhe apelimet janë një komponent i rëndësishëm i procesit zgjedhor dhe mund të bëhen për çdo aspekt të këtij procesi. Në qoftë se vazhdojnë të ketë ankesa të rëndësishme ende të pazgjidhura në kohën e largimit të parashikuar të MVZ-së nga vendi, misioni duhet të shqyrtojë nëse është e dobishme ose e mundshme që analisti zgjedhor ose një grup tjetër vëzhguesish të qëndrojnë në vend për të vëzhguar trajtimin e këtyre rasteve në gjyq ose procedura të tjera ankimore që lidhen me procesin zgjedhor.

MVZ-ja duhet të gjykojë rreth rëndësisë së rasteve të apeluara, nëse procesi i apelimit ka rezultuar efektiv dhe i besueshëm dhe nëse prania e vëzhguesve mund të ketë qenë me dobi për sa i përket zbatimit të procesit. Për shembull, në qoftë se kemi një rast kur rinumërimi i votave mund të ndikojë në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve, ose në ato raste kur një çështje e rëndësishme ndodhet për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, atëherë MVZ-ja duhet të përpiqet që vëzhguesit e saj të qëndrojnë në vend dhe ta vëzhgojnë nga afër procesin.

### **Probleme të mundshme për t'u pasur parasysh:**

- Procedurat komplekse mund ta bëjnë të paqarta se kujt organi duhet t'i drejtohet ankesi;
- Organet gjyqësore ose administrative mund të refuzojnë të pranojnë ankesa ose mund të mos jenë të hapura për të pranuar ankesa;
- Afate kohore tejkajshmërisht të shkurtra mund ta bëjnë të vështirë depozitimin e ankesës;
- Ankesat mund të gjykojnë të papranueshme ose të skualifikohen nisur nga aspekte teknike;
- Kompetencat e bordit të shqyrtimit ose të organit gjyqësor mund të jenë të kufizuara;
- Procesi i marrjes së një vendimi mund të tejzgjatet aq shumë sa të humbasë çfarëdolloj kuptimi;

- Zyrat publike mund të refuzojnë të japin dëshmi të vlefshme për ankesa;
- Komisionet zgjedhore mund të refuzojnë ta rinisin procesin e numërimit;
- Procedurat gjyqësore mund të mos ofrojnë të gjitha garancitë e duhura për një proces të saktë; dhe
- Vendimi i gjykatës mund edhe të mos zbatohet.

### 11.3 Zbatimi i rezultateve zgjedhore

Elementi final i një procesi zgjedhor është ardhja në detyrë e personave të zgjedhur. Angazhimet e OSBE-së kërkojnë që kandidatët të cilët kanë marrë numrin e nevojshëm të votave të marrin përkatësisht detyrën dhe të lejohen ta ushtrojnë atë deri sa t'u përfundojë mandati. E megjithatë, në një pjesë të mirë vendesh, lypset një farë kohe për marrjen nga zyrtarët e porsazgjedhur të detyrës së re qysh nga dita e zgjedhjeve. Është pikërisht kjo gjë që e bën praktikisht të pamundur që MVZ-ja të qëndrojë në atë vend deri sa i gjithë procesi zgjedhor të jetë mbyllur. Sidoqoftë është ODIHR ai që përditësohet lidhur me fazën finale të procesit zgjedhor. Në qoftë se do të shfaqen probleme në këtë aspekt, ato do të pasqyrohen në raportin përfundimtar të zgjedhjeve.

#### **Probleme të mundshme për t'u mbajtur parasysht:**

- Skualifikimi i kandidatëve fitues;
- Parregullsi ose paqartësi në përzgjedhjen e atyre personave që do të fitojnë nga listat e partive (fjala vjen, në ato raste kur ka kuota të përcaktuara për gratë ose minoritetet);
- Zëvendësimi i kandidatëve fitues nga ana e partive para ose pas marrjes së detyrës; dhe
- Mundësia për një përfundim të parakohshëm të mandatit për zyrtarët e zgjedhur ose anëtarët e administratës zgjedhore të përzgjedhur sipas të gjitha rregullave.



# 12.

## Mbyllja e misionit të vëzhgimit zgjedhor të OSBE/ODIHR



Para se të mbyllet, një MVZ i ODIHR-it lypset të ndërmarrë një sërë hapash logjistike e konkretë. Pas ditës së zgjedhjeve, të gjithë VASH-ët kthehen, sa më parë që të jetë e mundur, në kryeqytet, në mënyrë që të mbyllin çdo proces pune para se të largohen për në vendet e tyre. Zakonisht VASH-ët nisen dy ditë pas përfundimit të zgjedhjeve. VAGj-ët duhet të rrinë në rajonet ku janë caktuar edhe disa ditë më pas, në varësi të rrethanave lokale, për të vëzhguar elementët e mbetur nga procesi zgjedhor para se të kthehen edhe ata në kryeqytet për një shkëmbim përfundimtar mendimesh e të dhënash me pjesëtarët e ekipit bërthamë si dhe për t'u nisur më pas. Punonjësit e logjistikës dhe të financës duhet të qëndrojnë në vend edhe nja dy-tri ditë të tjera pasi të jenë nisur të gjithë pjesëtarët e ekipit bërthamë në mënyrë që të përfundojnë aspektet administrative dhe financiare të mbylljes së misionit. Të gjithë dokumentet me vlerë të MVZ-së duhet të kopjohen në një kompakt disk dhe t'i dërgohen ODIHR-it në Varshavë për t'u arkivuar. Dokumentet me shumë rëndësi që nuk gjenden në formë elektronike duhet të shtypen e të sistemohen në dosje për t'u kthyer ODIHR-it.



# 13.

## Partneritetet



Është pjesë e politikës së ODIHR-it për të bashkëpunuar ngushtësisht me grupe të tjera vëzhguesish ndërkombëtarë, pjesëtarë të organizatave përkatëse qeveritare ose jo qeveritare, në varësi të besueshmërinë së qasjen dhe metodologjisë së tyre. Kjo gjë bën të mundur që ODIHR-i të mbajë një dialog të hapur me organizata të tjera si dhe të diskutojë me ta lidhur me përfundimet e mbërritura prej tyre. Kjo gjë minimizon mundësinë që organizma të ndryshëm ndërkombëtarë të mbërrijnë në përfundime të ndryshme lidhur me një proces të caktuar zgjedhor.

### 13.1 Vëzhguesit parlamentarë

Duke njohur vlerën e bashkëpunimit me organizmat parlamentarë për vëzhgimin e zgjedhjeve, ODIHR është i angazhuar të bashkëveprojë me Asamblenë Parlamentare të OSBE-së (OSBE AP) dhe Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës (PACE)<sup>18</sup> por, në të njëjtën kohë, shpesh hyn në partneritet me vëzhguesit e Parlamentit Europian. ODIHR ka krijuar një sërë praktikash të rregullta dhe procedurash për mbështetje dhe bashkëpunim me asambletë parlamentare përkatëse, duke përfshirë këtu edhe organizimin e takimeve informative për vëzhguesit parlamentarë si dhe mbështetje logjistike për dërgimin e tyre në terren. Zakonisht ekipi bërthamë i ODIHR-it ka në gjirin e vet edhe një punonjës ndërlidhës me parlamentin, i cili, lehtëson gjithë këto përgatitje. Përpjekjet e përbashkëta për vëzhgim gjatë ditës së zgjedhjeve kryhen në emër të organizatave përkatëse, si dhe nën ombrellën gjithëpërfshirëse të një misioni vëzhgues zgjedhor ndërkombëtar.

Përsa i takon bashkëpunimit të ODIHR-it me Asamblenë Parlamentare të OSBE-së, të dy organizmat shkëmbejnë rregullisht informacion gjatë gjithë procesit zgjedhor, po kështu Asambleja Parlamentare e OSBE-së ftohet rregullisht të shoqërojë misionin e radhës së vlerësimit të nevojave të ODIHR-it. Veç kësaj, Kryetari i radhës i OSBE-së mund të caktojë një nga anëtarët më me përvojë të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së të bëhet koordinatori i posaçëm dhe të udhëheqë misionin e vëzhguesve afatshkurtër në një proces të caktuar zgjedhor. Në ato raste kur caktohet, koordinatori special është personi që bën deklaratën

<sup>18</sup> Gjatë vëzhgimit të zgjedhjeve për organet lokale dhe rajonale, ODIHR-i shpesh bashkëpunon me Kongresin e Autoritetit Lokal dhe Rajonal të Këshillit të Europës.

paraprake paszgjedhore në bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e Misionit të ODIHR-it dhe udhëheqësit e Asambleve Parlamentare dhe, sipas rastit, me drejtuesit e ODIHR-it.

### 13.2 Misionet dhe Institucionet e OSBE-së

Misionet e vëzhgimit zgjedhor të ODIHR-it dhe misionet rezidente përkatëse të OSBE-së (atje ku ka) veprojnë sipas mandateve të tyre të ndryshme dhe të ndara. Kjo ndarje u duhet bërë gjithnjë e qartë autoriteteve qeveritare të vendit pritës si dhe publikut në përgjithësi, duke filluar nga deklarata prezantuese për shtyp ose konferencën e shtypit. Misionet e OSBE-së janë një burim i çmuar dijesh, ekspertize, dhe këshillash për një mision vëzhgimi zgjedhor të ODIHR-it.

Misioni i vëzhgimit zgjedhor duhet gjithashtu të njihet me çfarëdolloj pune të kryer në vend nga institucionet e tjera të OSBE-së, të cilat mund të kenë rendësi për procesin zgjedhor. Në mënyrë të veçantë, puna e Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare dhe ajo e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias shpesh zënë një vend të veçantë në detyrën që do të kryejë një mision vëzhgimi zgjedhor.

### 13.3 Organizata të tjera

Përveç partneritetit me vëzhguesit parlamentarë dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, si dhe marrëdhëniet e ngushta me institucionet e tjera të OSBE-së dhe misionet e saj në terren, ODIHR bashkëpunon edhe me grupe të tjera që merren me vëzhgimin e zgjedhjeve, duke përfshirë këtu edhe organizatat jo qeveritare ndërkombëtare.

Po kështu ODIHR bashkëpunon edhe me grupet e vëzhgimit zgjedhor vendas nëpërmjet një dialogu të rregullt dhe shkëmbimit të informacionit. E megjithatë është pjesë e politikës së ODIHR-it për t'i ruajtur rreptësisht të ndara si përpjekjet e kryera gjatë misionit të vëzhgimit zgjedhor, ashtu edhe konkluzionet e përfutuara me këtë rast, nga ato të vëzhguesve vendas.<sup>19</sup>

<sup>19</sup> Më 2003, ODIHR-i botoi *Handbook for Domestic Election Observers* [Manual për vëzhguesit zgjedhor vendas], i cili mund të gjendet në faqen e internetit të ODIHR-it, [www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr).



# 14.

## Raporti përfundimtar



Raporti përfundimtar parashtron një vlerësim tërësor të MVZ-së për procesin zgjedhor. Në mënyrë të veçantë, raporti ofron konkluzionet e MVZ-së se deri në ç'shikallë u zhvillua procesi zgjedhor në përputhje me angazhimet e OSBE-së, parimet universale si dhe detyrime të tjera ndërkombëtare për një proces zgjedhor demokratik, po kështu edhe me legjislacionin vendas. Nga ana tjetër, raporti ofron rekomandimet për qeverinë pritëse lidhur me atë se si procesi mund të përmirësohet apo të silllet në një linjë me angazhimet e OSBE-së. Raporti duhet të dalë afërsisht gjashtë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe t'i shpërndahet të gjithë anëtarëve të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së në Vjenë.

Raporti përfundimtar përmbledh përfundimet e krejt MVZ-së, ku hyjnë puna e kryer nga ekipi bërthamë, VAGj-ët, VASh-ët, si dhe përfshin seksione ku përshkruhet konteksti politik i zgjedhjeve; kuadri legjislativ; puna e administratës zgjedhore; regjistrimi i kandidatëve dhe i votuesve; fushata zgjedhore; media; proceset e votimit, të numërimit e të tabelëzimit; si dhe procedurat e ankimit dhe të apelimit. Raporti përfundimtar merr gjithashtu në konsideratë faktin nëse parregullsitë ose shkeljet ligjore të raportuara janë incidente të izoluar apo përbëjnë një model sistematik, çka mund të jetë një rrezik për integritetin e procesit zgjedhor. Raporti reflekton se deri në ç'masë procesi zgjedhor ka gëzuar besimin e kandidatëve dhe të elektoratit, si dhe shkallën e vullnetit politik të shfaqur nga autoritetet për të zhvilluar një proces zgjedhor të vërtetë demokratik. Së fundi, të gjitha zgjedhjet vlerësohen në përputhje me angazhimet e OSBE-së, standardet universale dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare.



# 15.

## Ndjekja në vazhdimësi e problemeve



Një element kyç i raportit përfundimtar është pjesa e rekomandimeve, të cilat duhen marrë parasysh nga qeveria e vendit pritës për përmirësimin e procesit në tërësi ose elementëve të tij. Rekomandimet mund të përfshinë sugjerime për ndryshime në ligj ose në praktikën e administrimit të procesit zgjedhor. Raporti nuk mungon të përsërisë se ODIHR është kurdoherë i gatshëm për të ndihmuar autoritetet e vendit organizator, duke përfshirë këtu edhe zyrtarët e administratës zgjedhore, partitë politike, kandidatët, shoqëritë civile si dhe gjithkënd tjetër të interesuar për të ndrequr mangësitë e gjetura.

Shtetet pjesëmarrëse janë kurdoherë të inkurajuara të kontaktojnë ODIHR-in për të përfituar ndihmë në zbatimin e rekomandimeve që përmban raporti. ODIHR mund t'u ofrojë ndihmë zgjedhore vendeve pjesëmarrëse, duke përfshirë këtu rishikimin e legjislacionit lidhur me procesin zgjedhor, këshilla për tema të veçanta, siç është regjistrimi efektiv i votuesve, shkëmbimi i përvojës me rrjetet e vëzhguesve vendas, si dhe ndihmë në përgjithësi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin përfundimtar të vëzhgimit të procesit zgjedhor. Raporti i ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve përcakton gjithashtu çështje që shpesh mund të trajtohen nëpërmjet programeve afatgjata të ODIHR-it që synojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, fuqizimin e institucioneve demokratike, respektimin e shtetit të së drejtës, si dhe forcimin e shoqërisë civile në të gjithë vendet anëtare. ODIHR nuk ofron ndihmë zgjedhore pikërisht në prag të periudhës së vëzhgimit të zgjedhjeve ose gjatë kohës së zhvillimit të tyre.

Siç është përmendur edhe më parë, të gjitha shtetet anëtare të OSBE-së janë plotësisht të angazhuara ndaj Kartës për Sigurinë në Europë (1999) për të ndjekur e përmbushur pa ngurrim vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it përsa i takon procesit zgjedhor. Ky angazhim u përsërit në Takimin e Portos të Këshillit të Ministrave të OSBE-së (2002), i cili u bëri thirrje të gjithë vendeve pjesëmarrëse të zbatojnë me vendosmëri rekomandimet e ODIHR-it që pasojnë proceset e vëzhgimit të zgjedhjeve.<sup>20</sup> Të gjitha këto angazhime të përsëritura hedhin dritë mbi rëndësinë që Organizata iu kushton masave të vazhdueshme që merren për të përmirësuar proceset zgjedhore dhe në mënyrë konkrete rolin që luan ODIHR-i për të lehtësuar e mundësuar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

<sup>20</sup> Vendimi Nr. 7, Angazhimet Zgjedhore, Këshilli i Ministrave të OSBE-së, Porto, 2002.



---

# ANEKSET

# Aneks A

## Dokumente të OSBE-së<sup>21</sup>

### Paris, 1990 (“Të Drejtat e Njeriut, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës”)

Qeverisja demokratike bazohet në vullnetin e popullit, i shprehur rregullisht nëpërmjet zgjedhjeve të lira e të ndershme. (...)

Ne afirmojmë që, (...) çdokush (...) ka të drejtë: (...) të marrë pjesë në zgjedhje të lira e të ndershme (...)

Kopenhagen, 1990 (zgjedhjet-komente specifike)

(6) Shtetet pjesëmarrëse deklarojnë se vullneti i popullit, i shprehur lirisht e ndershmërisht nëpërmjet zgjedhjeve periodike e të vërteta, përbën bazën e autoritetit dhe legjitimitetit të të gjitha qeverive. Për rrjedhojë, shtetet pjesëmarrëse zotohen të respektojnë të drejtën e shtetasve të tyre të marrin pjesë në qeverisjen e vendit, qoftë drejtpërdrejtë, qoftë nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht prej tyre përmes proceseve të ndershme elektorale (...)

(7) Për të siguruar që vullneti i popullit të shërbejë si bazë e autoritetit të qeverisë, shtetet pjesëmarrëse duhet të:

(7.1) organizojnë zgjedhje të lira në intervale të arsyeshme kohore, siç përcaktohet me ligj;

(7.2) lejojnë që të gjitha vendet, të paktën në një nga dhomat e legjislaturës kombëtare, t'i nënështrohen lirisht votës popullore;

(7.3) garantojnë votë universale e të barabartë për shtetasit në moshë për të votuar;

(7.4) sigurojnë që votimi të jetë i fshehtë, ose të kryhet nëpërmjet një procedure ekuivalente votimi të lirë dhe që të jenë numëruar e raportuar ndershmërisht dhe që rezultatet zyrtare të bëhen publike;

(7.5) respektojnë të drejtën e shtetasve për t'u zgjedhur në një post politik ose publik, individualisht ose si përfaqësues i partive apo organizatave politike, pa u diskriminuar;

(7.6) respektojnë të drejtën e individëve ose grupeve të individëve për të krijuar, në liri të plotë, partitë e tyre politike, ose organizata të tjera politike dhe t'u ofrojnë këtyre partive dhe orga-

<sup>21</sup> Të gjitha këto përkthime janë jozyrtare. Versionin zyrtar të përkthimit të dokumentave të Aneksit A do ta gjeni në [www.osce.org](http://www.osce.org).

nizatave politike të gjitha garancitë e nevojshme ligjore për t'u dhënë mundësi që të konkurrojnë me njëra-tjetrën në mënyrë të barabartë përpara ligjit dhe autoriteteve;

(7.7) sigurojnë që ligji dhe politikat publike të bëjnë të mundur që fushatat politike të zhvillohen në një atmosferë të lirë e të ndershme, gjatë së cilës as veprimi administrativ, as dhuna, apo kërcënimi nuk duhet t'i ndalojnë partitë dhe kandidatët të prezantojnë lirshëm pikëpamjet dhe vlerat e tyre, ose votuesit që të mësojnë ose diskutojnë, si dhe ta hedhin votën e tyre pa patur frikë nga shpagimi;

(7.8) sigurojnë që asnjë pengesë ligjore ose administrative të mos i presë rrugën medias për të patur akses të papenguar, mbi baza jo diskriminuese për të gjithë grupet politike ose individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin elektoral;

(7.9) sigurojnë që, siç e kërkon ligji, kandidatët të cilët fitojnë numrin e nevojshëm të votave të marrin postin që u takon dhe të lejohen të qëndrojnë në atë post deri sa t'u përfundojë mandati, në rast të kundërt, të hiqen sipas ligjit, në përputhje me procedurat demokratike, parlamentare dhe kushtetuese.

(8) Shtetet pjesëmarrëse mendojnë se prania e vëzhguesve, si atyre të huaj ashtu edhe vendas, mund ta përforcojë procesin zgjedhor në vendet ku zhvillohen zgjedhjet. Prandaj, ata ftojnë vëzhgues nga të gjithë vendet anëtare të KSBE-së, si dhe nga të gjitha institucionet private dhe organizatat që mund të dëshirojnë të veprojnë kësisoj, të vëzhgojnë zhvillimin e procedurave të zgjedhjeve kombëtare në atë shkallë që lejohet me ligj. Ata do të përpiqen gjithashtu të mundësojnë akses të ngjashëm për të ndjekur procedurat zgjedhore që nuk janë në nivel kombëtar, por nën këtë nivel. Vëzhguesit angazhohen të mos ndërhyjnë në procedurat elektorale.

### Kopenhagen, 1990 (angazhime të tjera të kësaj natyre)

Me qëllim që të rrisin respektin për të drejtat e njeriut dhe lirinë themelore dhe lirinë për t'i gëzuar ato, për të zhvilluar kontaktet njerëzore, si dhe për të zgjidhur çështjet me karakter humanitar, shtetet pjesëmarrëse ranë dakord si më poshtë vijon:

(3) Ato riafirmojnë se demokracia është një element i natyrshëm i shtetit të së drejtës. Ato njohin rëndësinë e pluralizmit për sa i takon organizatave politike.

(5) Ato solemnisht deklarojnë se ndër elementët e drejtësisë që janë thelbësorë për shprehjen e plotë e të natyrshme të dinjitetit si dhe të drejtave të patjetërsueshme e të barabarta për të gjitha qeniet njerëzore janë si vijon:

(5.1) zgjedhjet e lira që do të mbahen në intervale të arsyeshme kohe dhe me votim të fshehtë, ose sipas procedurave të lira e ekuivalente të votimit, sipas kushteve që sigurojnë në praktikë shprehjen e lirë të opinionëve të votuesve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre;

(5.3) detyrimi i qeverisë si dhe i autoriteteve publike për të vepruar në përputhje me kushtetutën dhe me ligjin;

(5.4) për një ndarje të qartë dhe të prerë midis shtetit dhe partive politike; dhe se, në mënyrë të veçantë, partitë politike nuk duhet të shkrihen me shtetin;

(5.9) se të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit dhe se kanë të drejtë të mbrohen prej tij pa kurrfarë diskriminimi. Në këtë drejtim, ligji do të ndalojë çfarëdolloj diskriminimi dhe do t'u garantojë të gjithë njerëzve mbrojtje të barabartë dhe efektive kundër diskriminimit mbi çfarëdolloj baze;

(5.10) çdokush duhet të ketë të drejtën dhe mjetet efektive për t'u ankuar kundër vendimeve administrative me qëllim që të garantohet respektimi i të drejtave themelore dhe të sigurohet integriteti ligjor;

(5.11) vendimi administrativ kundër një personi duhet të jetë plotësisht i justifikuar dhe, si rregull, duhet të tregojë edhe rrugët e vlefshme të zhdëmtimit;

(10) Duke riafirmuar angazhimin e tyre për të siguruar efektivisht të drejtat e çdo individi për të njohur dhe vepruar në përputhje me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe për të kontribuar në mënyrë aktive vetë ose në shoqata me persona të tjerë, për çuarjen përpara dhe mbrojtjen e tyre, shtetet pjesëmarrëse shprehin angazhimin e tyre të:

(10.1) respektojnë të drejtën e çdokujt, qoftë si person, qoftë në shoqëri me të tjerë, që të kërkojë, të marrë e të japë lirshëm pikëpamje dhe informacion për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë edhe të drejtën për t'i shpërndarë e publikuar këto pikëpamje dhe informacione;

(10.3) sigurojnë që çdo individ të jetë i lirë të ushtrojë të drejtën e mbledhjes e shoqërimit, duke përfshirë edhe të drejtën të formojë, të bashkohet dhe të marrë pjesë efektivisht në organizata jo qeveritare, të cilat kërkojnë të çojnë përpara dhe të mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke përfshirë sindikatat dhe grupet e monitorimit të të drejtave të njeriut;

(10.4) lejojnë anëtarët e këtyre grupeve dhe organizatave të komunikojnë lirshëm e pa pengesa me organizma të ngjashëm brenda dhe jashtë vendeve të tyre, si dhe me organizata të tjera ndërkombëtare, të angazhohen në shkëmbime, kontakte dhe bashkëpunim me kësi grupesh e organizatash dhe të kërkojnë, të marrin dhe të përdorin me qëllim çuarjen përpara dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, kontribute financiare vullnetare nga burime vendase dhe të huaja, siç parashikohet me ligj.

(24) Shtetet pjesëmarrëse duhet të garantojnë se ushtrimi i të gjitha të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, ashtu siç janë parashtruar më sipër, nuk do t'i nënshtrohet kurrfarë kufizimesh, me përjashtim të atyre që parashikohen me ligj dhe që janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë, nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, tok me angazhimet ndërkombëtare që rrjedhin prej saj, dhe veçanërisht, nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. Këto kufizime kanë karakterin e përjashtimeve. Shtetet pjesëmarrëse duhet të garantojnë se me këto kufizime nuk do të abuzohet dhe nuk të do të zbatohen në mënyrë arbitrare, por në mënyrë të atillë që të sigurohet ushtrimi efektiv i këtyre të drejtave. Në një shoqëri demokratike, çdo kufizim i të drejtave dhe liritë duhet të lidhet me një nga objektivat e ligjit që zbatohet dhe të jetë në përputhje të plotë me synimin e ligjit.



### **Budapest, 1994 (Dokumenti përfundimtar, par. 12)**

ODIHR do të luajë një rol të dorës së parë në vëzhgimin e zgjedhjeve, para, gjatë, dhe pas përfundimit të procesit zgjedhor. Në këtë kontekst, ODIHR duhet të vlerësojë kushtet për një funksionim të lirë e të pavarur të medias.

### **Lisbonë, 1996 (Deklarata e Samitit, par. 9)**

9. (...) Ndër problemet e mprehta që kanë të bëjnë me dimensionin njerëzor, shkelja e vazhdueshme e të drejtave të njeriut, siç është rasti me (...) mashtrimet elektorale (...) vazhdon të kërcënojë stabilitetin në rajonin e OSBE-së. Ne jemi të angazhuar të vazhdojmë t'i trajtojmë këto probleme.

### **Stamboll, 1999 (Deklarata e Samitit, par. 26)**

26. Duke pasur numrin e madh të zgjedhjeve që kemi përpara, ne jemi të angazhuar që ato të jenë të lira e të ndershme dhe në përputhje me parimet dhe zotimet e OSBE-së. Kjo është e vetmja mënyrë për të pasur baza të qëndrueshme për zhvillim demokratik. Ne çmojmë rolin e ODIHR-it në ndihmën e dhënë një sërë vendesh për të zhvilluar legjisllacionin zgjedhor në pajtim me parimet dhe angazhimet e OSBE-së, ndaj dhe jemi dakord të ndjekim e zbatojmë pa ngurrim vlerësimet dhe rekomandimet zgjedhore të ODIHR-it. Ne vlerësojmë punën e ODIHR-it dhe të Asamblesë Parlamentare të KSBE-së – para, gjatë, dhe pas zgjedhjeve – si një kontribut të mëtjeshëm për proceset demokratike. Ne jemi të angazhuar t'u sigurojmë të gjitha të drejtat personave që u përkasin minoriteteve për të votuar si dhe t'u mundësojmë të drejtën refugjatëve të marrin pjesë në proceset zgjedhore që zhvillohen në vendet e tyre të origjinës. Ne zotohemi të sigurojmë konkurrencë të ndershme midis kandidatëve dhe partive politike, duke përfshirë këtu të drejtën e aksesit në media dhe respektimin e së drejtës për t'u mbledhur.

### **Stamboll, 1999 (Karta për Sigurinë Europiane, par. 25)**

25. Ne riafirmojmë detyrimin tonë për të zhvilluar zgjedhje të lira e të ndershme në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe në mënyrë të veçantë me Dokumentin e Kopenhagenit, 1990. Ne njohim ndihmën që ODIHR-i mund t'u ofrojë shteteve pjesëmarrëse në zhvillimin dhe zbatimin e legjisllacionit elektorale. Në përputhje me këto angazhime, ne do të ftojme vëzhgues në zgjedhjet që do të zhvillohen në vendet tona nga vendet e tjera anëtare, ODIHR, Asambleja Parlamentare e OSBE-së, si dhe nga institucionet e organizatat përkatëse që dëshirojnë të vëzhgojnë procedurat zgjedhore në vendet tona. Ne jemi dakord të ndjekim e zbatojmë pa ngurrim vlerësimet dhe rekomandimet zgjedhore të bëra nga ODIHR.

# Aneks B

Modeli i listës së verifikimeve të OSBE/ODIHR-it ditën e zgjedhjeve

<b>OSBE/ODIHR Misioni i Vëzhgimit Zgjedhor</b>		
<b>Raport i Qendrës së Votimit</b>		
Ekipi vëzhgues		
Emrat/inicialet	Numri i ekipit/Numrat e akreditimit	
Qendra e Votimit		
Zona Zgjedhore	Qendra e votimit emri/numri	Lloji i qendrës
Koha e vizitës		
Mbërritja e ekipit	Largimi i ekipit	
Numri i votuesve të regjistruar në qendër		
Numri i votuesve që kanë votuar	në: (ora)	
<p><b>Para hyrjes në qendrën e votimit</b>  <i>Lutemi vlerësoni atmosferën e përgjithshme. Mendimi i votuesve dhe i pranishmëve të tjerë do të jetë i dobishëm. Lutemi specifikoni hollësitë në pjesën e pasme të formularit.</i></p>		
A ishte e vështirë të gjendej qendra e votimit?	P / J	
A ishte e vështirë hyrja fizikisht në qendrën e votimit?	P / J	
A vërejtët dukuri si më poshtë:		
Frikësim të votuesve?	P / J	
Rrëmujë të përgjithshme dhe shqetësime?	P / J	
Pllakate dhe materiale të fushatës?	P / J	
Aktivitetet fushate?	P / J	

<b>Brenda në qendrën e votimit: Njerëzit e pranishëm, mjedisi zgjedhor</b> <i>Lutemi specifikoni hollësitë në pjesën e pasme të formularit</i>		
<b>Anëtarët e Komisionit Zgjedhor</b>		
Sa vetë?		
Nga cilat parti?		
Përfaqësues i partive/kandidatëve	P / J / DK	Cilës?
Vëzhgues vendas	P / J / DK	
Përfaqësues të medias		P / J / DK
Forcat e sigurisë		P / J / DK
Persona të pa autorizuar		P / J / DK
A ishte e mbipopulluar qendra e votimit?		P / J
A bëhej fushatë brenda në qendër?		P / J
A kishte materiale propagandistike brenda në qendër?		P / J
A ishte i saktë dhe i plotë informacioni që u ofrohej votuesve?		P / J
<b>Në qendrën e votimit: Procedurat e votimit</b> <i>Lutemi vlerësoni çdo hap që ka të bëjë me procedurën e votimit sipas radhës. Lutemi specifikoni hollësitë në pjesën e pasme të formularit.</i>		
A ka pasur probleme me identifikimin?		P / J
A ka pasur probleme me regjistrimin?		P / J
Fletët e votimit/dokumente të pa firmosur/shënuar/vulosur?		Y / N
Materiale votimi të pamjaftueshme apo të gabuara?		P / J
Kabina votimi të pa mbuluara?		P / J
Votim jashtë kabinave?		P / J
A ka pasur më tepër se një njeri në kabinë, njëherazi?		P / J
A ka pasur probleme me të verbërit apo votues analfabetë?		P / J
A kanë qenë të vulosura siç duhet kutitë e votimit?		P / J
A kanë qenë të dukshme kutitë e votimit për të gjithë anëtarët e Komisionit?		P / J
A ka pasur probleme të tjera?		P / J
Koha e përafërt për të proceduar me një votues		
Pyetje të mundshme rreth kutive të lëvizshme të votimit?		
A keni vërejtur votim familjar <i>Lutemi specifikoni detajet në pjesën e pasme të formularit</i>		P / J
Çrregullime gjatë votimit <i>Lutemi specifikoni detajet në pjesën e pasme të formularit</i>		

A është pezulluar për ndonjë çast votimi?	P / J / DK	Detaje?
<p><b>Parregullsitë që ju janë raportuar</b>  <i>Lutemi përshkruani këtu hollësi të parregullsive lidhur me procesin e votimit ose gjatë fushatës që ju janë raportuar dhe nga kush ju janë raportuar parregullsitë e përmendura. Pyesni përfaqësues të partive, vetë votuesit, vëzhgues vendas si dhe anëtarë të komisionit zgjedhor. Lutemi të shënoni gjithashtu nëse keni qenë në gjendje të verifikoni ndonjë prej parregullsive që ju janë raportuar.</i></p>		
<p><b>Me rëndësi</b>  <i>Lutemi që gjatë kohës që jeni në makinë të diskutoni rreth përshtypjeve tuaja lidhur me qendrën e votimit dhe ta mbushni plotësisht këtë formular. Në mënyrë të veçantë, bëni kujdes të përfshini të gjithë hollësitë e atyre çka patë ose dëgjuat dhe që ngjanin si parregullsi, ose edhe gjithçka tjetër që gjykoni se ia vlen të shënohet.</i></p>		
<p><b>Hollësi dhe komente:</b></p>		
<p><b>Përshtypje të përgjithshme</b></p>		
<p>Si do ta cilësonit në përgjithësi sjelljen në këtë qendër votimi:</p>		
Shumë të keqe ( )	Të keqe ( )	Të mirë ( )

# Aneks C

## Botime rreth zgjedhjeve

*Handbook for Monitoring Women's Participation in Elections*, Varshavë, OSBE/ODIHR, 2004.

*Handbook for Domestic Election Observers*, Varshavë, OSBE/ODIHR, 2003.

*Existing Commitments for Democratic Elections in OSCE Participating States*, Varshavë, OSBE/ODIHR, 2003.

*Udhëzues për Rishikimin e Kuadrit Ligjor për Zgjedhjet*, Varshavë, OSBE/ODIHR, 2001.

*Guidelines to Assist National Minority Participation in the Electoral Process*, Varshavë, OSBE/ODIHR, 2001.

*Resolving Election Disputes in the OSCE Area: Towards a Standard Election Dispute Monitoring System*, Varshavë, OSBE/ODIHR, 2000.



---

## Rreth OSBE/ODIHR-it

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së për të ndihmuar shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respekt të plotë për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke iu përmbajtur shtetit të së drejtës, për të çuar përpara parimet e demokracisë dhe (...) për të ndërtuar, fuqizuar dhe mbrojtur institucionet demokratike, si dhe për të çuar përpara tolerancën në shoqëri” (Dokumenti i Helsinkit, 1992).

ODIHR me qendër në Varshavë, Poloni, u krijua fillimisht si Zyra për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit, më 1990, dhe nisi të veprojë në maj të vitit 1991. Një vit më pas, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar edhe zgjerimin e mandatit ku përfshiheshin të drejtat e njeriut dhe demokratizimi. Sot në të janë të punësuar mëse 120 vetë.

ODIHR është agjencia kryesore në Europë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. ODIHR koordinon dhe organizon çdo vit dërgimin e një numri të madh misionesh vëzhgimi në përbërje të cilave ka me mijëra vëzhgues për të vlerësuar nëse zgjedhjet në hapësirën e OSBE-së kanë qenë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare. Metodologjia e tij unike ofron një vështrim vertikal në të gjithë elementët e procesit zgjedhor. Nëpërmjet projekteve të ndihmës, ODIHR ndihmon Shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre elektoral.

Veprimtaritë e Zyrës në fushën e **demokratizimit** synojnë të ndihmojnë shteteve pjesëmarrëse në zbatimin e angazhimeve të dimensionit njerëzor, duke ofruar ekspertizë dhe mbështetje praktike në forcimin e institucioneve demokratike nëpërmjet programeve afatgjatë për fuqizimin e shtetit të së drejtës, shoqërisë civile dhe qeverisjes demokratike.

ODIHR mbështet mbrojtjen e të **drejtave të njeriut** nëpërmjet projekteve të ndihmës teknike dhe të trajnimit në çështje që prekin dimensionin njerëzor. Zyra kryen studime dhe përgatit raporte lidhur me tematika të ndryshme për të drejtat e njeriut. Veç këtyre, Zyra organizon çdo vit një sërë takimesh për të shqyrtuar zbatimin e angazhimeve në fushën e të drejtave të njeriut nga shtetet anëtare brenda hapësirës së OSBE-së. Në veprimtaritë e veta anti-terrorizëm, ODIHR punon për të rritur vetëdijën për çështje që prekin dimensionin njerëzor dhe realizon projekte që trajtojnë faktorë themelorë që lindin terrorizmin.

Programet e ODIHR-it që kanë të bëjnë me **tolerancën dhe mos diskriminimin** ofrojnë mbështetje për shtetet anëtare në përmbushjen e zotimeve të tyre ndaj OSBE-së, si dhe në

---

---

forcimin e përpjekjeve për t'iu përgjigjur dhe luftuar krimin e urrejtjes dhe shfaqjet e dhunshme të intolerancës. Programet e ODIHR-it synojnë gjithashtu të përforcojnë kapacitetet e shoqërisë civile për t'iu përgjigjur incidenteve dhe krimeve të motivuara nga fryma e urrejtjes.

ODIHR iu ofron këshilla shteteve anëtare rreth politikave të ndjekura prej tyre në drejtim të pakicave **rome dhe gabele**. ODIHR nxit aftësitë rrjetndërtuese midis bashkësive rome dhe gabele dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tyre në organizmat politikëbërëse. Zyra e ODIHR-it vepron gjithashtu si një institucion qendror të dhënash për shkëmbimin e informacionit lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me romët dhe gabelët si ndërmjet aktorëve kombëtarë, ashtu edhe atyre ndërkombëtarë.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it kryhen në bashkëpunim dhe bashkëveprim të ngushtë me institucionet e OSBE-së dhe zyrat operative, si edhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

Për më shumë informacion vizitoni website-in e ODIHR-it ([www.osce.org/odihp](http://www.osce.org/odihp)).

---